



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 16 DHE 17 QERSHOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 16. I 17. JUNA 2016. GODINE**

**QERSHOR - JUN  
2016**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Votimi i Projektligjit nr. 05/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10,
5. Zgjedhja e tre (3) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve,
6. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-077 për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuarëve dhe punëdhënësve,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-081 për energjinë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-085 për energjinë elektrike,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-082 për gazin natyror
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës,
14. Shqyrtimi i raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015,
15. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015,
16. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015 dhe
17. Shqyrtimi i raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015,
18. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë dhe
19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërliken me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës.

## Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje o N/zakona br. 05/L-098 o ratifikaciji Finansijskog sporazuma između Republike Kosova i Evropske banke za investicije za projekat Rehabilitacija železničkog pravca 10,
5. Izbor tri (3) člana Borda za žalbe medija,
6. Izbor direktora Agencije protiv korupcije,
7. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-019 o osposobljavanju, prekvalifikaciji i zapošljavanju lica sa ograničenim sposobnostima,
8. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-077 o registrovanju i pružanju usluga i mera za zapošljavanje nezaposlenih, poslotražilaca i poslodavaca,
9. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-081 o energiji,
10. Drugo razmatranje N/zakona 05/L-085 o električnoj energiji,
11. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-084 o regulatoru energije,
12. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-082 o prirodnom gasu,
13. Razmatranje predloga-odluke za utvrđivanje plate Generalnog revizora Republike Kosova,
14. Razmatranje izveštaja Organa za razmatranje javnih nabavki za 2015. godinu,
15. Razmatranje izveštaja Regulativne komisije za javne nabavke za 2015. godinu,
16. Razmatranje izveštaja Kosovske agencije za imovinu za 2015. godinu, i
17. Razmatranje izveštaja Nezavisnog nadzornog saveta za civilnu službu Kosova za 2015 godinu,
18. Razmatranje Nacrt zakona br. 05/L-102 o ratifikaciji Međunarodnog sporazuma između Republike Kosovo i Evropske unije o Misiji Evropske unije za vladavinu prava na Kosovu,
19. Prvo razmatranje Nacrt zakona br. 05/L-103 o izmenama i dopunama zakona koji se odnose na mandat Misije Evropske unije za vladavinu prava u Republici Kosovo.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuar përfaqësues të Qeverisë, ministra,  
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në sallë ka mjaft deputetë.

Ju njoftoj që me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, e me vendim të presidentit të Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si në vijim:

Shukri Buja, kandidat i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, zëvendëson ish-deputetin Enver Hoxhaj.

Driton Çausi, kandidat i subjektit politik “Vetëvendosje”, zëvendëson ish-deputetin Besnik Bislimi.

Fatmir Xhelili, kandidat i subjektit politik PDK dhe koalicionit, i cili zëvendëson ish-deputetin Azem Sylja.

Deputetët e rinj i njoftoj se betimi i deputetëve është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Tekstin e betimit e ka secili deputet para vete dhe e njëjta duhet të nënshkruhet personalisht për të përmbushur këtë detyrim. Lus deputetët që të ngritën në këmbë, të dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe vetëm në fund, të gjithë së bashku, shqiptojnë fjalën “Betohem” dhe atë secili në gjuhën e vet.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”. Betohem!

Atëherë deputetëve të rinj u dëshirojmë mirëseardhje dhe i ftoj që ta nënshkruajnë tekstin e betimit.

Deputeti Driton Çausi ka njoftuar me shkrim se nuk do të jetë i pranishëm në këtë seancë të betimit dhe betimin do ta japë në seancën e radhës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

## 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

I dini rregullat cilat janë, janë paraqitur disa, fjalën e ka zoti Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot në Kosovë janë top tema, të cilat diskutohen pothuajse edhe në mesin tonë, po edhe në popullatë, edhe shqetësim i përgjithshëm është. Katër temat që sillen sot janë EULEX-si dhe ardhmja evropiane e Kosovës se çfarë vendime, çfarë qëndrime ne të marrim, çfarë vlerësime dhe çfarë obligime do të japim.

Është demarkacioni, i cili është krijuar si një instrument politik pa nevojë për opozitën dhe që ka reflektuar në gjendjen politike të Kosovës dhe në relacionet ndërnjerëzore, të cilat kanë pasur mundësi të bëjnë një zgjidhje më komode, më të pranueshme edhe më të adresueshme në drejtim edhe të popullatës, por edhe të fqinjëve tanë, të cilët nganjëherë krijojnë konflikte, të cilat nuk janë të nevojshme dhe këto ende nuk kanë adresë dhe adresat dihen nga janë.

Bisedimet me Serbinë, kualitetin e të cilave ne nuk po e vlerësojmë, metodologjinë dhe mënyrën se ku po shkojnë.

Pika mbi të gjitha, e cila është e katërta pikë, top temë është - ekonomia.

Unë kam parë dhe po shoh ditë për ditë në televizion kryeministrin, edhe kryeparlamentarin, edhe presidentin, duke ftuar investitor të huaj të vijnë në Kosovë, do të kenë lehtësi, do të kenë ndihmesa të gjitha me radhë.

Unë kam ngritur zërin disa herë për gjendjen e ekonomisë brenda vendit, si e kemi gjendjen me investitorët brenda vendit, sepse për t'i thirrur investitorët e jashtëm, ne duhet të reflektojmë për investitorët të brendshëm si e kanë situatën. Ne kemi Drenicën, ku është një situatë ekonomike shumë e keqe, popullata e cila ka sakrifikuar më së shumti për çlirimin e Kosovës e ka vetëm një industri, e ajo quhet Feronikeli, i cili rrezikohet të mbyllet dhe përkujdesja rreth tij me ato kushte që për ne i ofrojnë rrezikohen 900 punëtorë të dalin nga puna, 500 kontraktorë dhe total 10 mijë banorë të mbesin raste sociale.

Prandaj, a është obligim ne të shohim çfarë metodash fleksibile të aplikojmë që të ruhen ato vende të punës, apo ta lëmë vetëm se jemi ekonomi e lirë e tregut, ata janë privatë, kanë fitua më shumë ose të gjitha me radhë.

Këta 900 punëtorë janë të gjithë në linjë kreditore. Nesër nëse mbesin pa punë, do të jenë raste sociale në Ministrinë e Çështjeve Sociale dhe nesër do të jenë problem serioz për...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Glauk Konjufca, emër të Grupit Parlamentar.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Dua ta prezantoj një fotografi përpara jush.

Ky që po e shihni këtu është kryetari i Komunës së Klllokotit, njëra prej komunave të krijuara me pakon e Ahttisarit, ky quhet Sreqko Spasić dhe është duke shtënë me armë zjarri në një poligon, të cilën e ka ndërtuar Serbia, në veri të Kosovës dhe ku po ushtrojnë në mënyrë të armatosur strukturat paralele dhe të paligjshme të Serbisë, për të cilët Qeveria e Kosovës thotë që po shpërbëhet.

Në këtë foton tjetër këtu janë edhe shumë anëtarë të tjerë të strukturave të paligjshme të Serbisë, të gjithë të armatosur.

Dhe, disa prej tyre dua edhe që t'i përmend me emra. Pra e kemi njëfarë kryeshefi të Policisë këtu, Dobrivoje Stojanović, po thotë, pastaj Dragan Periq, punëtor i sigurisë në Klllokot, Miladin Janković, anëtar i BIA-së, i Shërbimit Informativ dhe të Sigurisë së Serbisë, Milorad Marković, ish- kryetar i Kuvendit të Klllokotit, Velibor Kostiq nga Gorqari, Ilija Mirković, zyrtar në Komunën e Klllokotit, e kështu me radhë.

Të gjithë këta janë ose punëtor të strukturave të paligjshme të Serbisë, ose punojnë zyrtarisht në komunën, e cila është në kuadër të Republikës së Kosovës dhe këta janë të zgjedhur zyrtarisht, pra në Komunën e Klllokotit.

Kjo është një listë e pagave të tyre, të cilat i marrin prej Serbisë, të gjithë këta, edhe kryetari aktual i Komunës së Klllokotit janë me numër, banka ku merret ajo, kontoja e të gjitha këto me radhë.

Këto ne do t'ia dorëzojmë Prokurorisë së Republikës së Kosovës që të merret me këto raste. Por, unë e shtroj pyetjen a i di Qeveria e Kosovës këto? Nëse nuk i di, çfarë Qeverie është kjo që nuk e di se çka po ndodh në oborrin e vet. Po nëse e di, çfarë Qeverie është kjo që përpara hundës Serbia i ndërton poligonet e ushtrimeve ushtarake dhe të armatosura e Qeveria jonë bënë sehir e merret me zgjedhjen e zëvendësministrave apo merret me kush-kujt do t' i japë tenderin. Kush po merret me sigurinë edhe me shtetin e Kosovës, shtrohet pyetja?

Mandatin e kaluar Qeveria e Kosovës pati thënë që strukturat e Serbisë do të shpërbëhen në nëntor të vitit 2014, ky është afati i fundit i shpërbërjes së strukturave të Serbisë. Tash jemi në qershor të vitit 2016 dhe këto struktura jo vetëm që nuk janë shpërbërë, por janë koalicion qeverisës bile me LDK-në dhe PDK-në, me ministra sikur tipi i Branimir Stojanovićit që bënë fushatë elektorale të hapur për Vuçiqin, pastaj këto struktura po ndërtojnë me qindra shtëpi dhe po e kolonizojnë Kosovën siç po ndodh me Luginën e diellit në Zveçan.

Këto struktura po ndërtojnë poligone të armatosura, si këtu që e paraqita tash dhe hiq më larg se dje, dy të dyshuarit kryesor vrasës të Enver Zymberit e kanë rrahur për vdekje dhe tash ai është në spital, dëshmitarin kryesor, i cili ka treguar për këta të dyshuar që mund të jenë vrasësit e Enver Zymberit.

Në mars të vitit 2009, pra po bëhen 7 vjet Lëvizja “Vetëvendosje” e pati dorëzuar në Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë një kallëzim penal me 116 emra të strukturave të paligjshme të Serbisë në Kosovë, me emra dhe mbiemra. Prokuroria e Kosovës nuk ka bërë asgjë që 7 vjet.

Po pikërisht edhe një lëndë tjetër është e vitit 2009, e ajo është përndjekja e 27 aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Këtë lëndë të vitit 2009 gjyqësia po e shfrytëzon e po e keqpërdor maksimalisht. A këtë lëndën e vitit 2009 të 116 emrave të strukturave të Serbisë gjyqësia e ka qitur në harresë edhe e ka mbuluar pluhuri.

Pra, gjyqësia jonë e kapur si mos më keq nga pushteti, është shumë e zellshme për persekutimin e opozitës dhe të kundërshtarëve politikë, ama kur nuk i ka prekur dy kategoritë e njerëzve në Kosovë. Strukturat e Serbisë, dhe krimin e politikës që është krim i organizuar në Kosovë, e kjo tregon më së miri se në dorë të kujt është shteti i Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolege deputete,

Të nderuar kolegë deputetë,

E kërkoja sot fjalën meqë po konsideroj se nuk mund të jemi të heshtur si Parlament karshi rastit tragjik që ndodhi javën e kaluar në Prizren, ku si pasojë e shembjes së murit të vjetër humbi jetën trevjeçarja Xheneta Gashi.

Konsideroj se është e dhimbshme dhe shumë e rëndë humbja e jetës e një fëmije dhe nuk guxojmë që në asnjë mënyrë këtë rast ta paragjykojmë dhe ta politizojmë. Mendoj se drejtësia duhet të veprojë, ta trajtojë me prioritet dhe me ndjeshmëri, në mënyrë që të dihen saktë shkaqet dhe pasojat që çuan në këtë tragjedi dhe të merren masa ndaj atyre që kanë dështuar që të përmbushin obligimin e tyre ligjor.

Pas asaj që ndodhi në Prizren kërkoj urgjentisht nga institucionet që të ndihmojnë me hapa konkretë familjen e vajzës, e cila pësoi tragjikisht. Ndonëse e di që nënës në asnjë mënyrë ne nuk do të mund t’ia kompensojmë humbjen e fëmijës së saj. Mendoj që ajo tani ka nevojë për strehim të sigurt për rehabilitim, si dhe për mbrojtje.

Po e them këtë me që ditët e kaluara ka pasur disa iniciativa të qytetarëve të vullnetit të mirë, të cilët kanë dashur që në mënyrë vullnetare të solidarizohen me këtë rast.

Mendoj që është obligim i institucioneve që të ofrojnë ambient të sigurt për të gjithë qytetarët. Prandaj, duhet të merren masa që një rast i tillë të mos ndodhë më.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarët e Kosovës duhet të sigurohen që rastet e ngjashme të mos përsëriten më, me që janë një numër i madh i objekteve të vjetra, të cilat po vazhdojnë të paraqesin rrezik për qytetarët e Kosovës.

Shtëpi të cilat rrezikojnë të shemben kemi edhe disa lagje në Prishtinë, si dhe në shumë qytete të Kosovës.

Qeveria si dhe komuna duhet të përkujdesen që këto objekte, që janë të trashëgimisë kulturore, të ndahen mjete për to dhe të restaurohen konform ligjeve në fuqi dhe krejt në fund, si deputete e këtij parlamenti, uroj që tragjedisë si kjo e fundit në Prizren të mos ndodhin më në Kosovë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Qerim Bajrami e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem predsedavajući,  
Poštovani poslanici Skupštine Republike Kosova,  
Poštovani ministri,

U ovoj temi su moje koleginice ispred bošnjačke zajednice već govorile ovde u parlamentu Kosova, ali ja moram da prenesem ogromnu zabrinutost bošnjačkog, albanskog i djelan srpske zajednice koja živi u regiji Župa kod Prizrena, koja u nazad dva meseca je jako uznemirena, i nažalost naša Vlada, odnosno kompetentna ministarstva, ne reaguju dovoljno da smire situaciju na terenu među dvanaesti hiljada trenutno prisutnih mještana u 10 do 15 sela u regiji Župa.

Naime radi se o divljim pokušajima da se po jednom planu Ministarstva za ekonomski razvoj navodno izgrade takozvane mini hidrocentrale, koje opšte nisu mini, nego su hidrocentrale ogromnih kapaciteta, i imaju za namjeru da ognišu i da unište i životnu sredinu, i bukvalno život građana na tim prostorijama.

Zahtijevam ovde od Ministarstva za zaštitu životno sredino ponovo, kao što smo to učinili u pismenoj formi, da sve te manipulacije na terenu pojedinih navodnih investitora ponovo preispita, jer samo da navedem primjer da su navodno za tri nekakve mini hidrocentrale održane u nazad nekoliko meseci javne debate na terenu sa građanima, a prikazana je jedna debata da u jednom selu manastiri gde živi dvije do tri hiljade stanovnika, da je održana u gradu Prizrenu sa nekakva tri građana, koje nemaju očigledno poreklo ne iz grada Prizrena, a kamo li iz tog sela manastirice. Samo sam htjeo da navedem jedan primer šta su ljudi koji su trenutni želji novca spremni da urade.

Takođe smo uputili naše primedbe i uredbe za energetiku i u Ministarstvom za ekonomski razvoj, i očekujemo adekvatno reagiranje.

Nemojte da mislite da smo mi slučajno iz te regije protiv ekonomskog razvoja, nismo, ali kao što svi znate, to je jedan od najlepši krajeva na Kosovu, ta regija je prenaseljena stanovništvom i neka moji Prizrenci kolege poslanici zamisle situaciju da nama neko sada u gradu Prizrenu dođe, i od dva grada uzme u cevima od 70, 80 ili 100...

*(Ndërprerje nga regjia)*



KRYESUESI: Rregulloren e dini. Zoti Mytahir Haskuka e ka fjalën.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar qytetarë,

Deputetë dhe deputete,

Së pari e falënderoj edhe kolegen nga PDK-ja që e ngriti rastin e Prizrenit, por unë vetëm këtu dua të them pse s'ka qenë dje kur shoqëria civile në Prizren organizoi një protestë për këtë rast, pse s'mori pjesë edhe ajo.

Në këtë aspekt unë vetëm desha të them që javën e kaluar në Prizren faktikisht ka ndodhur një krim, nuk ka qenë as fatkeqësi, as tragjedi, por krim. Një vajzë 3- vjeçare, duke lozur në rrugicën ku banonte vdiq nga një mur, i cili ra nga një shtëpi, e cila ishte nën mbrojtjen e shtetit. At ditë po ashtu u lënduan dy persona. Kaluan më shumë se një javë nga tragjedia, asnjë reagim nga institucionet përgjegjëse, reagimi i vetëm institucional ishte vendosja e gypave të kanalizimit rreth objekteve të trashëgimisë kulturore në Prizren.

Nuk ka inicim të ndonjë rasti ndaj gjyqtarëve, nuk ka kërkesë përgjegjësie, e as deklaratë nga kryeministri apo ministra. Së paku është dashur të reagojë personi i cili veten e quan president. Qeveritarët e Prizrenit këtë ngjarje u munduan ta paraqesin si fatkeqësi, por fatkeqësia e Xheneta Gashit ishte që ajo jetonte në Komunën e Prizrenit, ku një kryetar i dënuar që tre vjet vazhdon të mbajë postin e tij. Ku më shumë drejtorë komunalë janë nën hetime apo gjykime dhe gjykimet e tyre vazhdojnë në pafundësi.

Prizreni, ku njerëzit vriten nga gangsterë, gjë as prokuroria nuk e bën punën e saj, Prizreni, ku fajdja është bërë biznes. Pastaj, si mund të jetë fatkeqësi kur një vajzë jep shpirt nën rrënojat e një shtëpie që është nën mbrojtje të shtetit, a mund të jetë fatkeqësi kur ekzistojnë fonde për mirëmbajtjen e këtyre shtëpive, dhe kur kemi institucione që duhet të mirëmbajnë ato shtëpi. A mund të quhet fatkeqësi kur organet kompetente e neglizhojnë punën e tyre dhe, si pasojë, shkaktojnë vdekjen e njerëzve.

Ligjet përcaktojnë qartë përgjegjësitë e Komunës së Prizrenit dhe ministrive. Sipas këtyre ligjeve duhet të mbrohet Qendra Historike e Prizrenit dhe t'u ofrohet siguri qytetarëve të Prizrenit. Nëse mjeku e neglizhon punën dhe pacienti vdes, ai hyn në burg. Nëse shoferi i veturës neglizhon vozitjen dhe e vret këmbësorin, ai futet në burg, por në Kosovë nëse një zyrtar nuk e bën punën e tij dhe si pasojë vdesin njerëzit, kjo nuk konsiderohet si krim dhe kurrkush nuk shkon në burg.

Në vitet e kaluara shumë organizata joqeveritare dhe opozita në Prizren kanë kërkuar që institucionet të ndalin degradimin e Qendrës Historike të Prizrenit dhe të ndajnë fonde emergjente në ndërhyrje dhe riparime të objekteve të rrezikuara nga shembja. Degradim, kjo që u bë me neglizhencë, por edhe me djegie dhe rrënim të qëllimtë për të hapur vend për bizneset e lidhura me pushtetarët e Prizrenit. Kështu, duke shkatërruar ne nuk do të anëtarësohemi kurrë në UNESCO. Qendra Historike e Prizrenit është pasuria më e madhe e Kosovës, prandaj duhet të ndahen fonde emergjente për mbrojtjen e saj. Duhet të ndahen minimum 10 milionë euro që të ketë riparim, mbrojtje dhe mirëmbajtje të Qendrës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës, Mëngjesin e 3 prillit të vitit 2014, nën dyshimin e bazuar për inkriminim në veprimtari kriminale, u arrestuan 10 zyrtarë të Komunës së Prishtinës lidhur me veprat penale, pjesëmarrje ose organizim i grupit kriminal dhe keqpërdorim i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar.

Të njëjtit dyshohen se duke keqpërdorur detyrën e besuar zyrtare kanë përfituar për vete apo personat e tjerë hiq më pak se një vlerë rreth 29 milionë euro. Në një artikull të “Koha Ditore” të datës 9 qershor lexuam pjesë nga dëshmia e ish- inspektore në Komunën e Prishtinës, Zyhrisë Pllana. Aty thuhet se pas përplasjeve që dëshmitarja kishte pasur me ish-kryeshefin e Inspektoratit në Komunën e Prishtinës, i afërmi i Mustafës, Ismet Haliti, i kishte shkruar edhe ish-kryetarit të Komunës së Prishtinës, Isa Mustafa, në lidhje me një leje që dyshohej që ishte e falsifikuar dhe e cila ishte dedikuar Kompanisë “Hysi Group”.

Në një takim që kishte pasur me të, me të cilin dëshmitarja e kishte shpjeguar rastin në fjalë, i njëjti kishte thënë se kjo nuk është punë jotja, mos u merr me të. Madje, i kishte kërkuar që të dalë nga zyra.

Të nderuar deputetë, kjo deklaratë e kësaj dëshmitareje do të thotë shumë. Kjo deklaratë do të thotë që në krye të Qeverisë kemi një njeri për të cilin ekziston dyshimi i bazuar se ka qenë pjesë e grupit kriminal, i cili i plotëson të gjitha elementet e krimit të organizuar. Grup ky, i cili me veprimet e tyre duke keqpërdorur detyrën zyrtare kanë falsifikuar dokumentet e karakterit publik. Ky pretendim nuk vërtetohet vetëm për rastin në fjalë që është tejet skandaloz, por edhe për të gjitha kallëzimet penale të deponuara nga qeverisja aktuale e Prishtinës.

Sikur ne të kishim sot institucionet e pavarura të drejtësisë, prokurorja e rastit do ta zgjeronte aktakuzën në mënyrë që të zhvillonte hetim të veçantë dhe listës do t’i shtohet edhe një njeri, e ai do të ishte Isa Mustafa. Por, kjo realisht nuk ndodh dhe nuk do të ndodhë nga një sistem i kapur, i korruptuar dhe shërbyes jo i drejtësisë, por i para politikës. Mostër më e mirë për këtë është se në vend se kryeprokurori i shtetit të shihet duke e shpartalluar mafinë parapolitike, ai shihet në kafenetë e Prishtinës me aparatçikë politikë.

Cili është shembulli i cili po jepet nga kreu i organit të ndjekjes penale, luftimi i krimit. Natyrisht se jo, por e kundërta.

Të nderuar deputetë,

Para se Prokuroria të ngrejë ekspres-aktakuza për deputetët e opozitës, për veprimet e tyre në Kuvend, do të ishte e udhës që të hetojë dhe gjykojë kryeministrin Mustafa, madje nga këtu po i bëj thirrje për një gjë të tillë. Vetëm po të shohësh Prishtinën, kuptohet se deri para tre vjetësh këtu ka vepruar një rrjet i madh i krimit të organizuar, para të cilit prokuroria është dorëzuar dhe ka mbyllur sytë. Andaj, meqë po përmendet luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit si kusht për liberalizim të vizave, prokuroria le t’i kapë “peshqit” e mëdhenj dhe urdhërdhënësit.

Nuk ka shtet përmes drejtësisë selektive, nuk ka drejtësi me kalkulime politike nëpër kafenetë e Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Të nderuar të pranishëm,  
Koalicioni LDK-PDK çdo ditë e më shumë po argumenton at që lëvizja “Vetëvendosje” ka thënë në fillim, kur këta janë bërë bashkë në qeverisje.

Të qeverisësh me atë që për shumë vjet kanë kapur çdo pore të shtetit, do të thotë që edhe ti po bëhesh hisenik me të. Qeverisja e Isa Mustafës, përveç dëmeve që i ka sjellë Kosovës, me nënshkrimin e dy marrëveshjeve në dëm të sovranitetit, ajo është shembulli më i keq se si qeveriset vendi, sepse është vazhdimësi e asaj që është parë deri më tani. Vetëm se kapja e shtetit po bëhet edhe nga LDK-ja, duke i shpërblyer militantët partiakë me poste si në sektorët publikë, po ashtu edhe në agjencitë e pavarura.

Kemi, për shembull, anëtarë të bordeve, të cilët janë, ose kanë qenë anëtarë kryesie, kanë qenë militantë të LDK-së apo PDK-së, të cilët u zgjodhën nëpër këto poste, si për shembull, në ZRE u zgjedh Arsim Janova, anëtar kryesie i LDK-së, pastaj Besim Sefaj, nënkryetar i Degës LDK në Deçan, Qemajl Mustafa, ish- kryetar komune i Gjilanit, e kështu me radhë.

I tillë ishte edhe emërimi i Jeton Shalës kryeshef ekzekutiv i Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale. Është njeri i Isa Mustafës që përkundër se në kohën kur u zgjodh ai ishte i dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Jeton Shala në kohën sa ishte ushtrues detyre i kësaj agjencie janë vjedhur barna me sasi të mëdha, po ashtu me vlerë të madhe të të hollave. Si dhe është vjedhur llap-topi, ku kanë qenë të regjistruara këto barna.

E gjithë kjo po ndodhi nën vëzhgimin e kamerave, prandaj të nderuar qytetarë, këtë nuk mund ta quajmë vetëm vjedhje, kjo është krim i organizuar. Në vend që Jeton Shala të jepte llogari për këtë vjedhje, ai u shpërblye me postin e të parit të kësaj agjencie. E ajo që është shqetësuese dhe që po e paraqes këtu para juve është ndërhyrja në drejtësi, sepse më 29 shkurt të këtij viti Gjykata Themelore e Prishtinës, Departamenti i Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzë për Jeton Shalën për keqpërdorimin e detyrës zyrtare.

Vizita e kryeministrit Mustafa pas gjashtë jave, konkretisht më 12 prill 2016, i bën me dije prokurorisë se Jeton Shala nuk ka të bëjë me vjedhjen e barnave, sepse ky nuk do të “lejonte” të qeverisin ata që janë të akuzuar, siç ka thënë në fillim të këtij mandati, e kjo është një ndërhyrje në prokurori, sepse para 4-5 ditësh prokuroria tërhoqi aktakuzën ndaj kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë për Produkte Medicinale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përhëndetje Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të respektuar opozitarë që më në fund keni ardhur këtu që të jeni pjesë e këtij Kuvendi, dhe po më vjen mirë që keni filluar t’i trajtoni shumë çështje, të cilat janë me rëndësi jetike dhe këtu është vendi ku ju duhet të diskutoni dhe të debaton.

Dua të ndalem në dy çështje, së pari dua të kërkoj nga lëvizja “Vetëvendosje” me veprimet e tyre aktuale, a mos është duke tentuar ta instalojë logjikën e UDB-ës se kush me kënd rri. Është një logjikë e mbrapsht, besoj që e kemi tejkaluar kohë më herët dhe besoj që do të duhej të kenë kujdes se çfarë veprimesh janë duke bërë. Një pjesë e tyre vërtetë kanë pasur pasoja nga ajo kush me kënd ka qëndruar, ka ndenjor dhe është shoqëruar. Dhe besoj që është dhënë shumë mund, është derdhur shumë gjak, janë mbajtur shumë vjet burgje që të mos instalohet kjo logjikë.

Ka në lëvizjen “Vetëvendosje”, e cila u shërben për lavazh, futen nga njerëzit që kanë qenë ata ose familjarë të tyre antikombëtarë dhe pastaj dalin patriotë.

Dhe, e dyta, me çfarë autorizimi lëvizja “Vetëvendosje” bën fotografime të fshehura. A qëndron dikush pas jush? A mos keni ju ndonjë shërbim të fshehtë që i bëni ato gjëra? Mos bini pre e atyre veprimeve, debatoni këtu, angazhohuni këtu, këtu është vendi dhe dihen format, mënyrat çfarë duhet debatuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo replikë s’ka për këtë çështje. Nuk ishte replikë! Ishte diskutim.

Pra, është shteruar pika e parë e rendit të ditës. Po më vjen keq, por s’e kam problem për të dhënë fjalën për replikë, por nuk lejohet replika, sipas Rregullores.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Rregullat i dini. I kemi 16 pyetje.

Pyetja e parë është nga deputetja Albulena Haxhiu për kryeministrin Isa Mustafa.

Kryeministri nuk është këtu. Nëse doni, mund ta paraqitni pyetjen.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në seancën e kaluar e kisha këtë pyetje parlamentare. Kryeministri Mustafa erdhi tek pas përfundimit të pyetjeve parlamentare. Sot prapë s’është këtu.

Nuk po di çfarë njeri është kështu! A e di ky që duhet dhënë llogari para deputetëve dhe qytetarëve, sepse çështjet që i ngrenë deputetët janë goxha të rëndësishme për interesat e qytetarëve.

Mirëpo, papërgjegjësia e tij po reflekton edhe gjatë kohës së pyetjeve parlamentare.

Po e them pyetjen, ndonëse kryeministri nuk është këtu, mirëpo në qoftë se vjen kryeministri Mustafa apo kurdo që vjen sot, ai do të ketë përgjegjësi për t’u përgjigjur në këto pyetje parlamentare. Nuk mundet, thjesht, t’i injorojë kësisoj.

Në vitin 2011 Kosova e bëri regjistrimin e popullsisë. Asokohe, me shumë pompozitet, thuhej se ky regjistrim do të bëhet në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Në fakt, nuk ndodhi ashtu. Qeveria u dorëzua karshi Beogradit, duke mos regjistruar qytetarët e Republikës së Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të vendit.

Pyetja ime për kryeministrin është: Pse hoqët dorë nga regjistrimi i popullsisë atje dhe pse nuk zbatuat Ligjin për regjistrimin e popullsisë edhe në atë pjesë të vendit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dua të tërheq një vërejtje! Kur po e merrni fjalën, e nuk po e mbani mikrofonin mirë, po bëhet zhurmë dhe më shumë po dëgjohet zhurmë se sa diskutimi.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zoti Kurteshi, doni ta bëni pyetjen? Urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Zotëri kryesues!

Çështja e pyetjeve parlamentare është shumë problematike. Kryeministri dhe një pjesë e ministrave jo vetëm që nuk po vijnë këtu t'u përgjigjen pyetjeve parlamentare, e unë, pas vitit të ri, ua kam drejtuar 20 pyetje me shkrim kryeministrit dhe disa ministrave, që kanë mundur t'u përgjigjen nga kabinetet e tyre.

Dhe, nga ato pyetje i kam marrë dy përgjigje, një nga ministrja Bajrami dhe një nga ministri Jevtiq. Të tjerët nuk janë marrë me këto çështje. Mospërgjigja ndaj pyetjeve është refuzim i kontrollit që e bëjnë deputetët mbi punën e Qeverisë, prandaj kjo çështje duhet të ngrihet në një nivel më serioz dhe t'u bëhet me dije këtyre zotërinjve se kanë obligim ligjor të përgjigjen para deputetëve, ose kjo çështje, kjo e drejtë duhet t'u merret deputetëve dhe të mos lejohen pyetje parlamentare, e le t'i grahin ata dhe bëjnë çka të donë, e ne të rrimë e t'i këqyrim deri ku do të shkojnë.

Mirëpo, vërtet bën pyetje parlamentare e nuk vjen këtu. Bën pyetje parlamentare me shkrim, e mos u përgjigj as nëpër kabinetet e tyre, kjo është jashtë çdo mase.

Pyetjeve të mia me shkrim janë përgjigjur vetëm 10%. 90% të pyetjeve parlamentare me shkrim nuk kanë marrë përgjigje dhe është vërtet brengosëse për të gjithë ne. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit! Zoti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zoti Topalli a dëshironi të bëni pyetjen? Zoti Topalli e ka fjalën!

FATON TOPALLI: Faleminderit kryesues!

Tanimë nuk jam fare i befashuar me mungesën e kryeministrit, sepse mungesa e tij nuk është përjashtim, është rregull. Pra, ai nuk vjen për t'u përgjigjur Kuvendit të Kosovës dhe është shkelësi më i madh i të gjitha normave, shkelësi më i madh i Kushtetutës, si për "Zajednicën", si për Gjykatën Kushtetuese, si për përdorimin e forcave antiterror kundër opozitës, e kështu me radhë.

Ajo që më befason është heshtja totale e kolegëve të mi – deputetë e deputete nga radhët e koalicionit të madh qeverisës. A është kjo demokracia që ju e kuptoni dhe që e mbështesni që kryeministri kurrë të mos i përgjigjet Kuvendit?

Unë nuk besoj se në Kosovë ka një shumicë parlamentare që lejon të shkelen parimet themelore të demokracisë dhe të dhënies përgjegjësi, prandaj edhe ju pyes: Pse heshtni? Pse lejoni që kryeministri juaj t'u ikë përgjegjësi? Pse nuk kërkoni edhe ju llogari nga kryeministri? Pse nuk

e detyroni kryeministrin tuaj t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve dhe t'i përgjigjet këtij Kuvendi?

Kjo vlen njësoj edhe për shoqërinë civile dhe për aktorët e ndryshëm të shoqërisë civile, pse nuk reagoni fuqishëm kur kryeministri i Kosovës nuk i përgjigjet organit më të madh legjislativ të vendit? Pse nuk e ngrini zërin?

Kjo që po ndodh nuk është demokratike. Kjo far sjellje e kthen demokracinë dhe kryeministrin Mustafa në një mbret të një mbretërie të paproklamuar, e cila po bëhet me mbështetjen e shumicës parlamentare.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetja e radhës është nga zonja Donika Kada-Bujupi. Pyetja është për kryeministrin Isa Mustafa.

DONIKA KADA-BUJUPI: Vitin e kaluar në të njëjtën periudhë kohore, kur Isa Mustafa dhe Hashim Thaçi nënshkruan ose përgatiteshin të nënshkruajnë dy marrëveshjet shkatërruese për vendin, ky Kuvend dhe deputetët e opozitës në vazhdimësi ngritën pyetje, në të cilat asnjëherë nuk morën përgjigje, respektivisht ata erdhën të deklarohen para Kuvendit vetëm pas nënshkrimit.

E njëjta po ndodh edhe sot, kur kemi përpjekje të Serbisë që përfundimisht të ndajë veriun e vendit përmes kolonizimit dhe projektit të ashtuquajtur "Lugina e diellit", i cili më 9 qershor është inauguruar nga zëvendësi i Isa Mustafës. Ne sot kemi bërë pyetje parlamentare se çfarë ka ndërmarrë si shtet, si Qeveri, si kryeministër për t'i ndalë, e ai nuk është këtu.

Prandaj, pyetja jonë do të vazhdojë deri sa ai të përgjigjet, po ashtu siç do të vazhdojë edhe kundërshtimi për një përpjekje të tillë për rikolonizim të vendit 16 vjet pas luftime.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Shqipe, dëshironi ta bëni pyetjen?

SHQIPE PANTINA: Meqë Qeveria nuk është këtu për t'iu përgjigjur halleve të mëdha shtetërore, e kur nuk u përgjigjet këtyre, nuk di a ka interes t'iu përgjigjet edhe rasteve të tjera, për të cilat tashmë ka edhe zotime.

Zotëri Kuçi kur ka qenë zëvendëskryeministër, pozitë të cilën e mban edhe sot, më 13 gusht 2008 pati nënshkruar një memorandum me punëtorët e Radiotelevizionit të Prishtinës, të përfaqësuar nga Këshilli grevist prej 8 anëtarëve.

Në këtë memorandum tetëpikësh, ndër të tjera, Qeveria është zotuar se çështja e punëtorëve të RTP-së do të rregullohej së shpejti. Kjo është në pikën 3 dhe po ashtu këtyre punëtorëve do t'u njihet stazhi i punës dhe do t'u ofrohet përkrahje sociale. Por, në fakt, ajo çka ka ndodhur është se politikanë – anëtarë të partive të koalicionit, kanë punësuar familjarë të tyre në institucionin, i cili ka trashëguar RTP-në, qoftë deputetët që kanë punësuar vajzat apo kryetarë komunash që punësojnë gratë atje. Kështu që përveç PTK-së, tani RTK-ja është shndërruar në një institucion

ku punësohen familjarët dhe militantët politikë, përderisa punëtorëve legjitimë, të cilët kanë të drejtë, nuk u njihet ajo tash e sa vjet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

ABDYL YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektet e zhvilluara në infrastrukturën rrugore janë të shumta dhe janë zhvilluar në çdo pjesë të Kosovës, duke ndërtuar rrugë lokale, regjionale dhe autostrada, të cilat kanë mundësuar lehtësi në qarkullimin dhe lëvizjen e mallrave e të njerëzve.

Projekti i zgjerimit të rrugës nga segmenti Klinë e Epërme – Skenderaj – Drenas – Komaran, i nisur prej Qeverisë së kaluar, ende nuk ka hyrë në fazën përfundimtare të tij dhe, përkundrazi, nëse vazhdon me këtë dinamikë, do të duhen edhe disa vjet për ta përfunduar këtë projekt, sepse segmenti nga Klina e Epërme – Skenderaj – Polluzhë, edhe pse ka filluar punimet që dy vjet, ende nuk është kompletuar, ndërsa nga segmenti Polluzhë – Drenas – Komoran as që ka filluar të zgjerohet, sepse nuk kemi ende asnjë procedurë të zhvilluar për këtë segment.

Pyetja ime është:

-Zoti ministër, deri kur pritet të përfundojë segmenti rrugor nga Klina e Epërme – Skenderaj – Polluzhë dhe kur pritet të fillojë ndërtimi apo zgjerimi i segmentit rrugor Polluzhë – Drenas – Komoran?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Zharku, e keni fjalën!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,

Ministra,

Deputetë,

I nderuar deputet Avdyli,

Ministria e Infrastrukturës projektin e zgjerimit të rrugës regjionale Komaran – Skenderaj, segmenti Klinë e Epërme – Skenderaj – Polluzhë, në gjatësi prej 13,01 kilometër, e ka ndarë në shtatë lote apo nëntë segmente dhe ka kontraktuar 7 kompani.

Procedura tenderuese dhe kontratat tani lihen në pjesën e dytë të vitit 2014, kurse ndërtimi i urës mbi lumin Klinë, në segmentin Klinë e Epërme – Morinë është kontraktuar vitin e kaluar.

Kostoja totale e kontratave është 14.338.091 euro e 45 centë.

Për pjesën e kontraktuar në gjatësi prej 13 kilometrave, Ministria e Infrastrukturës fillimisht e ka pranuar projektin nga Komuna e Skenderajt, në bazë të cilit ka iniciuar procedurat e prokurimit.

Projekti i pranuar nga Komuna e Skenderajt nuk ka pasur elaborat të shpronësimit që ka ndikuar në problemet me banorë gjatë ekzekutimit të punimeve.

Po ashtu problem tjetër ka qenë ofrimi i zgjidhjeve teknike, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në projektin zbatues.

Ministria e Infrastrukturës vitin e kaluar ka nënshkruar kontratën për hartimin e elaboratit të shpronësimeve dhe të njëjtin e ka dorëzuar në fillim të këtij viti për procedura të mëtejshme në Ministrinë e Ambientit.

Në përputhje me elaboratin e shpronësimit, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 13 maj 2016 ka aprovuar vendimin për shqyrtimin e kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme në zonat kadastrale Klinë e Epërme, Klinë e Mesme, Klinë e Poshtme, Skenderaj, Novosellë, Polac i Vjetër, Krushevc, Polac i Ri, Llaushë dhe Polluzhë.

Me vendimi e Qeverisë për shpronësim kompanitë e kontraktuara kanë filluar të punojnë me kapacitet të plotë dhe ky projekt pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2016, nën kushtin që sigurohen edhe 2.036.000.000 euro mbi buxhetin e paraparë për këtë vit.

Më 19 maj, së bashku me nënkryetarin e Komunës së Skenderajt, zotin Fadil Nura, kam vizituar segmentin e rrugës, ku janë duke u zhvilluar punimet si dhe kemi pasur takime me disa prej banorëve, pronat e të cilëve preken nga zgjerimi....

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Ju lutem, ia vazhdoni mundësinë për sqarim ministrit!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: ...i rrugës, në mënyrë të kërkohe mirëkuptim për lejin e zhvillimit të punimeve deri sa nuk përfundojnë të gjitha procedurat e shpronësimit dhe në shumicën e rasteve ky mirëkuptim nuk ka munguar.

Sa i përket pjesës së mbetur nga fshati Morinë deri në kycjen e rrugës rajonale, në rrugën nacionale Prishtinë – Pejë, është duke u hartuar projekti kryesor, i cili do të përfundojë gjatë këtij viti.

Natyrisht, vazhdimi i zgjerimit të kësaj pjese të rrugës në rend të parë varet nga sigurimi i mjeteve financiare gjatë viteve të ardhshme si dhe kohëzgjatjes së procedurave të shpronësimit, që nuk janë nën autoritetin e Ministrisë së Infrastrukturës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti deputet? Nuk ka. Zonja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Unë pyetjen e kam parashtruar në seancën e kaluar. Ministri nuk ka qenë prezent. Duhet të jem reale, të tregoj se ministri Rrahmani u është përgjigjur pyetjeve, së paku pyetjeve që ia kam bërë unë nga lëmi i shëndetësisë.

Mirëpo, kur e pashë se nuk është prezent në seancën e kaluar, mendova që edhe ky paska filluar të bëhet sikur kolegët e vet, se thonë – me ata që rri, ashtu edhe bëhesh.



Prandaj, për atë edhe e parashtrova pyetjen, të cilën e keni marrë, ka të bëjë me punëtorët e sigurimit të Spitalit regjional të Gjilanit.

Siç jeni në dijeni, kanë qenë në grevë në muajin e kaluar për dy javë. E dini se ne kemi pasur vështirësi të ushtrijmë si funksionin e mjekut, e po ashtu kanë pasur vështirësi edhe pacientët, sidomos Departamenti për nëna dhe fëmijë, kur dihet se ky departament gjendet në afërsi të Spitalit psikiatrik të Gjilanit.

Prandaj, mungesa e këtyre punëtorëve ka shkaktuar probleme në këtë spital, mirëpo ajo që është e rëndësishme dhe që po dua të cek edhe këtu është se këta punëtorë, që edhe ju e dini, marrin paga minimale, po edhe ato që i kanë si paga minimale nuk i marrin në kohën e caktuar. Nuk u paguhet trusti pensional që 6 vjet, nuk u paguhet orët e tepërta jashtë orarit të punës, nuk u paguhet orët e natës, prandaj ministër, jo vetëm të jepni përgjigje, por shpresoj se do të bëni zgjidhje në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Urdhëroni, zoti ministër Rrahmani e ka fjalën!

IMET RRAHMANI: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete, zonja Baftiu,

Është e vërtetë që s'kam mundur të përgjigjem në seancën e kaluar sepse po atë ditë ka korresponduar koha me fillimin e një procesi shumë të rëndësishëm në sistemin tonë shëndetësor, që për herë të parë po bëhet pas 16 vjetëve, e që është procesi i rilicencimit të punëtorëve shëndetësorë sipas kritereve.

Ju them që më 24 maj 2000 ka skaduar licenca e parë e profesionistit shëndetësor të licencuar në mënyrë të rregullt dhe që atëherë validiteti i licencave është vazhduar me vendime të ministrave.

Për pyetjen konkrete, unë mund të ju them këtë: Privatizimi i shërbimit të sigurimit fizik në objektin e Spitalit Rajonal të Gjilanit, tash spitalit të përgjithshëm, është bërë në vitin 2005.

Prej atëherë, Spitali i Gjilanit ka kontraktuar kompani të ndryshme nëpërmjet procedurave të rregullta të kontraktimit ashtu siç e parasheh ligji.

Në kohën e kontraktimit si shenjë mirësjelljeje dhe mirëkuptimi ka pasur një pajtim që kompanitë ta përmbushin kontratën me punëtorët ekzistues, kuptohet derisa ata u përmbahen rregullave dhe obligimeve të punës, kjo edhe ka ndodhur.

Spitali e ka pasur obligim ta mbikëqyrë përmbushjen e kontratës dhe t'i shlyej me kohë obligimet karshi kompanisë, sikur që kompania i ka obligimet e veta karshi spitalit dhe punëtorëve të saj, e që gjithashtu kjo rregullohet me ligje tjera, e që i tejkalojnë kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe ministrit të Shëndetësisë.

Edhe shumë herë më përpara ka pasur kërkesa dhe ankesa nga të dyja palët. Punëtorët, tash jo më punëtorë të spitalit, për mospërmbushjen e obligimit të kompanisë ndaj tyre, por edhe ....

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Kthejani ministrit fjalën!

MINISTRI IMET RRAHMANI: obligimeve nga ana e ndonjë punëtori.

Punëtorët e sigurimit asnjëherë nuk e kanë kuptuar se nuk mund ta konsiderojnë veten si punëtorë të spitalit dhe drejtimi i ankesave të tyre për mosrealizimin e të drejtave që dalin nga Ligji i punës duhet t'i bëhen Inspektoratit të Punës dhe gjykatës, në rast nevojë.

Megjithatë, menaxhmenti i spitalit shpesh ka ndërmjetësuar në zgjidhjen e kontesteve ndërmjet kompanisë dhe këtyre punëtorëve që përfaqësohen nga një sindikatë e pavarur, por jo nga Sindikata e Shëndetësisë.

Kërkesat e fundit për ngritje të pagave, pagesa e kontributeve pensionale e të tjera duhet adresuar diku tjetër, e jo në Ministrinë e Shëndetësisë.

Të gjithë ish të punësuarit në sistemin shëndetësor duhet ta kuptojnë një herë e përgjithmonë se kthimi në listën e pagave në spital nuk ka mundësi të ndodhë. Sidomos në situatën kur çdo i pesti i punësuar në sektorin e shëndetësisë është punëtor joshëndetësor.

Sidomos në situatën kur ne kemi nevojë t'i sistemojmë edhe mbi 120 specialistë të papunë e brenda 3-4 vjetëve do t'i kemi 1 000 të pa punë. Sidomos në situatën që do ta përjetojmë, siç thashë pas disa viteve, kur do të specializojnë këta specializantë, që janë në përfundim të specializimit. Dhe, sidomos në kohën kur sistemi shëndetësor ka nevojë për punësim edhe të një numri shumë më të madh të infermierëve dhe mjekëve, se sa të punëtorëve ndihmës.

E nderuar deputete,

Unë ndihem mirë shumë në këtë Kabinet qeveritar dhe ndihem mirë si LDK-ist.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftiu, keni pyetje shtesë?

BESA BAFTIJA: Faleminderit!

Ministri tha se Ministria e Shëndetësisë nuk është përgjegjës për këta punëtorë, por, në anën tjetër, tha se kontraktimi i kontratës ndërmjet kësaj kompanie private dhe Spitalit të Përgjithshëm është bërë ndërmjet kompanisë private dhe Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit, e Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit nën menaxhimin e kujt është, ministër?

Siç e dini, kontrata të cilën e ka nënshkruar kompania private me Spitalin e Gjilanit, kompania private nuk është duke e përmbushur këtë kontratë, janë duke u shkelur të drejtat elementare të njeriut, e lëre më të punëtorit.

Siç e dini ministër, e di shumë mirë për Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, keni qenë edhe vetë ju punëtorë aty dhe e dini, në çfarë masash dhe në çfarë kushtesh punojnë këta punëtorë, po ashtu ka diskriminime, e ka të tillë punëtorë që punojnë edhe në sektorin publik, siç është rasti edhe me kompaninë e pastrimit.

Punëtorët të cilët janë të privilegjuar të...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe gjysmë minute, përbylle diskutimin!

BESA BAFTIJA: ...Ka punëtores të pastrimit të cilat punojnë në shërbimet publike që janë tash të privilegjuarit e menaxhmentit, e që marrin paga mbi 370 euro, ndërsa punëtorët e pastrimit që e bëjnë të njëjtën punë marrin pagë 170 euro, e ky është diskriminim.

Prandaj, për një gjë të tillë duhet të bëni zgjidhje sa më shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Edhe Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit menaxhohet nga Shërbimi Spitalor Klinik-Universitar, që gjithashtu është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe gjithashtu ju them që spitali ka pasur kujdes që ta vështrojë dhe ta mbikëqyrë përmbushjen e kontratës. Të gjitha shkeljet tjera që dalin nga Ligji i punës duhet t'i trajtojë dikush tjetër, e jo Ministria e Shëndetësisë.

Për nivelin e pagës të punëtorëve ne nuk kemi vendosur dhe nuk vendosim. Përmbushja e kontratës, sigurimi i shërbimeve fizike ka ndodhur edhe me intervenimin e Shërbimit Spitalor Klinik-Universitar derisa është zgjidhur problemi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftiu, pyetje tjetër për ministrin Imet Rrahmani. Zonja Baftiu e keni fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit!

Pyetja tjetër ka të bëjë me sigurimet shëndetësore. Qytetarët e Republikës së Kosovës që nga viti 2007, kur për herë të parë në Kuvend është aprovuar Ligji për sigurime shëndetësore, u janë përmendur shumë data për fillimin dhe zbatimin e tij.

Derisa në atë kohë dihen shkaqet pse nuk u nënshkrua nga shefi u UNMIK-ut, tani që kaluan 2 vjet prej se ky ligj ka kaluar në Kuvend, ende nuk po zbatohet. Këtë më së shumti po e ndiejnë shumica e qytetarëve të Republikës së Kosovës e sidomos kategoritë të cilat janë më të veçanta, e që janë me asistencë sociale e të tjerë.

Ministër, pyetja ime është konkrete: Kur qytetarët e Republikës së Kosovës do të kenë sigurime shëndetësore dhe shërbime më të mira shëndetësore?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Ligji i shëndetësisë dhe Ligji për sigurime shëndetësore kanë krijuar bazë ligjore për fillimin e përgatitjes për funksionalizimin e Agjencisë së Financimit Shëndetësor dhe për zhvillimin e infrastrukturës ligjore dhe teknike për shndërrimin e kësaj agjencie në Fond për Sigurime Shëndetësore.

Për t'i realizuar detyrat e dhëna nga ligjet e sipërpërmendura, Ministria e Shëndetësisë fillimisht ka përgatitur rregullore të brendshme të Agjencisë së Financimit Shëndetësor, e cila më pas është aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe mbi bazën e kësaj rregulloreje është duke plotësuar AFSH me resurse humane.

Aprovimi në Qeveri i Rregullores për Këshillin Përgatitor për themelimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore ka krijuar parakusht për themelimin e Këshillit, i cili tani mbanë takime të rregullta mujore dhe është duke i udhëhequr të gjitha aktivitetet drejtë themelimit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Me qëllim të dinamizmit të aktiviteteve përgatitore në janar të vitit 2016, Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë e ka organizuar një punëtori me çrastë është përgatitur një plan i detajuar për themelimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Ky plan është nda në dy faza: Faza e parë ka të bëjë me mbledhjen e premieeve, ndërsa faza e dytë me zhvillimin e tërësishëm të fondit të sigurimeve shëndetësore, përkatësisht me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore teknike, infrastrukturore dhe kontraktimin e shërbimeve me institucione shëndetësore.

Të nderuar,

Në kuadër të këtij plani, Ministria e Shëndetësisë e ka përfunduar instalimin e softuerit të sistemit të themelimit të fondit dhe janë testuar të gjitha modulet e tij.

Ekipet e Ministrisë së Shëndetësisë i kanë përfunduar aktivitetet për lidhjen e sistemit të informimit të fondit me Agjencinë e Regjistrave Civile, ATK-në, Thesarin, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për regjistrat e skemave sociale dhe Bankën Qendrore të Kosovës....

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Zgjatjani diskutimin ministrit!

**MINISTRI IMET RRAHMANI:** Po ashtu, në përkrahje të plotë nga ATK-ja, Thesari dhe Banka Qendrore, ekipet e Ministrisë së Shëndetësisë i kanë përgatitur të gjitha biznes-proceset për fillimin e mbledhjes së premieeve dhe në detaje janë definuar mënyra e deklarimit dhe e pagesës së kontributeve për sigurim shëndetësor për bizneset, të vetëpunësuarit, për të papunët, si dhe është definuar mënyra e pagesës së kontributeve për të punësuarit në sektorin publik.

Vendimi për fillimin e mbledhjes së premieeve duhet të merret nga Qeveria, ndërsa ne do të kërkojmë marrjen e këtij vendimi sapo t'i kemi përfunduar aktivitetet përgatitore.

Në planin legjislativ për vitin 2016 është paraparë edhe nxjerrja e Udhëzimit administrativ, i cili e rregullon qytetarët dhe banorët e liruar nga bashkëfinancimi, si dhe Rregullorja për menaxhimin financiar të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Statuti i fondit është duke u punuar dhe aprovimi i tij nga Qeveria nënkupton edhe themelimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Për të themeluar fonde të sigurimeve shëndetësore duhet kaluar një proces tejet kompleks, në të cilën përpos agjencive qeveritare duhet të përfshihen edhe qytetarët e vendit, prandaj, në këtë kontekst, Ministria e Shëndetësisë me qëllim të informimit të plotë të qytetarëve për të drejtat dhe obligimet karshi fondit, është duke e përgatitur një strategji informimi, e cila së shpejti do të fillojë së zbatuari, ndërsa për përgatitjen e saj janë duke u koordinuar aktivitetet me Administratën Tatimore dhe Projektin e shëndetësisë kosovare të Bankës Botërore.

Fondet e grumbulluara në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore nga mbledhja e premieeve do të përdoren për rimbursimin e barnave në fillim dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve për diagnostifikim dhe trajtim në të gjitha nivelet.

Gjithsesi deri në funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore duhet tejkalluar disa sfida, siç janë: numri i kufizuar i punëtorëve në AFSH, data-qendra në Ministrinë e Administratës Publike duhet të ofrojë 24 orë në 7 ditë dhe 365 ditë në vit shërbim pa ndërprerje.

Pastaj sfidues është numri i kufizuar i stafit në data-qendër për ta mbuluar këtë shërbim 24 orë. Numri i kufizuar i stafit në ATK për t'i mbuluar nevojat për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe vonesat në implementimin e fazës së dytë të sistemit të informimit shëndetësor.

Ne si Ministri e Shëndetësisë jemi para finalizimit dhe muaji qershor është muaji kur ne teknikisht përgatitemi për fillimin e mbledhjes së premieeve.

Këshilli përgatitor për funksionalizimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore do të marrë vendim për propozim në Qeveri, e Qeveria do t'i analizojë të gjitha rrethanat, të gjitha mundësitë dhe do të marrë vendim për datën e fillimit të mbledhjes së premieeve.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetje shtesë, zonja Baftiu?

BESA BAFTIU: Faleminderit!

Pyetja ime ishte konkrete. Unë e kërkova nga ministri datën e fillimit se kur qytetarët do të kenë sigurime shëndetësore. Edhe pse ai i dha disa argumente apo sqarime rreth asaj se pse nuk kemi sigurime deri më tash, ajo që më bën ta pyes prapë ministrin dhe të di, e që nuk është e mundur të bëhen sigurimet shëndetësore nëse nuk e kemi sistemin informativ shëndetësor, me licencim paskeni filluar, e dihet se prej vitit 2000 nuk kemi licenca, por ky është një fillim i mbarë, mirëpo duhet ta kemi sistemin informativ shëndetësor, e më pastaj të kemi edhe sigurime shëndetësore.

Është një frikë te popullata, sepse vetëm do të mblidhen premiumet, do t'u merren paratë, sepse siç dihet Qeveria është në krizë, ndërsa nuk dihet se çfarë sigurie, çfarë shërbimesh shëndetësore do të përfitojnë këta qytetarë.

Prandaj, dua ta di konkretisht, përveç që thatë se do të filloni me mbledhjen e premieeve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Mos ua ndërprit, ta përfundojnë diskutimin. Janë pyetje që duhet dhënë kuptim dhe përgjigje...

BESA BAFTIJA: ...vetëm me shërbime... Çfarë shërbimesh? A do të përmirësohen shërbimet shëndetësore me fillimin e sigurimeve shëndetësore? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, urdhëro!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!

E kam thënë edhe disa herë publikisht që është projekt, i cili e reformon sistemin tonë shëndetësor në bazën e tij në kuptimin e plotë është sistemi i informimit shëndetësor.

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore është një hallkë e reformimit të sistemit tonë shëndetësorë që e krijon një stabilitet financiar të sistemit tonë dhe një qëndrueshmëri në financa.

Mirëpo, funksionalizimi i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore nuk do të krijojë mrekulli në sistemin tonë shëndetësorë, sepse sistemi i formimit shëndetësor është baza e grumbullimit të dhënave, baza e marrjes së informatave nga terreni dhe mbi bazën e këtyre dhe planifikimet më të mira.

Mirëpo, prapë mund të them se mund të fillohet Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, sepse e kemi njërin nga modulet e sistemit të informimit shëndetësor - sistemi i informimit të fondit, dhe mund të fillohet edhe pa sistemin e informimit shëndetësor.

Gjithashtu, mund të themi që Ligji e përcakton se cilat janë shërbimet që do të merren nga të siguruarit, ose cilat janë shërbimet që të gjithë të siguruarit do t'i kenë të garantuara. Do të jetë lista esenciale e shërbimeve shëndetësore, e cila është dinamike dhe çdo vit, me vendim të Qeverisë ndryshon, rriten shërbimet, ose zvogëlohen shërbimet. Gjithashtu, sikur që lista e çmimeve është dinamike dhe varësisht prej mundësive të fondit dhe nevojave të qytetarëve, gjithmonë me vendim Qeverie, çdo vit adaptohet ose akomodohet nevoja dhe mundësia.

Shërbimet shëndetësore do të jenë gjithnjë e më të mira sikur që ka ndodhur përmirësimi ndër vite dhe duhet ta kuptojmë një herë e përgjithmonë se mund të ketë një fillim këtu kur proklamohet një reformë në shëndetësi, por reforma në shëndetësi është proces dinamik dhe është e gjithhershme, sepse gjithmonë ka nevojë që të përmirësohemi në shëndetësi.

Sistemi ynë shëndetësor gjithnjë e më shumë është duke dhënë shërbime më të mira shëndetësore për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka pyetja e zotit Salih Salihu, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Unë në fakt pyetjen e kam bërë në seancën e kaluar, por po e përsëris në pika të shkurtra.

Zoti ministër, çështja është se unë këtu po i sjell shqetësimet e qytetarëve të komunës së Vitisë për faktin se ata nuk janë të kyçur në autostradën Prishtinë - Hani i Elezit, por duhet nga pika e Grizës të kthehen diku rreth 3 kilometra.

Dhe pyetja, zoti ministër është si është e mundur që një komunë, e cila i ka rreth 60 mijë banorë dhe i ka rreth 40 fshatra të mos ketë kyçje, kur dihet se autostrada është ndërtuar, dhe themi se do të shpenzohen 600 milionë euro dhe gjithnjë arsyetohet se autostrada do të jetë në interes të qytetarëve, ndërkaq një komunë e cila i ka rreth 40 fshatra nuk ka kyçje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Zharku, e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar nënkryetar,  
Ministra, të nderuar deputetë,  
I nderuar deputet Salihu,  
Ministria e Infrastrukturës, siç e dini, është duke e realizuar projektin e ndërtimit të autostradës R6 në bazë të kontratës së lidhur në korrik të vitit 2014 me konsorciumin “Bechtel&Enka” dhe punimet janë duke u ekzekutuar në bazë të projektit zbatues të përgatitur nga ky konsorcium.

Projekti është punuar sipas standardeve TEM, përkatësisht autostradave trans-evropiane me sistem të mbyllur për shpejtësi projektuese 120 deri 140 kilometra në orë, me shpejtësi maksimale të kufizuar prej 130 kilometrash në orë.

Gjatë fazave të projektimit të trasesë së autostradës janë punuar raportet te ndikimi social dhe mjedisor si dhe është bërë studimi i fizibilitetit për trasenë e autostradës.

Në bazë të standardeve evropiane për autostrada, kyçjet duhet të jenë të projektuara në distanca jo më të vogla se 20 deri 30 kilometra.

Megjithatë, në vendin tonë, duke marrë parasysh gjatësinë e tërë autostradës prej 60 kilometrash, projektuesi është përpjekur që ta gjejë zgjidhjen më të mirë për kyçje të popullatës duke e shkurtuar këtë distancë në 8,5 kilometra në mes të udhëkryqit që lidh autostradat “Ibrahim Rugova” dhe “Arbër Xhaferi” me kryqin . e Lipjanit dhe gjatësi prej 10,5 kilometrave në mes kyçjes Bibaj të Ferizajt dhe Doganave të Kaçanikut.

Natyrisht, besoj se pajtohesh që është e pamundur që traseja e autostradës t’i përfshijë në kyçjet e parapara të gjitha komunat dhe vendbanimet që gravitojnë në korridoret e autostradës.

Siç po e shihni, distanca në mes të kyçjeve është aq e shkurtë, sa që çdo zvogëlim i mëtejshëm do të rrezikonte seriozisht mbajtjen e standardeve minimale të pranueshme për autostradat evropiane, si dhe përfshirjen e kësaj rruge në rrjetin bazë evropian.

Më lejoni të theksoj se të gjitha kyçjet e autostradës janë të lidhura me rrjetin e rrugëve nacionale dhe regjionale, si dhe kanë qenë të parapara me projektin fillestar nga kompania EGIS International, i cili ka përfunduar në vitin 2010.

Sa i përket lidhjes së komunës së Vitisë, ajo ka mundësi të qasjes në kyçjen e Ferizajt dhe atë të Doganajt nëpërmjet rrjetit të rrugëve ekzistuese rajonale.

Megjithatë, Ministria ka filluar ta përgatisë një projekt për rehabilitimin e të gjitha rrugëve lokale të cilat e shkurtojnë këtë distancë në mes të kyçeve Bibaj dhe Doganaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Salihu?

SALIH SALIHU: Unë i kuptoj domethënë standardet evropiane, zoti ministër, por Kosova e ka një dendësi bukur të madhe të banorëve, por edhe të qyteteve dhe fshatrave. Është zvogëluar domethënë prej 20 deri 30 kilometra sa e japin standardet e BE-së, e keni bërë diku 8,5 kilometra distancën ndërmjet dy pikave.

Por, zoti ministër, çështja është tash që ju jeni vetë ministër, jeni po ashtu nga LDK-ja, edhe kryeministri është nga LDK-ja, unë mendoj se ka mundësi që të shqyrtohet disi mundësia për ta bërë një lidhje, ndoshta jo të formatit të unazës siç po ndërtohet atje në Doganaj, por një lidhje ndoshta pak më të thjeshtë, në mënyrë që ta kemi një lidhje direkte.

Është e qartë që ekzistojnë rrugët, zoti ministër, por kjo është e kushtueshme që të kthehen qytetarët tre kilometra prapa dhe pastaj tre të tjerë për ta vazhduar rrugën janë 6 kilometra humbje për qytetarët e komunës së Vitisë, e edhe rrugët që janë ekzistuese nuk çojnë direkt në autostradën që e kemi, se ka shumë kthesa dhe rrugët nuk janë shumë të përshtatshme për lidhje të shpejtë në autostradë.

Prandaj, në të ardhmen ose të parashihen rrugë që çojnë direkt në Gërlicë te pika e Doganës, ose një rrugë Viti që çon direkt në Sojevë, atje ku është pika në Ferizaj, ose t'i mundësohet komunës së Vitisë një lidhje më e thjeshtë e formatit më të vogël se a që jeni duke e planifikuar unazën me Doganaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Zharku e keni fjalën.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti deputet, në parim pajtohem, të mos themi është e pamundur, por distanca në mes të rrugës në Gërlicë që shkon për Viti dhe kyçje në Bibaj është vetëm 3 kilometra. Të jemi të sigurtë, është e pamundur për ta bërë ta bëjmë edhe një kyçje në atë vend, kurse në anën tjetër ajo që e përmenda dhe ju që jeni pro asaj, ne do të përpiqemi që ta shkurtojmë distancën mes rrugëve lokale ose rrugëve të reja, ose rehabilitimin e rrugëve aktuale, që na çojnë drejt në kyçje në Bibaj, apo që çojnë drejt në kyçjen në Doganaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Arban Abrashi. Zonjës Mustafa fjalën, ju lutem!

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
I nderuar ministër,



Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe të Pagjeturit gjatë monitorimit të zbatimit të Ligjit për parandalimin e dhunës në familje dhe gjatë takimit me përfaqësuesit e strehimoreve ka ankesa se këto strehimore po rrezikojnë të mbyllen në mungesë të buxhetit.

Zoti ministër, në raportin e Qeverisë, të miratuar në seancën e 25 majit, është thënë se tetë OJQ strehimore që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje janë mbështetur me 350 mijë euro për vitin 2015.

I nderuar ministër,

Si është ndarë kjo shumë e mjeteve, cilat kanë qenë kriteret në ndarjen e këtyre mjeteve dhe a janë trajtuar njësoj të gjitha strehimoret. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abrashi, e keni fjalën.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

E nderuar deputete Mustafa,

Në bazë të kontratës për blerjen e shërbimeve, këto strehimore, këto OJQ janë mbështetur më 2 500 euro në muaj për secilën, pagesë e cila është bërë në bazë të numrit të viktimave.

Po ashtu, me një vendim të ish-kryeministrit të vitit 2014, këto OJQ kanë pranuar shumë të mjeteve 18 750 euro në dhjetor të vitit 2014, shumë e cila është shpenzuar për 13 muaj, duke filluar nga viti 2014 deri në dhjetor të vitit 2015.

Pra, shumta e përgjithshme e mbështetjes buxhetore, që e kanë pranuar këto OJQ për zbatimin e projekteve për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit ka qenë në total 350 mijë euro për të gjitha ato.

Lidhur me shqetësimin tuaj, kontrata aktuale me këto OJQ përfundon më 31 korrik 2016.

Prandaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale vetëm se i ka filluar procedurat për të bërë thirrje në kuadër të projekt-propozimeve për këto OJQ, në mënyrë që ta planifikojë koston buxhetore dhe të bëjë mbulesën e buxhetit dhe pagesën e projekteve deri në fund të vitit 2016, duke filluar nga gushti deri në dhjetor.

Përpos kësaj, ne e kemi filluar një iniciativë dhe kemi dhënë propozime në kuadër të plotësimit të Ligjit për financa lokale, në mënyrë që secila komunë ashtu siç e merr grantin specifik për shëndetësi dhe arsim, ta marrë edhe grantin specifik për shërbime sociale.

Po ashtu, siç dihet këto kompetenca janë deleguar në komuna, por nuk është përcjellë me ngritje të kapaciteteve, apo me buxhet të specifikuar për shërbime sociale. Ideja themelore, në mënyrë që ta qetësojmë situatën dhe ta rregullojmë sferën financiare, ose përkrahjen financiare për këto

OJQ që ofrojnë shërbime sociale është të ndajmë grant specifik apo buxhet të veçantë për këto kategori, ose për shërbime sociale.

Besoj që derisa të kalojë ky ligj, e besoj që do të kalojë, sepse kemi hasur edhe në mirëkuptim nga vetë ministri i Financave, ne do ditë shkojmë nëpërmjet blerjes së shërbimeve, të cilat do t'i fillojmë tani në fund të korrikut, në mënyrë që ta mbulojmë pjesën e mbetur për këtë vit. Domethënë, çka mund të sigurojmë është se këto OJQ nuk do të mbeten pa përkujdesje ose pa përkrahje financiare, por edhe unë vetë nuk jam i kënaqur me këtë përkrahje financiare, sepse po bëhet në bazë të projekt-propozimeve, ideve apo numrit të viktimave që janë. Ne synojmë që nëpërmjet plotësim-ndryshimit të Ligjit për financa lokale ta kemi një grant specifik për shërbime sociale, në mënyrë që çështja e përkrahjes financiare për të gjitha OJQ, jo vetëm për këto, qoftë për shërbime sociale, të rregullohet njëherë e përgjithmonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Mustafa?

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit ministër për përgjigjen!

Është shumë domethënëse kjo që e thatë, sepse është e vërtetë që në fillim të qershorit përfundojnë këto projekte, por ju kisha lutur që Ligjin për financa lokale ta sillni sa më shpejt, sepse në komuna ka problem duke pasur parasysh faktin se është vullnet i komunave nëse duan të nënshkruajnë memorandume bashkëpunimi me këto strehimore dhe problemi tjetër është që strehimoret janë rajonale dhe ka komuna që nuk u përgjigjen ftesave të këtyre strehimoreve.

Besoj që ky problem do të zgjidhet shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mexhide Mjaku, pyetje për ministrin Abrashi.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Përshëndetje, kryesues!

Ministra, deputetë,

Çështja që desha ta paraqes para jush dhe që i ishte drejtuar zotit ministër të Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotit Arban Abrashi, ishte pikërisht çështja e mbylljes së strehimoreve, shtëpi që kujdesen për gratë, viktimat të dhunës në familje, dhe unë e mora një përgjigje se ju jeni në proces duke punuar dhe i keni filluar procedurat, duke bërë thirrje për ndihmë, për mosmbyllje të OJQ-ve.

Unë do të kërkoj nga ju të di nëse keni bërë kërkesë në Ministrinë e Financave, apo në Ministrinë e Pushtetit Lokal, kujt i jeni adresuar dhe...

*(Ndërprerje e incizimit)*

KRYESUESI: Atëherë, vazhdojmë! Ministrat paskan shkuar! Zoti Abrashi, besoj se do të kthehet, ose i lëmë pyetjet për seancën e ardhshme dhe vazhdojmë me këto të njëjtat pyetje.

Pra, meqenëse është shteruar koha e pyetjeve... Nëse doni, i kryejmë.

*(Ndërrhyrje)*

Po disa ishin këtu, por kryesisht kanë qenë Hoti, Skenderi s'është. Memli e Skenderi s'kanë qenë. Arban Abrashi ishte këtu. Abdullah Hoti ishte këtu. Arban Abrashi, këtu, Kujtim Shala nuk ishte. Për këta, kanë qenë pyetjet. Dhe si të doni e nëse doni, i presim dhe për mua s'ka ndonjë problem. Mirëpo, po them, më mirë i lëmë për seancën e ardhshme.

Regjia, i bini ziles, le të kthehet dikush. Ministri e vazhdon përgjigjen siç ishte më parë duke e bërë. Urdhëroni, zoti Abrashi!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, zonja deputete!

I nderuar nënkryetar,

Deputetë,

Ashtu siç e specifikuam në përgjigjen e mëhershme, kontrata për blerjen e shërbimeve në kuadër OJQ-ve përfundon më 31 korrik 2016, prandaj Ministria do t'i fillojë procedurat që të vazhdojë blerjen e shërbimeve nga këto OJQ edhe pas kësaj periudhe, deri në fund të vitit.

Ajo çka po punojmë është se së bashku është mënyrë që të gjejmë një zgjidhje të përhershme, sepse ajo çfarë ka ndodhur pas decentralizimit është se këto kompetenca janë bartur në nivel komunal, por nuk është përcjellë me ngritje të buxhetit apo bartje të buxhetit, plus ngritje të kapaciteteve për të gjithë ata që i ofrojnë shërbimet.

Ideja themelore është që të krijojmë, ashtu siç ekziston, një grant specifik për arsim dhe një grant specifik për shëndetësi dhe ne si Ministri synojmë të fusim në projekt-propozim, që tashmë ka filluar debati i brendshëm në kuadër të plotësim-ndryshimit të Ligjit për financa lokale, të cilën e udhëheq Ministria e Financave, të kemi edhe grantin specifik për shërbime sociale.

Ne si Ministri i kemi dhënë idetë tona dhe jemi pjesë e grupit punues. Gjatë kësaj kohe kemi punuar drejtpërdrejt edhe me Ministrinë e Financave, edhe me asociacionin e komunave, edhe me organizatat e tjera ndërkombëtare, posaçërisht me UNICEF-in në mënyrë që të gjejmë formulat më të mira se si kishte me qenë formula dhe granti specifik për secilën komunë, sepse dallojnë edhe shërbimet sociale nëpër komuna.

Ajo çka ndodh në terren është se shpeshherë një numër i madh i OJQ-ve ose strehimoreve, në këtë rast, apo OJQ-ve të tjera që ofrojnë shërbime sociale është se veprojmë në bazë të regjionit. Prandaj është shumë e vështirë që të marrim një grant specifik, i cili thotë se 5% do të jetë granti në tërësi, por ajo çka po punojmë ne është që të bëjmë hulumtimet, të cilat tashmë i kemi filluar së bashku me UNICEF-in dhe organizatat e tjera që të shohim se cila komunë çfarë ofron dhe të kemi së paku një pamje të terrenit se kush çfarë ofron, e mandej, varësisht se çfarë është numri i klientëve ose i vetë shërbimi që e ofron, ta zëmë Komuna e Pejës edhe për komunat në atë regjion, le t'i ndajmë në shumë më të madhe për komunën e Pejës, duke përfshirë edhe regjionin dhe grant më të vogël për komunat e tjera, të cilat mund të marrin shërbime në ndonjë qendër regionale.

Ajo çka nevojitet tash është përkrahja juaj, deputetë, që kjo të kalojë. Pra, edhe nëse s'ka buxhet për vitin e ardhshëm, ideja themelore është që të futet në ligj dhe të jetë grant specifik për shërbime sociale dhe besoj që gjatë viteve në vijim, edhe do të sigurojmë buxhetin për këto shërbime. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Avdullah Hoti. Ministri nuk është këtu dhe mbetet pyetja t'i bëhet tjetër herë.

Deputeti Salih Salihu, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër, kjo është hera e tretë që brenda një viti e gjysmë e kam ngritur çështjen e pensioneve të shtetasve të Kosovës që janë pensionuar në Zvicër, por që nuk po i marrin pensionit për shkak të procedurave administrative që duhet t'i përmbushë Ministria që ju e drejtoni.

Në përgjigjen tuaj të fundit patët premtuar se kjo çështje do të rregullohet brenda një muaji. Nga ajo kohë kanë kaluar 8 muaj, e pensionet ende nuk po u vinë qytetarëve tanë, pa fajin e tyre.

Zoti ministër,

Më njoftoni ku keni arritur me këto çështje dhe kur saktësisht pensionistët do t'i marrin pensionet e tyre të merituar nga Zvicra, e që nuk po i marrin për shkak të neglizhencës së Ministrisë që ju po e drejtoni.

KRYETARI: Urdhëroni, i nderuar ministër!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit!

Faleminderit, kryetar,

Ministra,

Deputetë,

Faleminderit për pyetjen, zoti Kurteshi!

Të gjithë ata që e njohin natyrën e sigurimeve apo marrëveshjeve ndërshtetërore sa i përket sigurimeve shëndetësore, sigurimeve pensionale dhe çështjeve të pensioneve, e dinë kompleksitetin e kësaj çështjeje.

Prandaj, për atë që kam thënë, unë u qëndroj fjalëve të mia, dhe kjo nuk ka të bëjë me përmbushjen e çështjeve administrative, si e thoni ju, por ka të bëjë me ndërprerjen e njëanshme nga shteti i Zvicrës të marrëveshjes së vitit 2010 dhe nuk është punuar në këtë drejtim për kohë të gjatë.

Ajo që kemi bërë ne me marrjen e mandatit është se kemi filluar menjëherë negociatat me shtetin e Zvicrës përmes ambasadës, por edhe kontakteve direkte dhe ka pasur lëvizje pozitive në këtë drejtim, në mënyrë që të sigurojmë shtetin e Zvicrës se administrata ose sistemi pensional i Kosovës është i gatshëm t'i përmbushë kërkesat e shtetit të Zvicrës sa i përket kërkesave të tyre në shumë sfera, edhe të çështjes administrative.

Për të siguruar këtë, ne kemi nënshkruar për herë të parë një marrëveshje me shtetin e Zvicrës sa i përket fushës së pensioneve dhe kjo është marrëveshje testuese. Kjo marrëveshje testuese mbaron në gusht të këtij viti dhe, sipas informatave të fundit që ne i kemi, meqë e përcjellim situatën në baza, të mos them në baza javore, por në baza mujore, patjetër rezultati dhe vlerësimi do të jetë pozitiv.

Pas këtij vlerësimi pozitiv, ne besoj që do të ulemi dhe do ta hartojmë marrëveshjen e përgjithshme sa i përket fushës së pensioneve.

Për të gjithë këtë, ne duhet t'i sqarojmë deputetët dhe qytetarët e tjerë se ka shtete në regjion që për këtë, edhe për marrëveshje testuese, por edhe marrëveshje të përgjithshme në fushën e pensioneve presin deri në dhjetë vjet. Pra, shtetet e regjioneve, posaçërisht me Zvicrën ka shtete që prej 9 a 10 vjetësh presin për marrëveshje. Ne kemi arritur që brenda një viti, ose të them realisht prej se e kam marrë mandatin që i kemi filluar negociatat në shkurt, në fund të vitit ne kemi nënshkruar marrëveshjen testuese dhe mendoj që kjo është arritje e madhe dhe nuk duhet bërë zhurmë rreth kësaj, sepse mund ta dëmtojmë procesin. Këtë po e them shumë sinqerisht se mund ta dëmtojmë procesin.

Atë që mund të themi, është se sa i përket nivelit administrativ dhe çështjeve të brendshme, si Ministri do t'i kalojmë me sukses dhe besoj se edhe vlerësimi i marrëveshjes testuese do të bëhet me sukses, por nuk duhet bërë zhurmë rreth kësaj marrëveshjeje.

Shtetet e regjioneve marrëveshje të ndryshme pensionale bëjnë deri në dhjetë vjet, qoftë edhe me vende të tjera, të mos flasim për Zvicrën. Besoj që jemi në rrugë të mbarë dhe në fund të gushtit kalon marrëveshja testuese dhe pas kësaj ulemi dhe mendoj që jemi të gatshëm për marrëveshjen e përgjithshme. Faleminderit!

**KRYETARI:** Deputeti Ismajl Kurteshi dëshiron ta marrë prapë fjalën!

**ISMAJL KURTESHI:** Ministër, ju lutem, më thoni a keni qenë të vetëdijshëm atëherë për kompleksitetin meqë keni premtuar një muaj.

Dhe, çështja tjetër, kur po thoni nuk është mirë të bëhet zhurmë, a mos po thoni nuk është mirë të bëhen pyetje? Nëse thoni nuk është mirë të bëhen pyetje, e keni shumë gabim. Dhe çështja e tretë, një herë keni thënë një muaj, e tash e keni çuar në dhjetë vjet.

Dhe, një çështje tjetër, të lutem! Prit, se unë ende kam kohë. Çështja tjetër është se keni thënë që Zvicra e ka ndërprerë njëanshëm këtë çështje. Nuk është e vërtetë! Kjo ka ndodhur për shkak të mospërgjegjësisë së Qeverisë së Kosovës, e cila nuk i ka përmbushur obligimet dhe po pësojnë njerëz të pafajshëm, prandaj ju lutem, na thoni pse po premtoni kur janë çështjet komplekse dhe a duhet pritur 10 vjet apo sa duhet të presin këta njerëz.

**KRYETARI:** Urdhëro, ministër, vazhdoni, mund të përgjigjeni!

**MINISTRI ARBAN ABRASHI:** Shumë e dimë që është marrëveshje komplekse dhe e dimë që është natyrë komplekse, por po mendoj që ju nuk e keni ditur që është komplekse.

*(Ndërhyrje)*

Jo, unë e di çka kam folur, se procesverbalet ekzistojnë dhe brenda asaj kur e kemi nënshkruar marrëveshjen testuese, ideja ka qenë ta nënshkruajmë si testuese, sepse e kanë ndërprerë marrëveshjen më herët dhe besoj se duhet ftuar në përgjegjësi ata të tjerët. Atë që e kam pasur unë në mandat, e kemi kryer dhe po mendoj se po shkon mirë.

A, pse po them të mos bëhet zhurmë, mendoj privatisht të tregoj pse të mos bëjmë zhurmë. Besoj që do të kem të drejtë dhe do ta pranosh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër, deputet i nderuar! Deputeti Faton Topalli nuk qenka këtu, e ka pasur në pyetje për ministrin Skender Hyseni.

Shkojmë tutje. Deputeti Mytahir Haskuka, pyetje për ministrin Kujtim Shala. Urdhëro, meqë u paraqit Salihu.

SALIH SALIHU: Ministër, t'u kisha lutur meqë s'po e kam të qartë çfarë është kjo marrëveshje testuese dhe nën dy, ne e kemi vizituar Zvicrën dhe i kemi takuar bashkatdhetarët, thuhet që Qeveria zvicerane i ka dërguar dy letra dhe s'ka marrë kurrë përgjigje nga Qeveria e Kosovës pas rënies së marrëveshjes.

KRYETARI: Ministër, nëse do, përgjigju, e nëse s'do, mendoj që s'ka nevojë, sepse u përgjigj.

SALIH SALIHU: E çka është marrëveshja testuese?

KRYETARI: Deputet, të lutem! Zotëri Mytahir Haskuka, pyetje për ministrin Kujtim Shala. A dëshironi ta bëni pyetjen, për arsye se s'është zëvendëskryeministri këtu. Fjala është për deputetin, regjia!

MYTAHER HASKUKA: Edhe pse ministri nuk është këtu, ndoshta përgjigjet me shkrim, unë po e bëj pyetjen.

Javën e kaluar në Prizren humbi jetën një trevjeçare dhe u lënduan dy persona të tjerë. Kjo tragjedi ndodhi si pasojë e mosveprimit të pushtetit lokal dhe atij qendror, të cilët janë të obliguar t'i mbrojnë monumentet e trashëgimisë kulturore sipas Ligjit për trashëgiminë kulturore dhe sipas Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Të përkujtoj se në vitet e kaluara, shumë organizata joqeveritare dhe opozita në Prizren kanë kërkuar që institucionet kompetente, që në këtë rast janë Komuna e Prizrenit dhe Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit, të veprojnë e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit sipas përgjegjësi që i përcaktojnë ligjet.

Po ashtu, Këshilli i Trashëgimisë Kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit ka kërkuar në prill të këtij viti, duke paraparë rrezikun që kanoset nga këto objekte, ka kërkuar nga Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit të ndajë fonde emergjente për ndërhyrje e riparime tek objektet e rrezikuara nga shembja.

Pse Ministria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit asnjëherë nuk i ka marrë parasysh këto kërkesa dhe nuk ka vepruar për të mbrojtur trashëgiminë kulturore në Qendrën Historike të Prizrenit?

Pse nuk janë ndarë fonde të kërkuara për sanimin e gjendjes, a duhen më shumë viktima që Qeveria t'i kryejë obligimet e saj ndaj qytetarëve, ashtu si përcaktojnë ligjet e cekura më lart.

**KRYETARI:** Faleminderit, deputet! Zëvendëskryeministri, njëherësh ministër i Kulturës, nuk është këtu.

Dëshiroj ta shfrytëzoj rastin që në emër të gjithë neve bashkërisht t'i shprehim ngushëllime familjes për rastin tragjik, i cili ka ndodhur dhe mundësisht të evitohen gjëra të tilla dhe të mos ndodhin më në të ardhmen.

### **3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme**

Nëse dikush ka vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 9 qershor 2016, urdhëroni.

Meqë nuk keni vërejtje, atëherë Kuvendi e miraton procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 9 qershor 2016.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës...

Së pari, kryetari i Grupit Parlamentar, Ismet Beqiri, e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

**ISMET BEQIRI:** Faleminderit, kryetar!

Unë në emër të Grupit propozoj që rendi i ditës të plotësohet me dy pika, dhe atë në fund të jenë këto dy pika të rendit të ditës.

Propozoj të futen si pika të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë dhe

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Beqiri.

Pra, e kemi një propozim konkret, në bazë të nenit 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ju kisha lutur, nëse grupet parlamentare kanë deklarime, mund ta marrin fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Grabovci e ka fjalën!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike që këto dy pika të rendit të ditës të radhiten në fund për shqyrtim.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Konjufca, fjala është për ju!

GLAUK KONJUFCA: Këtu pak më parë, nuk e ka as në orë, na erdhi në letër e nënshkruar në mes të shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe atij të LDK-së, e cila është në formën e propozimit për plotësimin e rendit të ditës të kësaj seance plenare dhe që ka të bëjë me shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe BE-së për vazhdimin e mandatit të EULEX-it dhe ndryshimin e ligjeve që përfshijnë këtë çështje.

Ne nuk pajtohemi me këtë plotësim të rendit të ditës dhe marrëveshja, e cila është arritur ndërmjet PDK-së dhe LDK-së është arrogante dhe e papranueshme.

Për shembull, në njërin prej paragrafëve këtu thotë që mblidhet Komisioni i Legjislacionit për të shqyrtuar këtë projektligj pasi ta miratojmë ne këtu në Kuvend të Kosovës këtë projektligj.

Unë mendoj se ai do të shqyrtohet përpara. Duhet të ketë komisioni kohë të mjaftueshme që ta shqyrtojë fillimisht, e pastaj të vijë në procedurë të diskutimit këtu në seancë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Marrëveshja thotë që Komisioni duhet të mblidhet aty shpejt e shpejt dhe vetëm në shqyrtim të dytë ta shqyrtojë këtë projektligj.

Vetë shmangia apo ideja e shmangies së Rregullores dhe futjes së pikave të reja në rend të ditës së seancës nuk e përfshin në të njëjtën kohë edhe anashkalimin e procedurave të rregullta dhe të domosdoshme që i ka Kuvendi i Kosovës dhe kjo arrogancë e koalicionit qeverisës është e papranueshme për Lëvizjen “Vetëvendosje”, kështu që ne nuk do ta votojmë, ose do të votojmë kundër kësaj që kjo çështje të ketë shmangie të rendit të ditës.

KRYETARI: Faleminderit! Grupet e tjera parlamentare a e doni fjalën? Jo!

Atëherë, në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit duhet të procedojmë me deklaram në votim për propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të propozimit për plotësimin e rendit të ditës.

Pra, do të jenë pikat 18 dhe 19, si pika të fundit të rendit të ditës.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!



Atëherë konstatoj se 70 janë për, 12 kundër dhe 1 abstenim dhe miratohet propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës për plotësimin e rendit të ditës dhe shmangien nga Rregullorja e Kuvendit për pikat:

**- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, dhe**

**- Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.**

Shqyrtimi i këtyre dy projektligjeve radhiten si pikat 18 dhe 19 të rendit të ditës.

#### **4. Votimi i projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime të projektit të rehabilitimit të linjës hekurudhore 10**

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 9 qershor 2016, andaj tash procedojmë vetëm me votim.

Të nderuar deputetë, në sallë janë të pranishëm 91 deputetë, që do të thotë se kemi numër të mjaftueshëm për procedim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, kanë votuar 87 deputetë, 75 për, 12 abstenime. Konstatoj se Kuvendi nuk e miratoi Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin e rehabilitimit të linjës hekurudhore 10.

#### **5. Zgjedhja e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve**

KRYETARI: Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, pas intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për procedim dhe miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit ad hoc, zonjën Xhevahire Izmaqu, që t'i paraqesë dhe t'i arsyetojë rekomandimet, si dhe ta sqarojë procedurën e votimit.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve në bazë të nenit 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, nenet 38, 39 dhe 40 të Ligjit numër 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve, në mbledhjen e mbajtur më 30.5.2016, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

## R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve me votim të fshehtë.

Për tre anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve propozohen kandidatët, si në vijim:

1. Abdyl Hyseni,
2. Musa Dragusha,
3. Mentor Hoxha,
4. Ivica Ivanović,
5. Dua Kadriu dhe
6. Natasha Taniq.

Kuvendi prej 6 kandidatëve të propozuar zgjedh 3 anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve.

Pas zgjedhjes së tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, anëtari i cili merr më së shumti vota zgjidhet kryetar i Bordit për Ankesa të Medieve.

Anëtarët e Bordit për Ankesa të Medieve emërohen me mandat trevjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në vazhdim kryetarët e grupeve parlamentare po i shoh që nuk janë lajmëruar asnjë.

Atëherë për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues me përbërje nga një deputet nga secili grup parlamentar, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për komisionin votues.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Urdhëro, zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar propozon Luljeta Veselaj-Gutajn dhe Xhevahire Izmakun.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Ismet Beqiri, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Ne e propozojmë Besa Gaxherrin, deputete.

KRYETARI: Faleminderit! “Vetëvendosje”, ju lutem! Zonja Albulena Haxhiu, nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Për anëtar të këtij komisioni e propozojmë deputeten Shqipe Pantina.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lista serbe, zoti Slavko Simiq e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedniče!

Parlamentarna grupa Srpske liste za člana izborne komisije predlaže gospodina Bojana Mitića. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Myfera Serbica-Shinik, e ka fjalën nga Grupi “6+”.

MYFERA SHINIK: Grupi “6+” e propozon deputetin Kujtim Paçaku.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi grupe të tjera parlamentare në seancë.

Lus deputetët që me ngritje formale të dorës të deklarohen për komisionin votues. Kundër nuk ka.

Kuvendi, në fakt, i emëroi anëtarët në komisionin votues për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve dhe për zgjedhjen e kryetarit të Bordit për Ankesa të Medieve.

Procedimi për përzgjedhjen e tre anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve. Lus komisionin që të fillojë procedimin, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës.

I lutem komisionit t’i zërë vendet, unë po filloj t’i thërras deputetët për votim.

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Alma Lama, Nait Hasani, Sabri Hamiti, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Shpejtim Bulliqi, Slobodan Petroviq, Donika Kadaj Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Muhamet Mustafa, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Gutaj-Veselaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Ismajl Kurteshi, Melihate Tërmmkollli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashi, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Kadri Veseli...

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyçi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

\* \* \*

KRYESUESI: Ftoj kryesuesen e Komisionit që të raportojë për votimin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Mentor Hoxha,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Dua Kadriu  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni,  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha... Më falni, kjo është e pavlefshme, janë votuar katër kandidatë  
dhe e lëmë kështu.  
E pavlefshme,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq,  
Musa Dragusha, Mentor Hoxha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu,  
Musa Dragusha, Mentor Hoxha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu,

Dua Kadriu,  
Musa Dragusha,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni,  
Musa Dragusha,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni,  
Avdyl Hyseni, Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq,  
E pavlefshme,  
Musa Dragusha, Mentor Hoxha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
E pavlefshme,  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Dua Kadriu,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Musa Dragusha,  
Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu,

Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Avdyl Hyseni, Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq,  
Avdyl Hyseni, Musa Dragusha,  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu.

Ky ishte rezultati i votimit.

\* \* \*

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për votim.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Për rezultatet e votimit për zgjedhjen e 3 anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve, në këtë radhë votimi kemi këtë rezultat.

Në votim kanë marrë pjesë 91 deputetë dhe kanë votuar, si vijon:

Avdyl Hyseni i ka fituar 62 vota;  
Musa Dragusha i ka fituar 41 vota;  
Mentor Hoxha i ka fituar 20 vota;  
Ivica Ivanoviqi i ka fituar 40 vota;  
Dua Kadriu i ka fituar 37 vota;  
Natasha Taniq nuk ka fituar asnjë votë.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 40 të Ligjit numër 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve, me mandat trevjeçar, në këtë rund zgjidhet vetëm Avdyl Hyseni, ndërsa vazhdojmë me rundin e dytë, ku në garë do të vazhdojnë kandidatët, si në vijim:

- Kandidati Musa Dragusha,
- Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq dhe
- Dua Kadriu.

Pra, do të vazhdojmë me rundin e dytë, kurse në rundin e parë për mandatin trevjeçar ka fituar vetëm Avdyl Hyseni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A po votojmë edhe një herë, ose do të shkojmë në pauzë?

OK! Do të shkojmë në pauzë deri në orën 15:15. Faleminderit!

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*  
*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Po vazhdojmë me seancën, ndërkohë vazhdojmë me shqyrtimin e disa raporteve derisa të krijohen të plotësohen kushtet për vazhdimin e votimit.

#### **14. Shqyrtimi i raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zoti Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka përgatitur dhe dorëzuar në Kuvend raportin vjetor të punës për vitin 2015.

Në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 120 dhe neni 121 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, raporti përfshin numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar në vitin 2015, ku gjithsej janë pranuar 592 ankesa, ndërsa janë shqyrtuar 567 ankesa.

Në 166 raste, apo 28% janë shqyrtuar vendime të autoriteteve konkurruese si të bazuara.

Në 196 raste, apo 33% është bërë rivlerësimi i ofertave, ku është konstatuar se është bërë vlerësimi i gabuar i Komisionit vlerësues dhe është hasur në shkelje të Ligjit për Prokurimin Publike dhe rregulloreve të Prokurimit Publik.

Në 129 raste, apo 22% OSHP-ja ka anuluar aktivitetet e prokurimit dhe është bërë ritenderimi.

Në 10 ankesa, apo 2% janë hedhur poshtë për shkak të moskompletimit të tyre brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 11.4 dhe 118.1 të Ligjit të Prokurimit Publik.

53 ankesa të dorëzuara janë tërhequr nga operatori ekonomik para se të shqyrtohen nga paneli shqyrtues.

6 ankesa, apo 1% janë refuzuar, sepse nuk kanë qenë kompetencë e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues gjatë vitit 2015 ka lëshuar gjithsej 3 urdhëresa, 25 ankesa kanë mbetur pa vendim, në mungesë të kryetarit të OSHP-së.

Në bazë të kësaj del se numri i ankesave nga operatorët ekonomikë për vitin 2015 është më i lartë për 4% apo 55 ankesa më shumë se sa në vitin 2014.

Numri më i madh i ankesave ka qenë ndaj KEK-ut, 45 ankesa. Ndaj Komunës së Prishtinës 38 ankesa, Ministrisë së Shëndetësisë 32 ankesa, ndaj Ministrisë së Infrastrukturës 33 ankesa, Komunës së Pejës 21 ankesë, Autoritetit Qendror të Prokurimit 22 ankesa, PTK-ja 19 ankesa dhe kështu me radhë.

Shumica e ankesave nga operatorët ekonomikë kanë qenë tenderë me vlera të larta.

Sa i përket raportit financiar buxheti i ndarë për OSHP-në për vitin 2015 ka qenë në vlerë prej 319 mijë e 70 euro, buxheti i rishikuar ka qenë 305 mijë e 70 euro, kurse buxheti përfundimtar ka qenë 297 mijë e 974 euro. Ndërsa buxheti i shpenzuar është 291 mijë e 838 euro, apo 97%.

Në fakt, raporti fillestar financiar e OSHP-së që është shqyrtuar në Komision ka qenë me gabime dhe si rezultat Komisioni në bazë të vërejtjeve ka kërkuar nga OSHP-ja që të dorëzojë një raport të ri financiar të përmirësuar, gjë që është bërë dhe i është bashkangjitur rekomandimeve të Komisionit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa shqyrtoi raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015 dhe kërkoi që OSHP-ja të sjellë një raport shtesë për përmirësimin e disa gabimeve teknike, OSHP-ja pasi që ka sjellë raportin shtesë.

Komisioni vlerëson se raporti përmban kushtet ligjore të parapara në Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim të raportit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti Osmani! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Vetëm nga “Vetëvendosje” është lajmëruar Shqipe Pantina. Urdhëroni, e nderuar!

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit!

Në fakt, raporti i punës i Organit Shqyrtues të Prokurimit vë në pah atë që tash për një kohë të gjatë flitet edhe në media, jo vetëm nga problemet që i ka ngritur opozita, e që kanë të bëjnë me fushën e prokurimit, e cila vazhdon të mbetet njëra nga problemet më të mëdha me të cilat institucionet ballafaqohen, edhe atë jo për shkak të faktit se mungojnë kapacitetet për me e krye si duhet procesin e prokurimit, por për shkak se njerëzit që punojnë në këto institucione, në ato që quhen organizata kontraktuese, që i bie po thuaj se të gjitha institucionet brenda Qeverisë ministritë, po edhe të pavarurat e përdorin këtë proces si mundësinë më të lehtë dhe më të mirë për pasurinë e tyre pra për t’u korrptuar.

Kështu që edhe ky raport vë në pah se edhe kjo Qeveri, edhe vitin që shkoi, 2015, si vite të mëhershme ka vazhduar me trendin e keqmenaxhimit, keqpërdorimit dhe manipulimit me paranë publike për përfitime të veta dhe kjo shihet me numrin e madh të ankesave që i janë drejtuar këtij institucioni dhe shumica e tyre kanë pasur të bëjnë me kontratat që kanë vlera të mëdha.

Për sa i përket vetë raportit dhe punës së Organit Shqyrtues, në fakt edhe ky institucion jo që e ka kryer punën në formën më të mirë të mundshme.



Fakti që OSHP-ja nuk ka arritur ta hartojë si duhet raportin e vet financiar, me të cilin edhe Komisioni, siç e tha kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, ka pasur vërejtje për nivelin e profesionalizmit dhe seriozitetit me të cilin punëtorët e këtij institucioni e trajtojnë çështjen, siç thashë, është ndër çështjet më të ndjeshme e Prokurimit Publik.

Në raport nuk ka objektiva, pothuajse 10 faqet e para apo më shumë flasin cilat janë detyrat e OSHP-së, e cilat janë të përcaktuara me ligj, por nuk tregojnë se cilat kanë qenë objektivat që ata i kanë vënë vetes për vitin që shkoi, do të thotë për vitin 2015, për të cilën kanë raportuar. Vetëm në fund të raportit ata i përmendin disa objektiva për vitin 2016.

Raporti nuk përmend po ashtu cilat janë të arritura e tyre, në fakt ata flasin për disa të arritura, e në fakt që janë trajnime, të cilat i ka ndjekur ky staf, qoftë brenda vendit, qoftë edhe jashtë vendit dhe është interesant se një nga të arriturat të përmendura janë trajnimet jashtë vendit, ku ata tregojnë se i kanë kaluar katër ditë në Shqipëri për të hartuar këtë raport pune.

Unë nuk e kuptoj pse i është dashur këtij institucioni të shkojë për katër ditë në Shqipëri për të hartuar një raport dhe këtë pastaj ta prezantojnë si trajnim.

Natyrisht se edhe ky institucion, si shumë të tjerë, kanë nevojë për trajnime, kanë nevojë për ngritjen e kapacitetit në mënyrë që ta kryejnë punën më mirë, por nuk tregojnë përkundër faktit se paktën për trajnime kanë folur në shumicën e kohës, nuk tregojnë se cilat janë rezultatet që janë shënuar pas ndjekjes së këtyre trajnimeve. Sa është rritur efikasiteti i punës së këtij institucioni.

Më tutje, siç e përmendëm, raporti po ashtu ka probleme me financat, mënyrën e prezantimit se si e kanë shpenzuar ata buxhetin e tyre, ndonëse më vonë kanë sjellë korrigjimet, për faktin që herën e par kanë bërë kaq gabime edhe një herë e tregon ose nivelin e ulët të seriozitetit, ose përpjekjet për të manipuluar me mënyrën se si i kanë shpenzuar paratë publike.

Por, raporti, siç e thashë, vë në dukje edhe një herë, megjithëse është i hartuar dobët dhe nuk ka analiza të mjaftueshme, me të cilat mandej do të mund të diskutonim, sërish vë në pah se institucionet tona vazhdojnë të keqmenaxhojnë paratë publike, sidomos të keqpërdorin procesin e prokurimit publik si një nga mënyrat më të lehta për të keqmenaxhuar dhe për të keqpërdorur paratë publike.

Prandaj, me këtë raport çfarë është tani ne nuk mund të rekomandojmë Kuvendit si Lëvizje “Vetëvendosje” që ta miratojë si të tillë.

**KRYETARI:** Faleminderit, zonja deputete! Kam problem pak me sistemin, nuk u lajmërua askush më. A ka dikush me dorë, Abdyl, Faton dhe Shpejtim Bulliqi.

**ABDYL YMERI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, si organ i pavarur, ka një mision dhe rol të veçantë në rritjen e besimit dhe mbrojtjes ligjore si dhe në shqyrtime të të gjitha ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomikë, të cilët i paraqesin me rastin e shkeljeve nga autoritetet kontraktuese.

Përpos kësaj, ky organ në vazhdimësi duhet t'i përmbushë obligimet, detyrat dhe parimet që dalin nga ligjet në fuqi, me qëllim të rritjes së transparencës, konkurrimit të drejtë, paanshmërisë dhe të ngritjes në nivelin më të lartë të përgjegjshmërisë për administrimin më të mirë të fondeve publike.

Nëse lexohet me shumë kujdes ky raport shihet se janë pranuar 592 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomikë, të cilët kanë pretenduar se autoritetet kontraktuese kanë marrë vendime jo të drejta.

Po qe se bëhet një analizë dhe një krahasim edhe me raportin e vitit paraprak shihet se kemi një trend në rritje të ankesave të operatorëve ekonomikë, të cilët edhe pse janë të obliguar të deponojnë sigurimin e ankesave, i bëjnë ankesat e tyre në qoftë se i konsiderojnë se ju është bërë e padrejtë gjatë procesit të tenderimit.

Prandaj, konsideroj se OSHP në raste të tilla duhet të marrë vendime të drejta dhe të pandikuara nga jashtë në bazë të ekspertizës dhe konform ligjit.

OSHP nga 592 ankesa të shqyrtuara, në 166 raste i ka aprovuar vendimet e autoriteteve kontraktuese, duke hedhur poshtë pretendime të palëve ankimore.

Po qe se e bëjmë një analizë krahasuese të 196 vendimeve për rivlerësim dhe 129 vendimeve për ritenderim, apo 54% nga vendime të tërësishme, konsideroj se nga vendimet e marra për rivlerësim dhe ritenderim në favor të operatorëve ekonomikë tregon se në një masë jo edhe aq të vogël ka pasur shkelje të ligjit të prokurimit publik dhe në raport nuk shihet se cilat masa janë marrë.

Në raste të tilla OSHP ka identifikua parregullsi të natyrave përmbajtjesore, teknike, procedurale, administrative dhe në raste të tilla duhet të ndërmerren masa të nevojshme për përmirësimin e tyre.

Unë këtu do t'i përmend vetëm disa autoritete kontraktuese që kanë numrin më të madh të ankesave të bëra nga operatorët ekonomikë.

KEK-u me 45, Komuna e Prishtinës 38, Ministria e Shëndetësisë me 32, ASHP me 22, PTK 19, Komuna e Ferizajt 19.

OSHP e ka pranuar një numër jo të vogël të ankesave nga operatorët ekonomikë. Prandaj, disa prej autoriteteve kontraktuese duhet të përmirësojnë performansën e tyre.

Operatorët ekonomikë kanë një adresë ku të drejtohen në rast se pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Mirëpo, OSHP duhet të argumentojë dhe të arsyetojë vendimet e saj, në mënyrë që të rritet besueshmëria e operatorëve ekonomikë ndaj këtij institucioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A vazhdojmë me debat, a po doni të futemi në votim. A e kryejmë këtë debat, Faton, atëherë. Po! Pastaj zoti Bulliqi le të përgatitet. Regjia, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Gjithë ata që kanë lexuar raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik nuk besoj që të mos e kenë kaluar pa e vërejtur një çështje.

Derisa vitin e kaluar kishin trajtuar 537 ankesa, këtë vit numri i tyre është rritur në 592, pra ka 4% më shumë se një vit më parë.

Nga ky numër 325 raste janë evidentuar shkelje të Ligjit të prokurimit. Nëse zbërthejmë politikisht këto shifra, mund të sjellim dy konkludime të rëndësishme për pushtetin lokal dhe atë qendror.

Konkludimi i parë është që pakënaqësitë e operatorëve ekonomikë janë shtuar për 4% në raport me vitin e kaluar, gjë që flet për një rritje të keqpërdorimeve si në nivelin lokal, ashtu në nivelin qendror.

Kjo tregon që koalicioni, i cili pretendon të luftojë krimin e organizuar, korrupsionin dhe implementimin e ligjeve në Kosovë, ka dështuar.

Pra, jo vetëm që nuk kemi përparim në vënien e ligjshmërisë, por po ndodh e kundërta, shkelja e ligjeve dhe e parregullsive po shtohet.

Kjo tregon edhe një fakt të rëndësishëm që pushteti është etabluar në shkeljen e ligjit dhe shifrat për këtë vit do të na tregojnë që numri i shkeljeve vitin e ardhshëm nëse nuk ka zgjedhje të reja gjatë këtij viti, do të shtohet edhe më shumë.

Konkludimi i dytë është që Qeveria dhe pushteti lokal po e bojkotojnë vetë zbatimin e ligjit.

Shkeljet më të mëdha, thotë raporti i OSHP-së, janë bërë përmes shkeljes së drejtpërdrejtë dhe duke dhënë tenderë për projekte që kushtojnë shumë dhe nuk janë efikase, neni 6, duke i trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese konkurrues të ndryshëm, neni 7, duke shkelur normën e transparencës, neni 10, duke pranuar projekte pa dosje të plotë, neni 27, apo duke ekzaminuar, vlerësuar dhe krahasuar gabimisht tender, neni 59.

Të gjitha këto shkelje, nga njëra anë, dëmtojnë operatorët ekonomikë dhe, nga ana tjetër, dëmtojnë buxhetin e Kosovës.

Mënyra se si po silltet pushteti ndaj shkelësve të ligjit po tregon që shkelja jo vetëm që nuk po dënohet e zvogëlohet, por ajo po stimulohet nga vetë pushteti.

Ndryshe s'ka si të shpjegohet fakti që subjektet e dënuara për shkak të shkeljeve të ndryshme mbeten pa u ndëshkuar. Kështu, për shembull, OSHP gjatë vitit 2015 ka shqiptuar dënimin ndaj PTK-së, KEK-ut dhe Ministrisë së Financave, të cilat Qeveria e Kosovës, respektivisht Thesari dhe Ministria e Financave, kanë kundërshtuar t'i ekzekutojnë vendimet e OSHP-së.

Ka një mori dënimesh që janë shqiptuar nga OSHP gjatë viteve 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013, së paku kështu thotë vetë raporti dhe nuk janë ekzekutuar nga Qeveria.

Me të vërtetë kjo është skandaloze, atëherë si do të vëni drejtësinë në këtë vend, si do ta luftoni shkeljen e ligjit, si do ta luftoni korrupsionin, kur vetë Qeveria e stimulon atë.

Raporti i OSHP-së ka pasur mundësi të jetë më i kompletuar, më i saktë dhe më transparent, më i detajuar, por kjo nuk është kritika ime kryesore.

Pyetja shtrohet se çfarë do të bëjë Qeveria me këtë raport, çfarë do të bëjë në luftimin e shkeljes së ligjit dhe të korrupsionit. Praktika e deritashme ka treguar që Qeveria nuk ka bërë asgjë.

Raportet e tilla tregojnë gjendjen ekzistuese, edhe atë shumë më të zbutur se sa është në të vërtetë, por nuk kanë asnjë vlerë tjetër, sepse nuk merren parasysh për të ndryshuar situatën dhe kjo as që pritet për një Qeveri të papërgjegjshme që stimulon vazhdimin e kësaj gjendjeje dhe që stimulon, në një mënyrë apo një tjetër, shkeljen e ligjit.

**KRYETARI:** Zoti Bulliqi e ka fjalën, të njëjtën kohë të bëhet gati zonja Hadërgjonaj dhe zonjën Gaxherri e kemi, më s'ka të lajmëruar, të keni parasysh.

**SHPEJTIM BULLIQI:** Faleminderit, kryetar!

Të respektuar deputetë të Kuvendit,

Në qoftë se ndalemi dhe e analizojmë me vëmendje raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2005, na bien në sy një sërë lëshimesh të mëdha, sidomos në aspektin e planifikimeve buxhetore që janë bërë për këtë periudhë kohore.

Faktikisht, unë do të ndalem vetëm në disa pika, po them, të detajeve të shpenzimeve sipas kodeve ekonomike që janë paraqitur nga raportuesi.

Duke filluar nga shpenzimet e udhëtimit, pastaj shpenzimet e mirëmbajtjes, qiraja dhe shpenzimet e marketingut.

Në qoftë se ndalemi dhe i analizojmë këto katër kategori kryesore të shpenzimeve të buxhetit për vitin 2015, na bie në sy një fakt i një planifikimi të papërgjegjshëm që është bërë në këto katër kategori kryesore të shpenzimeve.

Në të parën, në shpenzimet e udhëtimit, që mendojmë se është një rritje shumë e madhe ose një shpenzim shumë i madh, i cili faktikisht i ka kaluar të gjitha planifikimet buxhetore, e kjo faktikisht na shkon diku në 147,6% të planifikimeve që janë bërë nga ana e këtij organi ose në qoftë se i ndajmë në kategori, faktikisht shuma më e madhe e këtyre shpenzimeve është bërë në mëditje të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit me 141,25%, akomodimet gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit me 161,4% dhe shpenzimet e tjera të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit që janë me një përqindje diku prej 311,70%.

Nënkategoria e dytë, e cila gjithashtu bie në sy, në shpenzimet që janë realizuar është nënkategoria e mirëmbajtjes që në total kap një përqindje prej 132 % të shpenzimeve të planifikuara.

Faktikisht, këto shpenzime janë relativisht të rritura në dy nënkategori, të mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve me 142%, dhe mirëmbajtja e ndërtesave me 112%.

Ndërsa çështja tjetër që bie në sy dhe që kemi vërtet një rritje shumë të madhe është kategoria e qirasë, e cila faktikisht ka tejkaluar shumë prej 286%. Ne e dimë shumë mirë që qiraja e ndërtesave të paktën është dashur të planifikohej në mënyrë të drejtë në fillim të vitit, sepse ka qenë një dukuri ose është një problem që faktikisht këta e kanë ditur që do të ballafaqohen, e jo në fund ta kemi këtë përqindje të rritur tej mase.

Dhe, kategoria e fundit, shpenzimet e marketingut, që në total prapë kap një përqindje prej 280% shpenzime nga ato të parapara që kryesisht lidhet me reklamat dhe konkurse të ndryshme, të cilat në një farë forme ndoshta nga ky organ është dashur të planifikohen me kohë.

Nga të gjitha këto, po them, këto katër pika ose këto katër kategori kryesore, në qoftë se i analizojmë mirë na del që vërtet ky organ ka bërë një planifikim jo të mirëfilltë të buxhetit dhe faktikisht si pasojë e këtij planifikimi të gabuar të buxhetit na dalin krejt këto ndryshime në kuptimin e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore për vitin 2015. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj, le të bëhet gati zonja Gaxherri.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, sipas ligjit, është institucion i pavarur që mbron të drejtat e operatorëve vendorë dhe të huaj nga veprimet e paligjshme të autoriteteve kontraktuese në procedurat e prokurimit.

Ky institucion, për shkak të mosplotësimit të anëtarëve të bordit, ka pasur vështirësi në përmbushjen e detyrave të rëndësishme në procedurat e shqyrtimit të ankesave, në procedurat e prokurimit dhe në realizimin me sukses të funksioneve, për të cilat është themeluar, gjë që vërehet qartë nëse e analizojmë me kujdes raportin e punës të Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik gjatë vitit 2015.

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik gjatë vitit 2015 ka pranuar 592 ankesa nga operatorët ekonomikë, çka do të thotë që është shtuar numri i ankesave, për çka vijmë në përfundim që operatorët ekonomikë gjithnjë e më shumë po vetëdijesohen se për çfarëdo shkelje që u bëhet duhet të bëjnë ankesa dhe të marrin rekomandimet apo vendimet e caktuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik.

166 vendime të autoriteteve kontraktuese janë aprovuar.

196 janë kthyer në rivlerësim, duke konstatuar se është bërë vlerësim i gabuar i ofertave të autoriteteve kontraktuese.

Është shqetësuese se 129 raste Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka anuluar aktivitetet e prokurimit dhe është bërë ritenderimi.

Në raport nuk kemi të dhëna se çka është ndërmarrë ndaj të gjitha atyre autoriteteve kontraktuese që kanë bërë shkelje dhe procedurat e prokurimit janë ripërsëritur.

A ka marrë ndonjë masë Organi Shqyrtues i Prokurimit apo institucioni përkatës në këtë rast.

53 operatorë ekonomikë i kanë tërhequr ankesat e tyre për shkak të jokompetencës të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Janë refuzuar 6 ankesa, kurse 4 prej këtyre ankesave janë pjesë e procedurave të gjykatës.

25 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomikë kanë mbetur pa vendime përfundimtare për shkak të mungesës së bordit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik për moszgjidhjen me kohë të bordit ka trashëguar 74 ankesa të pazgjedhura, të cilat iu ka kaluar afati ligjor dhe operatorët ekonomikë nuk kanë pasur mundësi të marrin përgjigje.

Nga raporti vërejmë se më së shumti ankesa për shkeljen e procedurave të prokurimit ka pasur Korporata Energjetike e Kosovës, gjithsej 45. 10 prej tyre janë kthyer në tenderim për shkak të shkeljeve që ka bërë Korporata Energjetike e Kosovës si autoritet kontraktues.

Mirëpo, nuk mbetet prapa as Komuna e Prishtinës. Ankesat më të shumta janë bërë edhe ndaj Komunës së Prishtinës, si autoritet kontraktues, gjithsej 38 ankesa, ku 12 prej tyre lënë janë kthyer në rivlerësim, kurse 7 prej tyre janë kthyer në ritenderim për shkak të shkeljeve të bëra.

Më shumë ankesa janë bërë edhe nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Infrastrukturës, Komuna e Ferizajt dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik i mbetet për detyrë të shqyrtojë se ku janë problemet më të mëdha që i kanë bërë këto institucione që kanë qenë autoritete kontraktuese, të kenë aq shumë shkelje në procedurat e prokurimit.

Me që ka raste të shumta të kthimit të lëndëve në ritenderim, si pasojë e shkeljeve që i kanë bërë autoritetet kontraktuese, a janë marrë masa ndëshkuese ndaj atyre që kanë bërë shkelje? Këto të dhëna ne nuk i disponojmë dhe nuk kemi informata se a është dënuar dikush për veprime të liga, të cilat i kanë bërë në procedurën e tenderimit.

Raportit të punës i është bashkangjitur edhe raporti financiar, i cili është prezantuar me shumë gabime, gabime këto të përmirësuara në raportin e kthyer nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, në rishikim dhe përmirësim të të dhënave.

Rekomandojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit Publike ta analizojë kapacitetet njerëzore që merren me financa brenda institucionit, si dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë auditimin e këtij institucioni, meqenëse është institucion shumë i rëndësishëm është një lloj gjykate e tenderimi që ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e operatorëve ekonomikë dhe të kontrollojë 11 rekomandime të dhëna në vitin 2014, sa ka pasur lëvizje pozitive për një menaxhim më të mirë brenda institucional të këtij institucioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Gaxherri, fjala për ju.

BESA GAXHERRI: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Unë nuk do të ndalem më shumë në raportin për vitin 2015 të OSHP-së, për arsye se pajtohem plotësisht me atë çfarë tha kryetari i komisionit zoti Naser Osmani, por me këtë rast pasi që po diskutojmë për OSHP-në dua ta ngris ose ta kenë vëmendjen pikërisht këto institucione duke filluar nga Prokurimi Publik, AQP dhe OSHP, që vërtetë janë institucion natyrisht i pavarur, por ne si Qeveri po pretendojmë që vërtetë të luftojmë korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe një ndër institucionet më relevante janë pikërisht Prokurimi Publik, AQP dhe OSHP.

Duke u bazuar në këtë dhe duke pasur parasysh që nëpërmjet këtyre institucioneve dhe mekanizmave synojmë që të vëmë rend, ligj dhe transparencë, atëherë i thërras këto institucione që vërtetë të kanë kujdes, të jenë shumë të kujdesshëm, të jenë transparentë, të respektojnë ligjin edhe konsideroj dhe i ftoj të gjitha organet, të cilat kanë të bëjnë me këtë çështje që t'i vë në spikamë për arsye se unë po i paralajmëroj që jemi duke i përcjellë me ankesat e disa bizneseve, të cilat padrejtësisht kanë kaluar nga Prokurimi Publik, nga AQP dhe tash janë duke pritur përgjigje nga OSHP-ja.

Dua ta ngris këtë për arsye se shumë shpejtë, unë personalisht vetë do t'i përcjell këto ankesa të këtyre ofertuesve dhe do t'i diskutojmë këtë në Kuvend me argumente që vërtetë qoftë Bordi i OSHP-së, qoftë i AQP-së, qoftë Prokurimi Publik nuk po e kryejnë punën e vetë ose po shkelin ligjin. Prandaj, me këtë rast unë po dua të them që përveç atyre vërejtjeve që i kemi diskutuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa me të cilat unë pajtohem plotësisht po i paralajmëroj këto institucione njëkohësisht edhe prokurorinë do të jeni në vëmendje të tyre, sepse njëherë e përgjithmonë duhet të vendos ky Kuvend dhe këto institucione që më mos të punohet në ato institucione qysh është punuar deri sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, nuk ka më diskutues të paraqitur. Duhet të futemi në pjesën e votimeve të Raportit të punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

80 deputetë kanë marrë pjesë në votim, 60 kanë votuar për, 15 kundër, 5 kanë abstenuar. Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2015.

Do të rikthehem tek votimi. Lus komisionin votues të marrë vendin e vet, përgatitjen për votim për Bordin për Ankesat e Medieve. Menjëherë do të filloj me thirrjen e deputetëve për votim:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Alma Lama. Atëherë edhe një herë: Shaip Muja, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, , Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli. Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq,

*(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Kadri Veseli, Kujtim Paqaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj Gutaj, Kadri Veseli, Margarita Kadriu Ukelli, Melihate Tërmkollli, Mexhide Mjaku Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Millka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiç, Nezir Çoçaj, Njomza Emimi, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviçe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyçi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Serxhan Popoviç, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

\* \* \*

XHEVAHIRE IZMAKU: Musa Dragusha;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu,  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Ivica Ivanoviç, Dua Kadriu;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha;  
Mentor Hoxha;  
Musa Dragusha;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha;  
Musa Dragusha;  
E pavlefshme;  
Musa Dragusha, Mentor Hoxha;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviç;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviç;  
Mentor Hoxha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviç;  
Musa Dragusha;



Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
E pavlefshme,  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Dua Kadriu;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Dua Kadriu;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Mentor Hoxha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Ivica Ivanoviq, Dua Kadriu;  
Mentor Hoxha, Dua Kadriu;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha,  
Mentor Hoxha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Mentor Hoxha, Dua Kadriu;  
Mentor Hoxha, Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Dua Kadriu;

E pavlefshme;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Dua Kadriu;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Mentor Hoxha;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Ivica Ivanoviq;  
Musa Dragusha, Dua Kadriu;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Dua Kadriu;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq;  
Mentor Hoxha, Ivica Ivanoviq,  
Musa Dragusha dhe  
Dua Kadriu.

Tri fletëvotime janë të pavlefshme. Gjithsej 83.

\* \* \*

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Ne po vazhdojmë me rezultatet e votimit të dytë. Votimi i dytë për zgjedhjen e anëtarit të Bordit për Ankesa të Mediave është, si në vijim: në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë. Të pavlefshme janë tri fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

Musa Dragusha i ka fituar 45 vota,  
Mentor Hoxha i ka fituar 18 vota,  
Ivica Ivanoviq i ka fituar 35 vota,  
Dua Kadriu i ka fituar 32 vota.

Tani mund të konstatojmë se anëtar i Bordit për Ankesa të Mediave me mandat trevjeçar zgjidhet Musa Dragusha, ndërsa ne do të vazhdojmë pjesën e tretë të votimit për kandidatët, si në vijim: Ivica Ivanoviq dhe Dua Kadriu, ndërsa eliminohet Mentor Hoxha. Vazhdojmë me votimin tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, ndërkohë ne mund ta procedojmë pikën e radhës për arsye se derisa të përgatitemi për votim mund të futemi, në qoftë se pajtoheni, në pikën:

## 6. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka intervistuar kandidatët për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Kuvendit i ka propozuar dy kandidatët e mundshëm për pozitën e drejtorit. Kryetarja e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit deputetja Albulena Haxhiu e ka fjalën. Ndërkohë, në qoftë se grupet parlamentare pajtohen mbetet i njëjti, atëherë flasim. Atëherë, anëtarët e komisionit le të vazhdojnë, le të ulen në vendet e veta. Urdhëro, zonja Haxhiu fjala është për ju, ndërkohë do të shkojmë në procedurë të njëjtë.

ALBULENA HAXHIU: Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit në mbledhjen e mbajtur, më 07.06.2016 intervistoi kandidatët për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Nga 29 kandidatët që kishin aplikuar për këtë pozitë, 23 prej tyre iu nënshtruan intervistimit, dy kandidatë kishin ofruar dorëheqjen me shkrim nga kandidatura dhe 4 kandidatë nuk morën pjesë në intervistim. Nga 23 kandidatët e intervistuar, duke u bazuar në vlerësimin e anëtarëve të komisionit, pra në poentimin e secilit kandidatë rezultoi se Burim Sadiku u vlerësua me 85 pikë dhe Shaip Havolli me 78,5 pikë.

Komisioni për Legjislacion i rekomandon Kuvendit për votim kandidatët për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, që janë Burim Sadiku dhe Shaip Havolli. Kuvendi prej 2 kandidatëve të propozuar për drejtorë të agjencisë do të zgjedh njërin nga kandidatët. Votimi i kandidatëve për drejtor të agjencisë bëhet me votim të fshehtë dhe mandati i drejtorit të agjencisë është 5 vjet dhe fillon nga data 24 shtator 2016. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, nga PDK-ja a u lajmërua dikush? S'ka. LDK-ja Arben Gashin po e shoh. Urdhëro, Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit! Kryetar, veç është një problem se mundën të bien deputetët në lajthitje dhe është jo procedurale. Jemi në procedurë të votimit për rastin paraprak, nuk mundemi të hyjmë në një procedurë tjetër të votimit për pa u mbyll procedura e parë. Kështu që është mirë që të mos vazhdojmë me këtë pikë, por të vazhdojmë në pikën ku kem fillimisht, sepse edhe po i qesim deputetët në lajthitje edhe proceduralisht është e papranueshme. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet, krejt ajo çka po mundohem të bëj është ta shfrytëzojmë kohën në mënyrë maksimale, ju e vendosni në fund të fundit. Ne mund të përgatitemi ta konsumojmë këtë pjesën formale e cila është në votim, pastaj futemi se teknikisht duhet të presim edhe gjysmë ore derisa të shtypen, se administrata kandidatët kur po dalin është rezultat i votimit.

Tani i kemi dy kandidatë, të cilët do të shkojnë që kanë marrë më së shumti vota, por nuk i kemi aktualisht ose mundemi të ndalemi, të procedohen dhe ndalemi i presim atëherë. Atëherë, grupet parlamentare a kanë diçka vetëm sqarim procedural, sipas nenit 8, paragrafi 5, Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit Kuvendi me votim të fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të

votave zgjedh njërin prej kandidatëve të propozuar për drejtor të agjencisë. Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve me mbështetje zyrtarëve të Administratës.

Tani, para se të ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare në qoftë se shkojmë duke pasur parasysh se nuk kemi dokumentacionin për votimin për Bordin e Ankesave të Medieve a doni ta zgjidhni komisionin që të deklaroheni dhe të vazhdojmë menjëherë me materialin votimi. Atëherë, ta verifikojmë Partia Demokratike e Kosovës a e ka të njëjtën kandidatë? Lidhja Demokratike e Kosovës, Ismet Beqiri, Besa Gaxheri, mirë! Xhevahire Izmaqi, “Vetëvendosje” Shqipe Pantina njëjtë, Lista serbe, njëjtë. Atëherë, nuk kemi ndryshim. “6+” a jeni për të njëjtin urdhëroni anëtar të komisionit? Kujtim Paqaku, atëherë mirë!

Atëherë, e kemi të njëjtin Komision votues, vetëm me ngritje dore a ka mundësi ta aprovojmë votim formal këtë komision votues. Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit votues për përzgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Lus komisionin që të fillojë me procedim, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës. Unë do t’i thërras menjëherë deputetët:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Qaushi, Sali Morina, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli. Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paqaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu Ukelli, Melihate Tërmkollli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emiri, Nuredin Ibishi.

Ftoj deputetët, kryetarët e grupeve parlamentare t’i thërrasin deputetët që të qëndrojnë në seancë deri në orën 18:15. I kisha lutur kryetarët e grupeve parlamentare, i kemi disa ligje pastaj në orën 18:15 e vendosim vazhdimin e seancës për nesër, apo si t’ia bëjmë.

Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyçi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Serxhan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqi, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Në qoftë se ka ndonjë deputetë që s'e kam thirr e lus të ofrohet në votim edhe sa për protokoll vetëm t'ia thërras emrin.

\* \* \*

Atëherë, e kemi rezultatin e komisionit.

XHEVAHIRE IZMAKU: Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

E pavlefshme,

Shaip Havolli,

E pavlefshme,

E pavlefshme,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,

E pavlefshme,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,

Burim Sadiku,

Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Burim Sadiku,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Burim Sadiku,  
Shaip Havolli,  
Burim Sadiku,  
E pavlefshme,  
Shaip Havolli,  
E pavlefshme,  
Shaip Havolli,  
Burim Sadiku,  
Burim Sadiku,  
Shaip Havolli,  
Burim Sadiku,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
E pavlefshme.  
Burim Sadiku,  
Burim Sadiku,  
Burim Sadiku,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Shaip Havolli,  
Burim Sadiku,  
Burim Sadiku,  
Burim Sadiku,  
Burim Sadiku,  
Burim Sadiku,  
Shaip Havolli dhe  
Burim Sadiku.

\* \* \*

KRYETARI: Tash presim rezultatin përfundimtar nga komisioni votues edhe menjëherë pastaj rikthehemi në raundin e tretë të votimit për Bordin e Ankesave të Mediave. Urdhëroni, zonja Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

Në mbështetje të nenit 65, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të neni 8, të Ligjit nr. 03/L-159, për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Votues i formuar me vendim të Kuvendit, data 16 qershor pra, drejtpërdrejtë po kaloj në rezultate.

Komisioni votues pas procedimit të votimit të fshehur dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit në mbledhjen plenare të mbajtur, më 16 qershor 2016, konstaton si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 85 deputetë, të pavlefshme janë 7 fletëvotime. Rezultati është si në vijim:

1. Burim Sadiku i ka fituar 31 vota dhe
2. Shaip Havolli i ka fituar 47 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit konstatohet se zoti Shaip Havolli zgjidhet drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit me mandat 5-vjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, në bazë të raportit të komisionit votues Kuvendi zgjodhi zotin Shaip Havolli drejtor të Agjencisë Kundër Korrupsionit me mandat pesëvjeçar.

Rikthehemi te votimi për rundin e tretë për Bordin e Ankesave të Mediave. Shkojmë menjëherë në votim:

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Driton Qaushi, Sali Morina, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli. Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paqaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkollli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufëra Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emimi, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif

Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyçi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Atëherë, ju lus për vëmendje, të nderuar kolegë deputetë. Urdhëroni, zonja deputete!

**XHEVAHIRE IZMAKU:** Atëherë, kolegë deputetë, i numërojmë votat për anëtarin e fundit të Bordit për Ankesa të Medieeve:

Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
E pavlefshme,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Ivica Ivanoviq,  
E pavlefshme,  
E pavlefshme,  
E pavlefshme,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,



E pavlefshme,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Ivica Ivanoviq,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Ivica Ivanoviq,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
E pavlefshme,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
E pavlefshme,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
E pavlefshme,  
Ivica Ivanoviq,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Ivica Ivanoviq,  
Dua Kadriu,  
Dhe e fundit, e pavlefshme.

\* \* \*

KRYETARI: Zonja deputete Izmaku do të na japë rezultatin përfundimtar.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit kryetar!

Rezultatet e votimit për anëtarin e fundit të Bordit të Ankesave të Medieve janë, si në vijim:

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e një anëtari të Bordit për Ankesa të Medieve, në seancën plenare, të mbajtur më 16 qershor 2016, në rundin e tretë, konstaton si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 80 deputetë.

Të pavlefshme janë 23 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Ivica Ivanoviq i ka fituar 29 vota.

2. Dua Kadriu i ka fituar 28 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 40 të Ligjit Numër 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Medieve dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se me numrin e votave që nuk janë të mjaftueshme, nuk zgjidhet asnjëri anëtar për Bordin e Ankesave të Medieve, prandaj përsëritet konkursi për një anëtarë të këtij Bordi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zonja Izmaku! Atëherë, në bazë të rezultateve të votimit kandidatët që kanë marrë më së shumti vota për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve, janë:

1. Avdyl Hyseni dhe

2. Musa Dragusha.

Për kryetar të Bordit më së shumti vota ka fituar zoti Avdyl Hyseni.

Të nderuar deputetë, në bazë të rezultateve të votimit, konstatoj se Kuvendi zgjodhi dy anëtarë të Bordit të Ankesave të Medieve dhe kryetarin e Bordit për Ankesa të Medieve me mandat trevjeçar, derisa për njërin anëtar të Bordit përsëritet konkursi.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara**

Ftoj zonjën Flora Brovina, e cila ka kërkuar të tërhiqet draftligji - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sot. Urdhëro, zonja Brovina!

FLORA BROVINA: Faleminderit! Flas në emër të Komisionit. Na duhet edhe një konsultë me Qeverinë lidhur me nenin 18, sepse e pamë që ka ndodhur një gabim në amendamentimin e këtij neni, prandaj kërkojmë që të radhitet për seancën ardhshme.

KRYETARI: Faleminderit! Me ngritje dore, një votim formal, a jeni për?

A ka kundër?  
Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet propozimi.

## **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zotin Fadil Beka, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

FADIL BEKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 57, 58 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 6 qershor të vitit 2016, ka diskutuar dhe aprovuar njëzëri raportin përfundimtar për Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve e masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve dhe vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë për miratimin e Projektligjin me amendamentet e propozuara, që gjithsej janë 21 amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 21 amendamente.

Në ndërkohë, zonja Baftiu e kërkon fjalën! Urdhëroni!

BESA BAFTIU: Faleminderit! Më falni që paraqitem me vonesë!  
Edhe pse Projektligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve ka për qëllim të rregullojë procedurat që bëjnë lehtësira dhe ofrojnë shërbime nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe ka për synim rritjen e punësimit dhe parandalimin e papunësisë afatgjate në Republikën e Kosovës, kjo nuk po ndodh, sepse në praktikë, sado që me ligj rregullohen apo mundësohen të kenë të drejta të barabarta në kërkim të punësimit, nuk është njësoj për të gjithë punëkërkuesit dhe për këtë arsye ka humbur besimi i qytetarëve të papunë që çlajmërohen dhe regjistrohen në Agjencinë e Punësimit në Republikën e Kosovës.

Marrë në tërësi, ky projektligj në esencë nuk ka ndonjë ndryshim, përveç se ka riformulime të fjalive, ka heqje të fjalëve, ndërsa ajo që duhet cekur është neni 3 ku në këtë nen faktikisht ka përmirësime që shkojnë në të mirë, për arsye se si punëkërkues deri sa përpara janë regjistruar prej moshës 15 vjeç tani janë ata të papunë, që llogariten prej moshës 18 e deri në 65-vjeçare.

Andaj ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojmë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur tjerë për diskutim. Në këtë projektligj janë propozuar 21 amendamente dhe votojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit funksional.

Të pranishëm jemi 70 deputetë. Nëse pajtoheni, shkojmë me të gjitha 21 amendamentet me votim formal.

Atëherë, kush është për të gjitha 21 amendamentet?

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Tash e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 68 deputetë.

Konstatohet se 68 deputetë janë për dhe Kuvendi e miratoi Ligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve për të papunët, punëkërkuesit dhe punëdhënësit.

## **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për energjinë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, zotëri Muhamet Mustafa, që para deputetëve ta paraqesë arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëro, zoti Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

E keni marrë raportin e gjerë lidhur me ecurinë e diskutimit midis dy leximeve dhe me amendamentet që janë propozuar është bërë një punë e madhe nga Grupi punues, i udhëhequr nga kolegu Raif Qela dhe këto amendamente janë aprovuar në mënyrë unanime nga të gjithë aktorët pjesëmarrës dhe ju ftoj t'i votojmë. Janë 65 amendamente.

KRYETARI: Faleminderit! Është paraqitur për fjalë zoti Muja!

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Me gjithë respektin për punën e mirë që është bërë për ligjin e energjisë Komisioni funksional, unë kam një kërkesë që në nenin 3, tek përkufizimet, në pikën 1.5 që sigurisht është bërë një lëshim pa dashje, është bërë - përcaktimi i llojeve të prodhimit të energjisë në mënyrë strikte dhe unë propozoj që në fund, ku thuhet “dhe bio-gaz” të thuhet: “si dhe çdo teknologji” të shtohet fjalia “çdo teknologji që prodhon energji elektrike dhe ka certifikatën e institucioneve garantuuese për këtë teknologji”.

Pse e them këtë? Sepse në pikën 6 të këtij neni, mund të vjen nesër deri te certifikimet nga dikush në teknologji që mund të nxjerrë prodhimin e energjisë elektrike dhe në bazë të këtij ligji

ai nuk do të ketë mundësi të certifikohet sepse është bërë në mënyrë strikte funksionimi i burimeve energjike të ripërtëritshme.

Prandaj, nuk e shoh si diçka të keqe, por mendoj se i hapim mundësi edhe avancimeve të reja teknologjike, për të cilat ne nuk dimë shkenca ku ka arritur dhe nesër mund të jetë problem që të kërkoen riamendamentime, prandaj mendoj që nuk e prish përmbajtjen e ligjit.

Prandaj, them që të shtohet fjalia “si dhe çdo teknologji që prodhon energji elektrike dhe e ka certifikatën e institucioneve garantuese për këtë teknologji”.

KRYETARI: I nderuar deputet, për cilin amendament ishte kjo shtesa?

SHAIP MUJA: Është në pikën 1.5, te neni 3, të shtohet dhe vetëm shtimi të bëhet, sepse nuk ka amendament në këtë pikë.

KRYETARI: Atëherë, e thërras Profesorin të na japë sqarim se çfarë është pozicioni si kryetar i Komisionit Funkcional.

MUHAMET MUSTAFA: Nuk mund të flas në emër të Komisionit, sepse s’e kemi trajtuar këtë problem dhe është një amendament i ri. Me ju thënë të drejtën, ne këtu kemi pasur ekspertë të shumtë të cilën e kanë trajtuar këtë, dhe unë e kuptoj intencën e kolegut Muja që në avancime teknologjike mund të lindë nevoja për ndonjë modifikim, por besoj që deri atëherë ligji edhe do të ndryshojë, kështu që nuk kisha hyrë sot me nguti të bëjmë amendamente të reja, pa e konsultuar Komisionin. Pra, nuk e kam atë mundësi.

KRYETARI: Zotëri Muja, kjo është gjendja. Fjalën mund ta merrni, por amendament s’mund të futni tani. Urdhëro, zoti Muja!

SHAIP MUJA: Unë zoti kryetar nuk po kërkoj që ndonjë amendament të quhet amendament imi, mirëpo sikur të kisha qenë unë dijeni kur janë bërë amendamentet unë sigurisht se kisha reaguar meqenëse për këtë po kërkohet një vazhdim i një terminologjie e cila tregon një fleksibilitet për prodhimin e energjisë elektrike.

Prandaj, unë kërkoj nga kolegët të qitet në votim dhe mendoj që seanca plenare me këtë votim mund ta arsyetojë edhe çështjen e vazhimit të kësaj fjalie që po e them unë.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, unë i hedh amendamentet në votim. Shkojmë nga 1 deri në 65 me votim formal për amendamentet të gjitha, përnjëherë e pastaj edhe këtë të Shaipit e bisedojmë në fund.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 65 amendamente dhe ne do t’i votojmë në tërësi të 65 amendamentet e propozuara, nëse ju jeni dakord.

Pra, a ka kundër ndokush?

Abstenim? Abstenon Qerim Bajrami!

Pra, për janë 72 deputetë dhe aprovohen të gjitha amendamentet.

Tash propozimi i Shaip Mujës mund të vihet dhe Shaip Muja lexoje, e ne e vëmë në votim dhe seanca ose e voton ose jo. Lexo pra propozimin tënd, e unë propozimin tënd, sikur që e thua, e vë në votim. Urdhëroni!

SHAIP MUJA: Pra, në nenin 3 ku janë “Përkufizimet për burimet e energjisë së ripërtitshme” dhe vazhdon e thuhet “burim i ripërtëritshëm, jo fosil i energjisë, si energjia e erës, energjia solare, energjia ceotermale, uji, energjia e valëve, hidroenergja, biomasa, gaz i mbetjeve urbane, gaz i mbetjeve të trajtimit të ujërave dhe bio-gaz, si dhe”, këtu të vazhdohet “si dhe çdo teknologji që prodhon energji elektrike dhe ka certifikatën e institucioneve garantuese për këtë teknologji”. Do të thotë, nuk e ndryshon absolut, por i jep mundësi të një dimensionit që është fleksibil.

KRYETARI: Atëherë, e kemi një propozim të cilin e ka lexuar deputeti Muja dhe ta vëmë në votim, drejtpërdrejt.

Kush është për këtë propozim të cilin e lexoi Muja dhe e fusim në procesverbal.

Kush është për? Ju lutem, deklarohuni me ngritjen e dorës.

Atëherë janë shumica, sikur po e shoh.

A ka kundër? Janë 2 kundër?  
Kush abstenon? Abstenojnë 5.

Ju lutem, të numërohen votat, sepse si duket është ky propozim interesant, Shaip!

64 deputetë kanë votuar për, 3 kundër dhe kanë abstenuar 5.

Atëherë, miratohen 65 amendamente me plus propozimin e deputetit Shaip Muja futet në votimin e projektligjit në tërësi, ndërkohë zoti Sabri Hamiti është lajmëruar për fjalë. Urdhëroni, Profesor!

SABRI HAMITI: Faleminderit!

E mora fjalën për të deklaruar pse abstenova. Është e drejtë e imja. Nuk abstenova për amendamentin sepse do t'i thosha për Shaipin në amendament, por votova për të dhënë sot këtë, që herën tjetër unë kam propozuar në të njëjtën formë amendament të tillë dhe është thënë nga kryesuesi që nuk ka të drejtë, dhe sekretari që rrinte pranë tij.

E unë po ju them se ka të drejtë dhe mirë ia ka bërë Shaipi që e propozoi, sepse nëse një Kuvend një herë e bën këtë, e ne e kemi bërë amendamentimin se ka fuqi, Kuvendi ka fuqi edhe kushtetuese nëse i bën 80 vota. Pra, nëse Kuvendi vendos ka të drejtë të amendamentojë edhe në këtë shkallë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Profesor! Sido që të jetë, ju vendosni.

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati të votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara dhe me shtesën e deputetit Shaip Muja. Votojmë tash!

Profesor, sekretari po më thotë “unë jam interpretues i Rregullores”, pra kryesuesi është interpretues i Rregullores!

Kanë votuar 71 deputetë. 64 janë për, 6 abstenime dhe 1 kundër, prandaj Kuvendi e miratoi Ligjin për energjinë.

Vazhdojmë, i kemi edhe 2-3 ligje.

## **10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë elektrike**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për energjinë elektrike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Muhamet Mustafa, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetari i Kuvendit,

Ky është një pako e ligjeve të energjisë, të cilat janë jashtëzakonisht të rëndësishme për integrimin e aktorëve që prodhojnë energji elektrike dhe institucioneve që merren me politika të energjisë në Komunitetin Evropian të Energjisë dhe mu për këtë janë bërë shumë diskutime dhe konsultime dhe unë falënderoj kolegët që kanë dhënë një kontribut të madh këtu, veçanërisht kolegun Beqaj, kolegun Fatmir Rexhepi dhe sidomos kolegun Raif Qela, të cilët i kanë udhëhequr këto diskutime.

Ne i kemi dy intervenime në amendamentin 14, dhe në pikën 6.1 duhet bërë disa korrigjime për shkak të konsultimeve që janë bërë më vonë me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe me aktorët tjerë të interesuar.

Prandaj, kur të vijmë te këto dy amendamente, unë duhet të përmirësoj tekstin që është shumë me rëndësi për procesin e integritimit.

KRYETARI: Atëherë, faleminderit! Nuk ka asnjë deputet që lajmërohet për diskutim.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 58 amendamente.

Për amendamentin 1, janë dhënë dy propozime, propozimi i Komisionit funksional që çdoherë ka përparësi dhe propozimi i Grupit Parlamentar 6+ pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Ne do të vazhdojmë t'i votojmë amendamentet e propozuara.

Amendamenti numër 1 dhe 14 nuk votohen tash, kur të votojmë, kurse 56 amendamentet tjera, votohen në tërësi.

A ka kush kundër?

Abstenim?

Atëherë aprovohen 56 amendamente, përveç amendamenteve 1 dhe 14.

Shkojmë tek amendamenti 1.

I kemi dy propozime. Në rend të parë, në mënyrë elektronike votohen dy propozimet.

Propozimi i Komisionit, votohet nën a).

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të propozimit të amendamentit a) i propozuar nga Komisioni funksional. Votojmë tash!

Të nderuar deputetë, të pranishëm në sallë janë 72 deputetë. Do të votojmë edhe një herë, ose shkojmë drejtpërdrejt në amendamentin b), ose e votojmë edhe një herë për amendamentin a) dhe lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë përsëri amendamentin 1 të Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Janë 63 deputetë që kanë votuar për, 5 kanë abstenuar dhe asnjë nuk është kundër.

Kalojmë te propozimi b) i propozuar nga Grupi Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

*(Ndërrhyrje)*

Jo, e kemi obligim, sepse nëse kalon një më shumë, kalon ky pastaj.

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë, s’mund të procedojmë. Duhet të votoni të gjithë: për, kundër ose abstenim, sepse s’po e dimë numrin e votimit.

I kemi 28 vota për, 17 kundër dhe 11 që abstenojnë.

Rregullorja thotë në mënyrë të tillë, ju lutem!

*(Ndërrhyrje)*

Megjithatë, Rregullorja thotë se duhet të vihen të dytë, se nuk kemi rezultat. Pra, lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati. Votojmë tash!

Janë 24 deputetë për, 28 kundër dhe 15 abstenime.

Kalon amendamenti numër 1, i propozuar nga Komisioni Funksional.

Profesor fjala është juaja për amendamentin 14. Pra, e ka fjalën Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,  
I nderuar zoti Zemaj,



Këtu në këtë amendament i kemi dy intervenime, siç thashë, në bazë të konsultimeve që janë bërë me Sekretariatit e Komunitetit për Energji dhe aktorë tjerë të interesuar.

Në pikën 6, faqe 41, tekstin që po e lexoj tash “në rast se Kuvendi dy vite radhazi nuk e miraton raportin vjetor të operatorit të sistemit të transmetimit, Komisioni funksional mund të nisë procedurë të shkarkimit të kryesuesit dhe anëtarëve të bordit”. Pra, është fjala për anëtarët e Bordit të KOST-it. Pra, ky tekst fshihet dhe në vend të tij vjen teksti si vijon, po e lexoj tash:

Pika 6, tekst i ri “Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit kur pas dy viteve të njëpasnjëshme të rishikimit të performansës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Komisioni Funksional gjen se... 6.1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë dhe 6.2. Dështimi i tillë i zbatimit e ka dëmtuar seriozisht funksionimin efikas, efektiv dhe të pavarur të sistemit të operimit të transmisionit.

Dhe intervenimi i dytë, në pikën 6.2, fjala “qeveria” zëvendësohet me fjalët “Komisioni parlamentar përkatës për energji”.

KRYETARI: Faleminderit, Profesor! Amendamenti 14 i cili do të votohet është ai që e ka lexuar kryetari i Komisionit Funksional, profesor Muhamet Mustafa. Do të thotë, materiali i mëhershëm, kur ta vë në votim nuk vlen, por kjo që e ka propozuar profesor Muhamet Mustafa. Urdhëroni! Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që kjo duhet të saktësohet, sepse lë dilema në mes Kuvendit, Qeverisë dhe Komisionit funksional, duke marrë parasysh kompetencat, vetë ligjin dhe funksionet që i kryen KOST-i.

Unë besoj që kështu, sikur është paraqitur kjo e dyta nga Komisioni, është më e pasaktë se sa vetë ajo që ka qenë pjesë përbërëse e ligjit. Por, sido që të jetë, për të zgjedhurit dhe të emëruarit e Kuvendit vendos Kuvendi çdo herë dhe kjo duhet të saktësohet. E tash, si do ta gjejmë formën këtu, është mirë që vetë komisioni ta saktësojë me amendament dhe të jetë e qartë sepse kjo bëhet pjesë e ligjit dhe do të ketë dilema në të ardhmen.

Mbi të gjitha dhe në fund të fundit vendos Kuvendi dhe Kuvendi e vlerëson performansën e çdo institucioni.

Unë mendoj që, nëse do të kisha mundësinë të propozoja, atëherë jo në dy vite radhazi, sepse vetë mandati në fund të fundit është katërvjeçar. Nëse Kuvendi vendos që ne t'i sanksionojmë bordet, edhe pse pak përgjegjësi japin para Kuvendit të Republikës së Kosovës, është mirë që pas çdo viti të ketë kesi vlerësimi, nëse s'kalon raporti. Dhe ju e ne, të gjithë e dimë këtu, se nuk kalojnë raportet e agjencive, nuk kalojnë raportet e bordeve dhe kurrkush nuk jep përgjegjësi, as Kuvendi, as ata që janë përgjegjës para Qeverisë, por mbi të gjitha nëse bimë edhe në rrafshin e komisioneve funksionale.

Pra, mendoj se duhet të saktësohet, duhet të ketë edhe një konsultim shtesë dhe të arrihet ajo çfarë është dashur të arrihet me këtë normë apo me këtë amendament brenda këtij ligji. Kështu siç është, mbetet e pakuptimtë dhe mbi të gjitha mbetet e pazbatueshme gjithmonë dhe prapëseprapë ia jep mundësinë e çdo institucioni, jo vetëm për këtë institucion por e jep mundësinë edhe në të ardhmen që të mund të vazhdojnë me jorespektim të ligjit apo jo edhe me performansë të mirë askush s'mund të marrë vendim për t'i shkarkuar.

**KRYETARI:** Arben Gashi e ka kërkuar fjalën. Profesor, po ju lëmë për në fund. Besim Beqaj, e pastaj ju si kryetar i Komisionit Funkcional.

**ARBEN GASHI:** Faleminderit, kryetar!

Problemi i agjencive dhe i bordeve është problem që është përcjellë në vazhdimësi dhe problemi kryesor ka qenë raporti para Kuvendit dhe në rast kur raporti nuk kalon në Kuvend, cilat janë konsekuencat?

Nuk ka pasur asnjë parashikim ligjor deri më tash se cilat do të jenë konsekuencat ligjore nëse raporti nuk merr vota të mjaftueshme për të kaluar në Kuvend.

Ideja e futjes së sanksioneve është ide pozitive dhe mendoj që duhet të përkrahët si ide, por mënyra se si është elaboruar dhe si është prezantuar këtu është gabim. Nuk mund të marrë vendim komisioni për ta vlerësuar punën e një agjencie apo një bordi, por duhet seanca. Komisioni mund të rekomandojë aprovimin ose mosaprovimin e raportit, por jo ta vlerësojë punën dhe të thotë se puna është e keqe, ose e mirë.

Prandaj, në këtë rast, mendoj që formulimi është i gabuar dhe lë dykuptimësi në mes kompetencave të komisionit dhe kompetencave të seancës. I vetmi organ vendimmarrës në Kuvendin e Republikës së Kosovës është seanca e Kuvendit, e cila mund të marrë vendim dhe jo komisioni, sepse komisioni është një trup shumë i vogël punues dhe nuk mund të marrë vendime në emër të seancës.

Prandaj, mendoj se nëse e lejojmë këtë dykuptimësi do të krijojmë probleme në zinxhir për të gjitha agjencitë dhe bordit. Ideja është e mirë që të merren në përgjegjësi në rast se raportet nuk kalojnë, por zgjidhja, mendoj se nuk është e saktë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Më falni, por do ta kisha pasur një propozim, sepse po futemi në diskutime të paqarta. A do të kishim mund ta shtyjmë këtë...? Urdhëroni! Deputeti Besim Beqaj e ka fjalën.

**BESIM BEQAJ:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Besoj se të dy amendamentet të cilat u ngritën nga profesori janë amendamente të sakta dhe mendoj që nuk është kuptuar mirë nga deputetët, sepse kemi të bëjmë me dy çështje dhe kisha thirrur të gjithë deputetët që kur të diskutojmë për ligje paraprakisht t'i analizojnë ligjet dhe pastaj të diskutojnë për to.

Në amendamentin e parë flasim për raportin i cili duhet të kalojë në Kuvend dhe në rast se ai nuk kalon dy herë në Kuvend, atëherë mund të nisen procedurat për trajtimin e saj dhe specifikohet

saktësisht se në çfarë rastesh mund të shkarkohen bordet. Pra, është mënyrë decisive, shumë të saktë e specifikuar.

Ndërsa, roli i komisionit është në amendamentin tjetër. Aty ku thotë Qeveria i propozon, pra në kushte normale Ministria e Administratës Publike e fillon procedurën për borde dhe ai tani e dërgon në Qeveri, dhe Qeveria i propozon Kuvendit dy emra, ka qenë në mënyrë që të ruhet pavarësia. Është konstatim edhe i Komitetit të Energjisë, për ta ruajtur pavarësinë dhe Ministria ia dërgon komisionit, komisioni i bën procedurat, pra i merr, i trajton, sikur në rastin që e kemi të Bordi i RTK-së dhe bordeve të tjera. Pra, e kemi një situatë krejt ndryshe.

Në rastin e parë komisioni merret vetëm me procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të bordit ndërsa kur është fjala për përgjegjësinë e anëtarëve të bordit fjalën e fundit e ka Kuvendi, seanca.

KRYETARI: Profesor, Armend Zemaj, prapë u lajmërua. Ju Profesor e merrni fjalën në fund që ta kemi propozimin si duhet, se seanca në fund vendos. Armend, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Unë prapë po theksoj dhe po flas në aspektin ligjor. Nuk po hy në përmbajtje e logjikë këta çka kanë dashur të arrijnë komplet me projektligjin dhe gjithë atë vizionin e tyre për ta vlerësuar punën dhe performansën e një institucioni, sepse edhe vetë këtu nuk flasin për performansën, por thonë nëse nuk kalon raporti vjetor.

Dhe, tash, nëse nuk kalon raporti vjetor dy herë radhazi, pse këta e kanë theksuar që komisioni funksional mund të nisë procedura? Ligji nuk ka mund. Do të thotë ose duhet të thuhet “është obligative” ose “joobligative”. Kjo është esenca.

*(Ndërrhyrje)*

Po për cilën pjesë e ke? Ne për amendament, po e lexojmë amendamentin. Po e lexojmë pjesën që ju e keni paraqitur.

KRYETARI: A ka mundësi se jemi duke u futur në diskutime dhe ne menduam që t’i kryejmë edhe dy pika të rendit të ditës. Urdhëro deputeti Beqaj. Pastaj Raif Qela e ka kërkuar fjalën.

BESIM BEQAJ: Faleminderit! Prapë po ju lus që kur të flasin deputetët, në këtë rast kryetari i Komisionit e tha se ka dallim prej amendamentit i cili është dorëzuar dhe tha që është duke e lexuar një amendament të ri të cilin ne po e propozojmë si komision. Prandaj, ju lutem mos bëni intervenime në ligje të cilat janë ad hoc, pa i lexuar dhe pa dëgjuar fare se çfarë u tha. Nuk është në rregull!

KRYETARI: Atëherë, Arbeni e do fjalën për replikë! Më tutje Raif Qela, dhe pastaj Profesori.

ARBEN GASHI: O zotëri, ky është Kuvend! Unë do ta përfundoj replikën time. Ky është Kuvend dhe Kuvendi punon me letra. Deputetët nuk e kanë këtë për çfarë po flet zotëriu parafolës. Ai po flet përmendsh. Deputetët duhet ta kenë variantin e shkruar se çka të votojnë. Ose duhet të thuhet se është një amendament që propozohet këtu për këtu tani dhe me na e dhënë

formulimin. Ne po punojmë me letra dhe ne s'kemi letra para vetes. Këta e kanë një situatë imagjinare që e kanë para syve të vet, dhe kështu nuk mund të punojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Arben, mos e ndërprit! Ky është propozimi që na e sjellin me shkrim dhe ne e trajtojmë. Për kundër-replikë, Besim Beqaj!

BESIM BEQAJ: Zoti kryetar!

Ne nuk i ka 10 minuta që votuam një amendament të një deputeti i cili nuk e ka prurë me shkrim hiq. Ju para veti keni një propozim të lexuar saktësisht nga kryetari i komisionit dhe të cilin nuk e keni dëgjuar, prandaj kryetari i Komisionit le ta lexojë amendamentin dhe ka të drejtë ta bëjë dhe mbi leximin e amendamentit, atëherë le të flasin të tjerët.

KRYETARI: Faleminderit! Raif Qelaj dhe Profesor bëhu gati, në fund do ta merrni fjalën dhe kërkoj falje profesor. Urdhëro Raif!

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Ju lus për pak qetësi, në mënyrë që të përpiqemi ta sqarojmë gjendjen. Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri i ka përgatitur të gjitha amendamentet në projektligjin në fjalë. Në momentin e fundit, para dy ditësh, ka ardhur një shkresë prej zëvendës drejtorit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë i cili është njëkohësisht edhe i ngarkuari i SKE për çështje ligjore dhe ka thënë se këto çështje duhet t'i trajtoni ndryshe, respektivisht ka dhënë vërejtje në katër çështje.

Ndër çështjet në të cilat ka dhënë vërejtje, është edhe kjo të cilën e përmendi edhe kryetari i Komisionit.

Vërejtjet që i dha dikush prej deputetëve më parë, është në amendamentin të cilin e ka dhënë komisioni, e të cilin e kemi plotësuar sot me propozimin që e dha kryetari i Komisionit, zoti Muhamet Mustafa. Dhe, formulimi i ri është ky dhe dëgjoni ju që e kundërshtuat.

Ka qenë përpara kështu: “Në rast se Kuvendi dy vite radhazi nuk e miraton raportin vjetor të Operatorit të Sistemit të Transmisionit, Komisioni funksional mund të nisë procedurën e shkarkimit të kryesuesit dhe anëtarëve të bordit”, pra ka qenë propozimi nga komisioni.

Dhe, pas vërejtjeve që na i ka dhënë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, formulimi i ri i cili është propozuar sot prej kryetarit është ky: “Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkim të kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit kur pas dy vjetëve të njëpasnjëshme të rishikimit të performansës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Komisioni funksional gjen se, do të thotë të gjetura, Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë dhe dështimi i tillë i zbatimit ka dëmtuar seriozisht funksionimin efikas, efektiv dhe të pavarur të sistemit të operimit të transmisionit”. Ky është formulimi i tashëm.

KRYETARI: Faleminderit! I nderuar deputet Nuredin Ibishi, a je paraqitur për fjalë se e lamë Profesorin. Urdhëro!

NUREDIN IBISHI: I nderuar, zoti kryetar,

Ja kemi filluar jo si i përngjan Kuvendit, po sikur në formulime po shkojmë ad-hoc, çka i bie në mend njerit, a kjo merr formën e ligjit këto amendamente.

Mendoj që nuk është në rregull kështu dhe kam qenë kundër, i vetmi isha kundër, ia kemi nisur të bëjmë hajgare me ligjet tona dhe në këtë rast ju kisha lutur, nëse e bëjmë një amendament, të jetë në formë të shkruar, ta shpërndajmë edhe ta miratojmë. Po u bë një përjashtim, atëherë le të vendosë Kuvendi si do ta bëjë.

Mirëpo kjo formë e procedimit dhe përjashtimit, edhe formulon amendamente ad-hoc nuk është parë asnjëherë në Kuvend.

KRYETARI: Profesor, zonja Synavere Rysha u lajmërua, pastaj ju e keni fjalën, nuk ka më të lajmëruar.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj se ky amendament nuk ka vend në këtë ligj. Kisha kërkuar vëmendjen, sepse thjesht po dua ta trajtoj nga këndi i auditimit.

Në Kuvend duhet të kemi parime ose duhet ta rregullojnë çështjen e raportimit në Kuvend, e jo te ligjet e veçanta. Kemi shumë borde dhe agjenci të ndryshe, te të cilat nuk është i normuar ky amendament apo nuk është i paraparë, prandaj nuk ka nevojë të futet këtu, ndërsa për agjenci të tjera të kemi standarde të tjera.

Nëse ka nevojë të futet si amendament, atëherë ta gjejmë, ndoshta te Ligji për menaxhimin e financave, ta fusim, sepse aty e ka vendin, e jo në këtë ligj. Në qoftë se veprojmë në këtë mënyrë dhe nuk veprojmë si për agjenci të tjera, atëherë është e padrejtë kjo.

Unë personalisht mendoj se duhet hequr ky amendament dhe të kemi parime si Kuvend, nëse nuk kalon një raport i një agjencie, atëherë të fillojnë procedurat e shkarkimit, qoftë edhe një raport apo dy vjet apo tre vjet radhazi, varet, kjo të jetë normë për të gjitha agjencitë dhe bordet e veçanta. Faleminderit!

KRYETARI: Kam marrë sinjal prej deputetëve, 10 vetë m'u kanë lajmëruar menjëherë për fjalim. Profesor, urdhëro, e përgatiteni për votim, dhe të votojmë si dëshirojmë ose vendosim për shtyrje. Urdhëro!

MUHAMET MUSTAFA: Ne e kemi analizuar në Komision disa herë, jo një herë. Sot e kemi analizuar përfundimisht dhe kemi harmonizuar gjithçka me komunitetin e energjisë.

Kjo që u brengosën, unë e kuptoj se janë të lodhur dy kolegët edhe Zema, edhe Arbeni, faktikisht fshihet ai tekst dhe është teksti që unë e lexova, e lexoj për së dyti dhe Raifi që është një tekst shumë më i mirë që balancon përgjegjësinë dhe pavarësinë e bordit, sepse teksti qysh e kemi dhënë ka mundur ta lëndojë pavarësinë e bordit. Mu për këtë kemi pranuar tekstin e dytë, në qoftë se duhet po e lexoj edhe një herë, por është teksti që e lexoi Raifi dhe që e lexova unë.

E dyta, kjo që tha kolegu Nuredin Ibishi, ka të drejtë, por mua sot në Komision më thanë mundeni me i dhanë edhe kështu, se edhe unë pata më qejf t'i sillja me shkrim, por ne i lexuam në mënyrë shumë të qartë.

Kjo që tha kolegja Rysha, ne për të gjitha ndërmarrjet publike në Ligjin për ndërmarrjet publike e kemi sanksionuar diçka të ngjashme si në këtë ligj, por tash KOST-i, për shkak se duhet të ndahen prej KEK-ut, KOST-i kalon në mbikëqyrje të Kuvendit dhe ka qenë e nevojshme që atë që e kemi thënë për të gjitha ndërmarrjet në Ligjin për ndërmarrjet publike, praktikisht e themi këtu edhe për KOST-in. Prandaj, nuk është e saktë që vetëm për KOST-in po bëjmë këtë.

Unë ju ftoj që ta votoni mundësisht këtë që e propozuam ne, për arsye se është mirë e studiuar, është zgjedhje e mirë edhe i kontribuon zhvillimit të këtij sektori. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Amendamenti 14.

Propozimi i Komisionit FunkSIONAL, i lexuar, është për votim, në mënyrë elektronike, në qoftë se doni votonim, në qoftë se jo, vendosni vetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, ajo çfarë ka lexuar kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Muhamet Mustafa, votojmë tash:

U votua amendamenti 14.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara, 58.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se 66 deputetë kanë marrë pjesë në votim, 58 kanë votuar për, 8 kanë abstenuar. Kuvendi e miratoi Ligjin për energjinë elektrike.

## **11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë Elektrike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zoti Muhamet Mustafa, që para deputetëve të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

**MUHAMET MUSTAFA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari kryeministër edhe zëvendëskryeministër,

Edhe ky ligj, pra, është i një rëndësie të madhe si ligji që folëm dhe është bërë një punë e madhe dhe janë bërë amendamente të mira. Edhe këtu kemi vetëm dy intervenime, në amendamentin 17 dhe në amendamentin 19, të tjerat mund të votohen në bllok.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nuk ka të lajmëruar për fjalë.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 50 amendamente, urdhëro, zoti Damka.

FIKRIM DAMKA: Për amendamentin që ne e kemi propozuar duhet të theksoj që amendamentin 7b do ta tërheqim, sepse Komisioni Funkcional e ka përfshirë atë që ne kemi dëshirë, a për amendamentin 14 do të votojmë.

KRYETARI: Atëherë, i kemi 44 amendamente të propozuara.

Amendamenti numër 7, është vetëm një propozim, nuk është së më herët, edhe 14-shi është hequr. Janë 44 amendamente. Përgatitemi, në qoftë se pajtohem, të gjitha janë një propozim.

Vetëm 14-shin, Profesor, i kemi pasur dy propozime, 19 nuk kemi. Urdhëro!

MUHAMET MUSTAFA: Unë thashë që amendamenti 2 propozime, ata po e tërheqin amendamentin, për arsye se e kemi përfshirë diku tjetër, kështu që ai më nuk është më valid.

E dyta, unë thashë që duhet të ndalemi te amendamentet 17 dhe 19 për arsye se ka plotësime të ngjashme me ato që i bëmë në ligjin paraprak.

KRYETARI: Urdhëro, zoti Damka!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, zoti kryetar!

Amendamentin 7 është saktë që e kanë përfshirë, po amendamentin 14 nuk e kanë përfshirë. Amendamenti 14 flet për bordin, në të cilin ne kemi propozuar që të jenë 7 anëtarë, unë nuk e di ku e kanë përfshirë që janë 7 anëtarë.

KRYETARI: Atëherë, shkojmë kështu, të mos e komplikojmë, 44 amendamente.

Amendamenti 7, faktikisht është një propozim, amendamentet 14, 17 dhe 19 nuk votohet, të gjitha të tjerat, 41, me aprovimin tuaj i vë në votim, pastaj këto të rejtat shkojmë një nga një. Amendamenti 14, 17 dhe 19 nuk janë në paketë të votimit tonë formal.

A ka kundër për 41 amendamente, përveç 14, 17 dhe 19: a ka abstenim? Aprovohen të tërat, atëherë.

Shkojmë te amendamenti numër 14.

I kemi dy propozime.

Votohet për propozimin e Komisionit Funkcional një herë vetëm, votojmë në mënyrë elektronike:

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e amendamentit numër 14 me propozimin e Komisionit Funkcional, votojmë tash:

Për amendamentin 14, propozimi i Komisionit Funkcional, 48 vota për, 5 abstenime dhe 10 kundër.

Shkojmë propozim B, Grupi Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e Komisionit funksional, amendamenti numër 14.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Propozimi i Grupit Parlamentar “6+”, amendamenti 14, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash: edhe një herë, sepse kemi gabuar, të lutem, regjia edhe një herë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim, amendamentin 14 pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, propozim i Grupit parlamentar “6+”, votojmë tash:

Kanë votuar 11 për, 16 abstenime dhe 34 kundër. Faktikisht kalon amendamenti 14 me propozimin e Komisionit FunkSIONAL.

Profesor, fjala është për ju te amendamenti 17, ai çfarë e propozon deputeti Muhamet Mustafa vihet në votim automatikisht nga unë.

MUHAMET MUSTAFA: Amendamenti 17 që ndërlidhet me nenin 8 ndryshon si vijon, pika 2 me tekstin “Personeli i punësuar në rregullator ka statusin e shërbyesit civil”, fshihet ky tekst për arsye se rregullohet me ligje të tjera.

KRYETARI: Lus deputetët dhe regjinë të përgatitemi për votim, amendamenti 17, propozimi i deputetit Muhamet Mustafa, si kryetar i Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash!

44 vota për, 10 abstenime dhe 10 kundër. Kalon amendamenti 17.

Kalojmë në amendamentin 19, po ashtu ju kërkoj vëmendje.  
Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Muhamet Mustafa, e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Amendamenti 19, ju lutem të më dëgjoni, është i ngjashëm me tekstin që e debatua te Ligji i energjisë elektrike, por për hir të regjistrimit duhet të lexohet.

Pra, amendamenti 19, faqe 26, pika 3 që ndërlidhet me nenin 10, teksti si vijon: “Në rast se Kuvendi i Republikës së Kosovës dy vjet radhazi nuk e miraton raportin vjetor të Rregullatorit, Komisioni FunkSIONAL mund ta nisë procedurën e shkarkimit të kryesuesit dhe anëtarëve të bordit”, ky tekst fshihet.

Dhe, pika 3, teksti i ri është si vijon: “Kuvendi i Kosovës mund të nisë procedurën për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Rregullatorit kur pas dy vjetëve të njëpasnjëshme të rishikimit të performancës së ZRRE-së Komisioni FunkSIONAL gjen se.

3.1. Rregullatori nuk ka arritur të dëshmojë se plotësisht dhe në mënyrë aktive ka zbatuar funksionet dhe detyrat sipas ligjeve që rregullojnë sektorin e energjisë në Kosovë, dhe



3.2. Dështimi i tillë i zbatimit ka dëmtuar seriozisht rregullimin efikas, efektiv, të pavarur të sektorit të energjisë”. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, profesor!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, amendamentin 19, votojmë tash:  
42 deputetë kanë votuar për, 12 abstenime dhe 7 kundër, u votua amendamenti numër 19.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.  
Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:  
46 vota për, 8 abstenime dhe një kundër, do të mundohemi edhe një herë se nuk e ke totalin.

Lus regjinë dhe deputetët të votojmë projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara.  
Votojmë tash!

Atëherë 42 vota për, 8 abstenime, një kundër, Kuvendi nuk e miratoi Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

## **12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gazin natyror**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për gazin natyror dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zoti Muhamet Mustafa, që para deputetëve të paraqesë dhe të arsyetojë raportin me rekomandime.

MUHAMET MUSTAFA: Sa i përket këtij, i keni amendamentet, nuk ka shtesa, nuk ka korrigjime.

Dëshiroj të theksoj se sa i përket Ligjit për energji, nuk kaloi, por deputetët nuk votuan, deputetët duhet të votojnë. Kështu duhet të jetë konstatimi.

Mendoj se me një mosvotim të tillë dëmtojnë seriozisht ecuritë e sektorit të energjisë në komunitetin evropian të Kosovës. Prandaj, ju lutem që kjo çështje të merret me seriozitet dhe të mos vendosim në afekt. Kaq!

KRYETARI: Faleminderit, Profesor!

Për këta që nuk kanë votua profesori mirë e ka, se nuk ka kaluar këtë herë, por pa kaluar 61 vota për, ajo do të kthehet prapë në votim, por sot nuk ka kaluar, në fakt, por votimi duhet të ndodhë. Pa i kaluar 61 nuk është që s'ka kaluar.

Atëherë jemi tek shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gazin natyror.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 50 amendamente.

Votojmë për 50 amendamentet, e propozuara në tërësi, sipas asaj çfarë na ka paraqitur Komisioni Funkcional.

Kush është kundër? A ka abstenim? Nuk ka. Atëherë kalojnë 50 amendamentet dhe miratohen.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

55 vota kanë votuar për, 6 kanë abstenuar, asnjë kundër. Kuvendi e miratoi Ligjin për gazin natyror.

### **13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës**

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën e zëvendësauditorit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur propozim-vendimin për miratim.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, për arsyetimin e propozim-vendimit.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë tani do të lexoj propozim-vendimin me kompetencë pas konsultave dhe aprovimeve që kam marrë nga anëtarët e Komisionit që është më i ndryshëm nga ai që është dhënë në raport.

Propozim-vendim për caktimin e pagës dhe shtesave të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

1. Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës i caktohet paga në shumën prej 1 mijë 875 euro e 0,90 centë bruto në muaj, dhe shtesat që janë të barasvlershme me shtesat e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
2. Niveli i pagës dhe shtesave të auditorit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës sipas pikës 1 të këtij propozim vendimi zbatohet duke filluar nga data 30 mars 2016, e deri në miratimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë publikë. Domethënë votohet këtë që unë e lexova.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, kryetari i Komisionit Funkcional e ka dhënë propozimin. Zonja Pantina e keni kërkuar fjalën, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Është më se e qartë se secili që e kryen një punë duhet të paguhet për punën që e bën, natyrisht se kjo vlen edhe për auditorin e përgjithshëm madje është e padrejtë se pse deri më tani auditori nuk ka marrë pagë.

Mirëpo, mënyra se si i kërkohet Kuvendit tani që të vendos për pagën e auditorit është jo parimore, bile edhe jo ligjore dhe jo e drejtë. Edhe pas tetë viteve të pavarësisë Qeveria si kjo e tanishme, edhe ato të mëhershmet nuk kanë arritur të hartojnë Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publik. Janë dhënë qindra e mijëra euro e ndoshta edhe miliona për hartim të strategjive për

reformim të Administratës Publike e kur duhej të përfshiheshin edhe standardizimi i pozitave dhe nivelimi i pagave, po asnjëherë kjo strategji nuk u zbatua në praktikë dhe i gjithë sistemi i pagave të zyrtarëve të administratës publike është një katrahurë dhe në veçanti kur flitet për agjencitë dhe institucionet e pavarura, e të cilat paguhen nga buxheti i shtetit.

Përderisa në një institucion të tillë të pavarur, një anëtarë bordi paguhet deri në 2 mijë euro e një drejtor ekzekutiv mbi 5 mijë euro në një institucion tjetër të pavarur, pagesa është krejtësisht ndryshe për pozitat e ngjashme dhe kjo të lë përshtypjen se niveli i pagës nuk është vendosur në bazë të specifikave të punës dhe kualifikimeve të kërkuara, por është në bazë të njerëzve që i kanë mbajtur ato pozita dhe afërsive të tyre me njerëzit e pushtetit.

Kush mund ta shpjegoj ndryshe se pse për shembull, drejtori i trustit u dashka ta ketë pagën trefish më të madh se auditori i përgjithshëm. Ndarja e tillë e pagave në institucionet publike jo vetëm që është joparimore e në shumë raste edhe jo ligjore, sepse nuk përcaktohet me asnjë ligj, por mbi të gjitha është jashtëzakonisht e padrejtë. Përderisa paga minimale në Kosovë është vetëm 170 euro, pagat e funksionarëve të lartë përfshirë këtu edhe pagat tona, pra pagat e deputetëve shkojnë deri në dhjetëfishin e pagës minimale. Për më tepër, shumica e pozitave të funksionarëve gëzojnë edhe beneficione të tjera shtesë.

Është më se e kuptueshme se jo të gjithë njerëzit që punojnë në institucionet shtetërore duhet të paguhen njëjtë, sepse secila punë dhe pozitë i ka specifikat dhe peshën e përgjegjësisë të ndryshme, por përderisa një mjek specialist të cilit i duhen 20 vite shkollim për ta arritur kualifikimin e ka pagën 600 euro për 40 orë punë në javë, në anën tjetër një anëtar bordi i një agjencie të pavarur paguhet deri në 2 mijë euro vetëm për një takim në muaj dhe me të vetmin kualifikim real që e ka është afërsia me partinë politike në pushtet. Kjo është tërësisht e padrejtë dhe jo parimore.

Prandaj, çështja e pagave përfshirë ato të funksionarëve të lartë, përfshirë këtu edhe të auditorit të përgjithshëm duhet të rregullohet me ligj e jo me vendime ad hoc dhe Ministria e Administratës Publike duhet ta sjellë në Kuvend Ligjin për paga sa më parë.

KRYETARI: Qetësi, ju lutem! Kërkoj falje deputete e nderuar, qetësi kur flasim, si kolegë qetësi. Urdhëroni, deputeti Nuredin Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Së pari unë jam kundër personalisht këtij propozimi të komisionit, për arsye se s' di a bëhet kiameti për një pagë të auditorit të përgjithshëm kur ata kandidatë që kanë konkurruar për këtë post çdo herë e kanë pasur parasysh edhe pagën normalisht, edhe tash përnjëherë na po ua premë. Edhe kur bëjmë krahasimet me disa pozicione edhe të Trustit, edhe të Thesarit të drejtorëve, tash pa marrë parasysh si janë ata të paguar edhe në veçanti erdh propozim krejt kjo kur ka të bëjë me një kandidatë që është vendor.

Sa ka qenë i huaj gati kurrkush përveç shoqërisë civile se ka debatuar më shumë edhe personalisht jam kundër kësaj, derisa të bëhet Ligji për pagat e zyrtarëve të lartë edhe nuk bëhet

kiameti pse qoftë ky post apo postet tjera të mbajnë këto paga edhe me ligj kjo të rregullohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit Funkcional e ka fjalën prapë, zoti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Për korrektësi që deputetët është dashur ta dinë, zoti kryetar, që para Auditorit Gjeneral ... kemi votuar përpara ka qenë ndërkombëtar dhe ai është paguar prej buxheteve të tjera, jo prej Buxhetit të Republikës së Kosovës dhe tash kemi një situatë ku auditori është në funksion, të cilin ne e kemi zgjedh dhe nuk është në pagë, sepse pagën duhet t'ia caktojë Kuvendi i Kosovës. Dhe ne sot marrim këtë vendim për ta caktuar pagën deri në nxjerrjen e Ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë, kjo është e drejtë.

KRYETARI: Faleminderit! Ta konstatojmë praninë e deputetëve në sallë edhe do të shkojmë në votim me propozimin e komisionit funksional. Deputetë, jemi para votimit, i kemi 58 deputetë në sallë.

Kryetarët e grupeve parlamentare kisha dëshiruar ta dimë gjendjen cila është. Atëherë, deputetë 62 deputetë janë në sallë. Kisha kërkuar nga ju vëmendje, vazhdojmë me votimin e propozim vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, propozimi është a i merret parasysh ajo çfarë kryetari i komisionit funksional e tha. Votojmë tash!

50 deputetë për, 2 abstenime, 3 kundër. Do të provojmë edhe njëherë ju kisha lut deputetë të nderuar, vetëm për vëmendje, ndërkombëtarët e kanë kryer një punë të jashtëzakonshme por askush s'e ka ngrit çështjen e pagës së tij. Ky është vendor ndoshta pak është mirë mi jep një shtytje pikërisht pse është vendor. Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi edhe njëherë për votim, kjo në dorën e juaj. Votojmë tash!

Edhe kjo çështje 50 për, kanë votuar 4 abstenim, 1 kundër. Nuk e ka marrë formën e duhur për t'u refuzuar, shkon në seancën e radhës. Vazhdojmë me pikat e radhës të rendit të ditës.

Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka kërkuar fjalën.

ISMET BEQIRI: Kryetar, unë kisha propozuar që raportet që i kemi të shkojnë në një seancë tjetër dhe ne të kalojmë në pikat që i kemi paraparë të fundit 18 dhe 19, që i futëm në rend të ditës normalisht kjo kërkon edhe 2/3 e prezentëve shmangie nga procedura. Këto do të thotë nuk janë urgjente këto raporte dhe bën në një seancë të radhës, të ardhshme dua të them në mënyrë që të shkojmë për dy pikat e fundit të rendit të ditës 18 dhe 19. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetë të nderuar, kemi një propozim konkret nga shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që pikat:14, 15, 16 dhe 17 të mbeten prapa pikës 18 dhe 19. Faktikisht, pikat 18 dhe 19 kanë të bëjë me: Shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe Shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Para se ta procedojmë këtë propozim, unë duhet në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit duhet të shmangim Rregullore me 2/3 të deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare. Atëherë, në mënyrë elektronike do të votojmë për propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për shmangie nga Rregullorja.

Votojmë, regjia dhe deputetët i lus të përgatiten për votim. Votojmë tash!

58 deputetë kanë votuar, faktikisht e kemi një situatë reale në të cilën nuk kemi votim të deputetëve 61. Mund ta votojmë edhe një herë në qoftë se dëshironi, e provojmë edhe njëherë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, të nderuar deputetë, nuk e pati përkrahjen e deputetëve kjo shmangie nga Rregullorja për lëvizjen e pikave të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës. Po, do të vazhdojmë!

## **15. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës ka përgatitur dhe dorëzuar në Kuvend një raport vjetor që analizon aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë.

Raporti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik përbëhet prej dy pjesëve. Në pjesën e parë janë të pasqyruara të dhënat për të arriturat dhe zhvillimet në fushën e prokurimit publik në nivelin e Kosovës dhe pjesa e dytë që ka të bëjë me aktivitetet e KRPP-së në përmbushjen e obligimeve të përcaktuara ligjore përfshirë edhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit të këtij institucioni për vitin 2015.

Për periudhën raportuese 2015, 170 autoritete konkurruese i kanë dorëzuar me kohë raportet në KRPP. Numri i kontratave të nënshkruara ka qenë 10 mijë e 895 ndërkaq vlera e këtyre kontratave të nënshkruara është 401 milionë 800 mijë euro, duke mos përfshirë vlerën e pagesës së autostradës Prishtinë - Hani i Elezit që ka një pagesë prej 114 milionë e 577 mijë euro. Sipas burimit të financimit 62,4% të kontratave kanë qenë të nivelit qendror dhe shuma e paguar nga buxheti i Kosovës ka arritur vlerën prej 251 milionë euro. Ndërsa 36,71% e kontratave janë nga të hyrat vetanake apo 147,4 milionë euro që nga ky burim ka rritje prej 17,6 milionë euro.

Krahasuar me vitin 2014 vlera e kontratave prej donacioneve ka arritur në 3,3 milionë euro apo 0,82%. vlera e kontratave sipas procedurës së prokurimit, procedurë e hapur në total ka qenë e përdorur 84,23%. Procedura e negocimit pa publikim është 7,68%, ndërsa sa i përket nënshkrimit të kontratave të operatorëve ekonomik 75,76% janë operatorë vendor dhe 24,24% janë operatorë të huaj.

Raporti po ashtu përmban të dhëna dhe aktivitete të KRPP-së gjatë vitit 2015. KRPP-ja që ka të bëjë me monitorimin e autoriteteve kontraktuese dhe aktiviteteve të prokurimit, nga 42 autoritete kontraktuese sa janë planifikuar për monitorim janë realizuar 90% të aktiviteteve, apo janë monitoruar 38 aktivitete konkurruese, me gjithsej 285 aktivitete të prokurimit. KRPP-ja ka arritur të ofrojë një numër të konsiderueshëm të interpretimeve dhe këshillave profesionale dhe në këtë drejtim ka nxjerr katër udhëzime administrative në vitin 2015.

Është evidentuar bashkëpunimi me institucionin e Kosovës për administratë publike në procesin e trajnimit dhe certifikimit të zyrtarëve të Prokurimit Publik. Ajo që konsiderohet e arritur është zhvillimi i sistemit të prokurimit elektronik në bashkëfinancim me Bankën Botërore. Sa i përket raportit financiar, buxheti i ndarë për KRPP-në për vitin 2015 ka qenë në vlerë prej 913 mijë e 363 euro. Buxheti i rishikuar dhe ai përfundimtar ka qenë 878 mijë e 808 euro, buxheti i shpenzuar është 581 mijë e 101 apo 66.13%.

Në fakt raporti fillestar financiar i KRPP-së sikurse edhe tek rasti i OSHP-së që është shqyrtuar në komision ka qenë me gabime dhe si rezultat komisioni në bazë të vërejtjeve ka kërkuar nga KRPP-ja që të dorëzojë një raport të ri financiar të përmirësuar, gjë që është bërë dhe i është bashkangjitur rekomandimit të komisionit. Komisioni për Buxhet dhe Financa pasi e shqyrtoi raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015, dhe vlerësoi se raporti përmban kushtet ligjore të parapara me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë. Dhe, i rekomandon Kuvendit për aprovim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti kryetar i komisionit! Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj, besoj në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik i paraqet raport Kuvendit për të gjitha punët dhe aktivitetet e kryera për çdo vit kalendarik. Kështu që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015, raporti është i përgatitur mirë dhe përfshinë të gjitha të dhënat që është i obliguar Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik t'i raportojë, duke përfshirë këtu raportin financiar, të cilin e obligon ligji t'ia bashkëngjis raportit të punës.

Raporti përfshin në mënyrë të detajuar aktivitetet e Departamentit të rregullave dhe monitorimit, Departamentit të trajnimeve dhe teknologjisë informative, si dhe aktivitetet e kryetarit dhe anëtarit të Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Nisur nga fakti se vizioni i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është zhvillimi dhe funksionimi si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të prokurimit publik dhe prokurimi elektronik në Kosovë, atëherë nëse analizojmë me kujdes këtë raport vërejmë se janë bërë shumë përmirësime në sistemin e prokurimit, por situata ekzistuese në përgjithësi në prokurim, në institucionet publike në Kosovë, e obligon Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik si institucione të pavarura të bëjnë edhe më shumë në realizimin e objektivave të tyre të parapara me ligj dhe arrijen e vizionit dhe qëllimit për të cilin janë themeluar.

Nga raporti vërejmë se janë evidentuar 170 autoritete kontraktuese. Numri i kontratave të nënshkruara është më i vogël në vitin 2015 për 465 kontrata, krahasuar me vitin 2014, kurse vlera e kontratave të nënshkruara është më e madhe për 12 106 000 euro, krahasuar me vitin 2014.

Struktura e vlerës së kontratave sipas burimeve të financimit është 62,47% nga buxheti i Kosovës, 36,71% nga të hyrat vetjake, kurse vetëm 36,71% nga donacionet.

Numri më i madh i kontratave është për punë, duke përfshirë edhe autostradën që është 52,15%, për furnizim 36,67%, për shërbime 11,07% dhe në konkurs të projektimit 0,11%.

Përdorimi i procedurës së hapur në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara, që njihet si procedura më transparente, është përdorur më së shumti 76,35%, por krahasuar me vitin 2014, që ishte 83,38%, është më i ulët për 7,03%.

Pjesëmarrja e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës, procedurë kjo më pak transparente, është 16,10%, dukshëm më e lartë krahasuar me vitin 2014, që ishte 8,70%.

Përdorimi i kësaj procedure ka pasur tendencë të rënies që nga viti 2008, kurse në vitin 2015 shihet se është dyfishuar pjesëmarrja e kësaj procedure krahasuar me vitin 2014 dhe është në të njëjtin nivel që ka qenë në vitin 2008.

Procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës më së shumti e ka përdorur Telekom i Kosovës, që ka kontraktuar 37 775 000 euro, dhe Ministria e Arsimit.

Edhe më tutje problem mbetet planifikimi dhe menaxhimi i kontratave të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, duhet të bëjë më shumë në këtë drejtim, të ngrihen kapacitetet për planifikim dhe menaxhim të kontratave.

Sistemi i prokurimit duhet të shkojë drejt përdorimit të procedurës së hapur dhe zvogëlimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës.

Komisioni Rregullativ duhet të japë rezultate në këtë drejtim, sepse do të ketë efekte pozitive në procesin e prokurimit dhe efekte pozitive në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.

Raporti financiar i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ashtu sikur edhe i shumë institucioneve të tjera të pavarura, nuk është përgatitur ashtu si kërkojnë rregullat e raportimit.

Komisioni për Buxhet e Financa i ka rekomanduar që të plotësojë raportin sipas rregullave të raportimit dhe nga raporti i përmirësuar vërejmë se ky institucion ka shpenzuar mjetet 62,23%, 99,37% për paga dhe mëditje, 45,82% për mallra dhe shërbime dhe 30% për shpenzime komunale dhe 62 për investime kapitale.

Nga raporti vërejmë se procesi i prokurimit është më transparent krahasuar me vitet e kaluara dhe ka lëvizje pozitive në drejtim të prokurimit elektronik në saje të një projekti që financohet në formë huaje nga Banka Botërore.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka arritur t'i përmbushë rekomandimet që kanë dalë nga auditimi i këtij institucioni, kurse ka realizuar suksesshëm menaxhimin dhe mbikëqyrjen, pasi që në vitin 2015 ka realizuar në tërësi projektet të cilat i ka bërë për monitorim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet e Financa për të miratuar raportin e Komisionit rregullativ të prokurimit publik dhe u rekomandon deputetëve që ta votojnë këtë raport.

*(Drejtimin e mbledhjen e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Por, vlerësim s'ke të drejtë të bësh. Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim.

### **16. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015**

Komisioni Funkcional për legjislacion e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin.

Radha e diskutimeve është - nënkryetarja e Komisionit Funkcional për legjislacion, Selvije Halimi. Atëherë, kush e kërkon fjalën? Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar,  
Kolegë deputetë,

Flas në emër të Komisionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne e kemi shqyrtuar raportin e punës të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015.

Duke marrë parasysh detyrat dhe mandatin e Agjencisë, i cili përbëhet nga tri organe, gjegjësisht Sekretaria Ekzekutive, Komisioni për kërkesa pronësore të Kosovës dhe Bordi Mbikëqyrës, është vlerësuar pozitivisht puna për vitin 2015.

Tani e kemi edhe Ligjin e ri në fuqi, i cili bart edhe kompetencat dhe krijimin e Agjencisë, i cili ka të bëjë edhe me verifikimin dhe krahasimin e pronave.

Pak a shumë, mbeten sfida të njëjta ato që kanë qenë sa i përket uzurpimit të pronave, riuzurpimeve, por edhe çështjet që ndërlidhen me sferën e gjyqësorit.

Në emër të Komisionit dhe në emër të Grupit Parlamentar, ju ftojme që ta miratoni këtë raport kështu si është.

KRYESUESI: Kryetari i Komisionit për Buxhet e Financa, Naser Osmani, e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Agjencia Kosovare e Pronës ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor për financim për vitin 2015 brenda afatit ligjor.



Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit si dhe të dhënat për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitin paraprak.

Buxheti përfundimtar i AKP-së për vitin 2015 ka qenë 1 768 608 euro, ndërsa janë shpenzuar 1 713 711 euro, apo shprehur në përqindje buxheti është realizuar 96,89%. Me rishikim të buxhetit AKP-ja ka pasur një shkurtim të buxhetit prej 91 158 euro, ndërsa me vendim të Qeverisë buxheti është shkurtuar për 110 711 euro.

AFP-ja - do të thotë Agjencia e Pronave, sepse kemi me dy akronime të njëjta, për vitin 2015 ka realizuar të hyra në shumën prej 21 170 euro, të cilat janë bartur në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive: paga dhe mëditje 100%, mallra e shërbime 91,97% dhe shpenzimet komunale 100%.

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronave për vitin 2015 dhe ka vlerësuar se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për aprovim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim.

## **17. Shqyrtimi i raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015**

Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Medie e ka shqyrtuar raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

Tash unë këtu e kam emrin nga Komisioni, Zenun Pajaziti, mirëpo në emër të Komisionit kush e merr fjalën? Zonja Xhevahire Izma, në emër të Komisionit!

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Flas në emër të Komisionit dhe Grupit Parlamentar. Raporti i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil është një raport shumë profesional dhe raport, i cili i ka përmbledhur të dhëna interesante dhe pozitive për punën që e ka bërë ky institucion për një vit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës është kategori kushtetuese, i cili i raporton Kuvendit, dhe është një institucion i cili merret me ankesa të shërbimit civil në tërë Republikën e Kosovës.

Për këtë vit, është interesant të theksohet, është rritur numri i shërbyesve civilë, të cilët paraqesin ankesat e tyre dhe kjo tregon që është rritur besimi i shërbyesve civilë në këtë institucion.

Gjithashtu duhet të theksojmë se numri më i madh që vjen i ankesave në këtë institucion është nga niveli qendror, duke pasur parasysh se numri më i madh i shërbyesve civilë funksionon dhe kryen një punë në kuadër të institucioneve qendrore, mirëpo në kuadër të nivelit lokal në këtë vit, përkatësisht në raportin e vitit 2015 kemi pasur ankesa më të mëdha nga Komuna e Prishtinës. Nivelin qendror e theksojmë, sepse edhe një herë përsëritet do të thotë se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë vjen me ankesa më të mëdha prej shërbyesve civilë.

Këshilli gjatë vitit 2015 ka vëzhguar 68 procedura të rekrutimit dhe nga to si të rregullta e të aprovuara kanë qenë 34 procedura, ndërsa janë anuluar 34 procedura të tjera. Kjo është një punë, e cila bëhet gjatë rekrutimit të nëpunësve civilë të nivelit drejtues. Pra, Këshilli e ka edhe këtë mandat, të monitorojë rekrutimin e nivelit drejtues të shërbimit civil.

Në raportin që e kemi përpara, është një raport i cili përmbledh të dhëna të shumta, e unë do të theksoj një element, ku e kemi edhe një herë në këtë vit numrin më të vogël të femrave, të cilat paraqesin ankesa në kuadër të shërbimit civil dhe kjo nuk pasqyron realisht balancën e numrit të femrave që janë në shërbimin civil, pra e kemi një numër prej vetëm 28%, kurse 70% janë ata burra të cilët kanë ndoshta më shumë guxim ose besim në institucion dhe i kërkojnë ankesat e tyre.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e vlerëson pozitivisht punën e këtij komisioni dhe ju fton të votoni raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil. Pra, neve votojmë për. Faleminderit, nënkryetar!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Izmaaku. Fjalën e merr kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, për të arsyetuar raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015.

Sipas të dhënave të kërkuara, raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit si dhe të dhëna për shpenzimet e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimin me vitin paraprak.

Buxheti i Këshillit për vitin 2015 ka qenë 282,303 euro, ndërsa pas rishikimit të buxheti ka qenë në shumën prej 274,441 euro, kurse buxheti i shpenzuar është 276,871 euro, ose 99,44%.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë: paga dhe mëditje 99.72%, mallra dhe shërbime 99.39% dhe shpenzimet komunal 83.83%.

Komisioni për Buxhet e Financa, pasi e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil për vitin 2015, ka vendosur që të vlerësojë pozitivisht dhe t'i rekomandojë Kuvendit për aprovim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani! Fjalën e ka deputetja Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në raportin e punës për vitin 2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës paraqiten edhe disa sfida që është ballafaquar ky Këshill, siç janë edhe mungesa e mjeteve financiare edhe hapësira për punë elementare si dhe mungesa e stafit mbështetës.

Megjithatë, ky Këshill raporton se ka arritur që me sukses t'i kryejë lëndët dhe punën e tyre sipas Kushtetutës dhe ligjit në Kosovë.

Unë këtu paraqes vërejtje për të gjitha institucionet, të cilat pas ndërrimit të udhëheqjeve politike, sidomos në komuna, ku bëhet një diskriminim pa bazë ligjore i punonjësve duke ndërruar pozitat në vendet e tyre të punës dhe që pas ankesave të shërbimit civil këta nëpunës civilë marrin përgjigje pozitive nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, institucionet gjegjëse nuk i kthejnë ata në vendet e tyre të punës, që do të thotë se për një vit pune të këtij Këshilli puna e tyre nuk vlerësohet as nga komunat, e as nga institucionet e tjera prej nga nëpunësit civilë paraqesin ankesat për diskriminimin e tyre dhe për shkeljen ligjore në raport me ta nga autoritetet kompetente.

Prandaj, unë kërkoj nga Qeveria e Kosovës që të ndërmarrë masa, por edhe ne si Kuvend, që institucionet të cilat nuk i zbatojnë vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të merren masa sipas ligjit, nga se në këtë mënyrë po bëhet shkelje drastike e të drejtave të punëtorëve sipas Ligjit për shërbimin civil në institucionet e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Kolegë të nderuar, për tri raportet që i diskutuam, mbaruam diskutimin. Nesër vazhdon seanca në orën 11:00.

*(Ndërrhyrje)*

Bën, urdhëro! Fjalën e ka Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë po them hapur, së pari po shfaq pakënaqësinë time në joseriozitetin e disa kolegëve deputetë për mosqëndrim në sallë. E para!

E dyta. Po ashtu nuk pajtohem me interpretimin që po bëhet se ne nuk kemi të drejtë për pikat që i kemi futur në rend të ditës në fillim të debatojmë së paku për këtë që e kemi - për pikën e parë.

Absolutisht është interpretim i paqëndrueshëm për mendimin tonë, sepse kur kemi bërë propozimin, e kemi bërë shumë të qartë, pra që të futen këto pika në rend të ditës, që janë dy dhe ato janë futur në rend të ditës.

Më herët kur kërkoja, kërkoja që të bëhet zhvendosja e tyre para raporteve dhe nuk pati kuorum, OK. Por, ne tash i kemi këto pika dhe realisht e juridikisht ishte dashur të vazhdojmë debatin për pikat dhe është absurde të na interpretohet tash nga Sekretaria se s'keni të drejtë në debat. Kemi të drejtë të bëjmë debat, sepse ato pika janë në rend të ditës.

Prandaj, po them, pse të mos vazhdohet me pikat e tjera? Mirëpo, meqë interpretimi është i tillë, atëherë e thatë ju, vijmë nesër në seancë.

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, kjo që e thotë Ismet Beqiri është e vërtetë, ato janë në rend dite, por Ismet Beqiri s'po tregon që s'kemi kuorum. Ne mund të bisedojmë e të bëjmë biseda akademike, por për bisedë kuvendore duhet t'i kemi ekipet të bisedojnë këtu. Nuk është punë a duam! Ato janë në rend dite dhe absolutisht në rregull. Shihemi nesër në orën 11:00. Faleminderit!

\* \* \*

*E premte, 17 qershor 2016*  
*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16 qershor*  
*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,  
I nderuar kryeministër,  
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,  
I hap punimet e Kuvendit për vazhdimin e seancës plenare të filluar dje me pikat e rendit të ditës të papërfunduara.

Në sallë kemi numër të mjaftueshëm të të pranishmëve, janë rreth 85 deputetë.

Fillojmë me pikat në vijim: Po hyjmë menjëherë në votime, janë pikat e pavotuara dje, por të shterura me debat.

### ***11. Votimi i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë***

Kuvendi në seancën e djeshme ka miratuar 44 amendamentet e propozuara në Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë, por me rastin e votimit të tekstit të projektligjit me amendamentet e miratuara nuk ka pasur vota të mjaftueshme për miratimin e këtij projektligji.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit!

Kanë votuar 68 deputetë, për kanë votuar 60, kundër një, dhe kanë abstenuar 7 deputetë. Konstatoj që Kuvendi miratoi Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

### ***13. Votimi i Propozim-vendimit për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës***

Kuvendi në seancën e djeshme ka shqyrtuar Propozim-vendimin për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, por me rastin e votimit të Propozim-vendimit nuk ka pasur vota të mjaftueshme për miratim, andaj duhet ta përsërisim edhe një herë procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Kanë votuar 76 deputetë, për 67, kundër 7 deputetë, kanë abstenuar 2. Konstatoj që Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për caktimin e pagës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës deri në miratimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë.

### ***15. Votimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015***

Diskutimi për raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015 ka përfunduar në seancën e djeshme, por në mungesë të kuoromit votimi i këtij raporti është shtyrë për seancën e sotme.

Votojmë raportin e punës së Komisionit Rregullativ për Prokurimit Publik për vitin 2015.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Faleminderit! Kanë votuar 78 deputetë, për 58 vota, kundër 12, kanë abstenuar 8 deputetë. Konstatohet që Kuvendi miratoi raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2015.

### ***16. Votimi i raportit të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015***

Diskutimi për raportin e Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015 ka përfunduar në seancën e djeshme, por në mungesë të kuoromit votimi i këtij raporti është shtyrë për seancën e sotme.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Kanë votuar 84 deputetë, për 64 vota, kundër 8 vota dhe 12 kanë abstenuar. Konstatohet që Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2015.

### ***17. Votimi i raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015***

Diskutimi për raportin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015 është kryer, sot votojmë për shkak se nuk ka pasur kuorum.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tani:

Kanë votuar 81 deputetë, për 67 vota, kundër 8 vota dhe 6 kanë abstenuar. Konstatohet që Kuvendi miratoi raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2015.

Të nderuar deputetë,

Para se të fillojmë shqyrtimin e pikave 18 dhe 19 të rendit të ditës, duhet të miratohet propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për shmangie nga Rregullorja.

Ftoj zotin Ismet Beqiri që ta marrë fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Konform asaj që ne dje i kemi futur në rend të ditës këto dy pika. Unë sot në emër të Grupit Parlamentar propozoj që, në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtimi i këtyre dy projektligjeve të bëhet në procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3,8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit dhe atë si në vijim:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë dhe

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës që të bëhen në seancën plenare të sotme

Pas miratimit në shqyrtim të parë vetëm Komisioni Funkcional për Legjislacion të shqyrtojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit të bëhen po ashtu sot në seancë plenare, në një seancë tjetër, e cila do të bëhet pas përfundimit të seancës së parë dhe të jepej pauza, gjë që unë s'mund të predikoj në sa ora, por propozojmë që seanca e dytë të mbahet sot për leximin e dytë dhe për orën pastaj ju si kryesues dhe Kuvendi të vendosni kur do të mbahet.

Prandaj, lus deputetët që të miratojnë këtë propozim për shqyrtimin e këtyre dy projektligjeve në procedurë të përshpejtuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me dispozitat e Rregullores së Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqiri! Tani është koha e deklaramit të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për kryeministrin, kabinetin,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës edhe dje e ka thënë mendimin e vet, i ka dhënë mbështetje, por edhe sot ne e kemi analizuar këtë kërkesë me të gjithë deputetët dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e përkrahim këtë shmangie.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Ne dje kemi shprehur qëndrimin tonë se jemi kundër kësaj procedure të përshpejtuar të trajtimit të dy projektligjeve, njëri prej të cilit ka të bëjë edhe me vazhdimin e mandatit të EULEX-sit në Kosovë, për një arsye shumë të thjeshtë.

Prej 15 qershorit të vitit 2014 është ditur që fiks më 15 qershor të vitit 2016 EULEX-it i kalon afati, pra që dy vjet është ditur kjo datë dhe kjo vonesë është pa dyshim e qëllimshme, kjo ka mundur të bëhet ky trajtim shumë më herët edhe komisionet ta përfundojnë punën e tyre, sidomos Komisioni për Legjislacion.

Tash EULEX-si është qe dy ditë pa afat duke qëndruar në Kosovë, pa vazhdimin e mandatit të tij.

Unë mendoj që kjo është me qëllim prej koalicionit qeverisës dhe kjo vonesë mendoj që nuk u kontribuon vendimeve të mira për vendin tonë, sepse çështjet kur po bëhen shpejt e shpejt, punët kur po kryhen kështu shkel e shko, atëherë po na dalin natyrisht projektligje me gabime dhe kundër interesit të qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës.

Kjo është arsyeja pse jemi kundër këtyre vonesave të qëllimshme, të cilat pastaj po na hakmerren në cilësinë e vendimeve dhe të projektligjeve që po i miratojmë në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Konjufca. Fjalën e ka zoti Simiq, Lista serbe.

SLAVKO SIMIĆ: Zahvaljujem, podpredsedniče!

I Poslanička grupa Srpska lista takođe još juče razmatrala ovaj predlog, i mi smo dali ovom predlogu još juče podršku, tako da se slažemo sa predlogom Demokratskog Saveza Kosova da se ove tačke dnevnog reda uvrste danas. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+” zonja Serbica Shinik.

MÜFERA SERBICA-ŞINİK: Teşekkür ederim,  
“6+” Paralamenter Grubu LDK şefinin önerisini desteklemektedir.  
Teşekkürler.

KRYESUESI: Faleminderit!

Atëherë dua të sqaroj sipas nenit 84 të Rregullores së Kuvendit rregullat janë këto: për t’iu shmangur Rregullores Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhje. Shmangia mund të bëhet kur bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me standardet evropiane.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 85 deputetë, 80 janë për, 4 kundër dhe një abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë, dhe

2. Shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.



Kalojmë në pikën e tetëmbëdhjetë, sipas rendit të ditës, por në qoftë se duhet ministri i Drejtësisë, unë duhet të jap pauzë për 10-15 minuta derisa të vijë ministri dhe pastaj vazhdojmë. Faleminderit!

\* \* \*

*(Vazhdim i seancës pas pauzës  
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli)*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
Në qoftë se jemi gati kishim vazhduar seancën, jemi në pikën e tetëmbëdhjetë.

### **1. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë**

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zoti Hajredin Kuçi që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin, të njëjtën kohë thërras deputetët të kthehen në sallë.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit,  
Kryeministër,  
Të nderuar deputetë,  
Anëtarë të Qeverisë,  
Zonja dhe zotërinj,  
Më lejoni që të prezantoj para jush Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për misionin e Bashkimit Evropian për rend dhe ligji në Kosovë.

Të nderuar deputetë,  
Zonja dhe zotërinj,  
Ndoshta më lejoni që të bëj prezantimin tim në tri drejtime apo në tri pjesë.

E para, lidhur me procesin e negociimit që kemi pasur me KE-në.  
E dyta, me qëllimet e kësaj marrëveshje, dhe  
E treta, me siguri që edhe ju jeni të njoftuar me përmbajtjen e saj.

Lidhur me procesin më lejoni të them qysh në shtator të vitit 2015 Ministria e Drejtësisë, në koordinim të plotë edhe me pjesë të tjera të sistemit të drejtësisë, por edhe me qeverinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera vendore kemi koordinuar një strategji për tranzicionin e EULEX-it për këtë kohë.

Po ashtu dua të them se deri në prill të këtij viti nuk kemi marrë përgjigje nga organet kompetente të BE-së dhe nga prilli deri më tani kemi pasur tri takime të nivelit të lartë dhe disa takime të tjera të niveleve teknike.

Takimet e nivelit të lartë nga përfaqësuesit e BE-së që ka qenë në koordinim të plotë me zotin Kendi, komandat i operacioneve civile për misionet e BE në botë dhe përfaqësuesit e tjerë të BE-së në Kosovë, por edhe të Ambasadës Amerikane janë mbajtur në nivelin më të lartë të Republikës, përfshirë presidentin e Republikës, kryetarin e Kuvendit, kryeministrin, ministrin e Punëve të Brendshme, kryeprokurorin, kryetarin e Gjykatës Supreme, atë të Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial dhe unë si ministër i Drejtësisë.

Po ashtu më lejoni të them që më datën 9 qershor të këtij viti, presidenti i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, ka dërguar te zonja Mogerini, si përfaqësuese e lartë e BE-së, letrën apo ftesën për të vazhduar misionin e EULEX-it në Kosovë.

Më datën 15 qershor, në orët e vona kemi marrë përgjigje dhe kjo ka qenë arsyeja që ju jeni njoftuar më datën 16 qershor në mëngjes.

Qëllimet e kësaj marrëveshjeje më lejoni të them në radhë të parë kanë qenë që të funksionojë apo të rriten kapacitetet në fushën e rendit dhe ligjit në Republikën e Kosovës, pastaj ka pasur dhe kemi qëllim që të rrisim kapacitetet në procesin e integritimeve evropiane dhe po ashtu qëllim primar ruajtjen e partneritetit tonë me BE-në dhe SHBA-në.

Natyrisht se në kuadër të qëllimeve negociuese kemi pasur për qëllim primar që të ruajmë sovranitetin e Republikës së Kosovës sa më shumë që është e mundur, të institucioneve tona vendore, por po ashtu të ruajmë dhe të shfrytëzojmë ekspertizën e ekspertëve të BE-së.

Në këtë drejtim kemi pasur qëllim që në kuadër të ruajtjes së sovranitetit të kemi një sistem unik të drejtësisë dhe besoj që kjo është e garantuar, përfshirë me gjyqtarë dhe prokurorë vendorë dhe të EULEX-it, të cilët do të kalojnë përmes procedurave të Këshillit Gjyqësor dhe me emërim nga presidenti i Republikës, si dhe kemi pasur po ashtu për qëllim që menaxhimi i institucioneve të drejtësisë të bëhet nga institucionet tona dhe besoj po ashtu ky qëllim është arritur.

Sa i përket ekspertizës po ashtu mendoj që kemi arritur të bëjmë një marrëveshje që të kemi prezencë edhe për dy vjet të misionit të EULEX-it në Kosovë, duke përfshirë gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it, duke përfshirë dhe rolin e tyre edhe në Gjykatën Kushtetuese.

Lidhur me ekspertizën, po ashtu më lejoni të them që ka qenë një temë e debatueshme. Për sqarimin tuaj, besoj që tani e keni edhe nga letrat e shkëmbyera, por edhe nga mediat, ka qenë dhe mbetet qëllim që rastet të shkojnë në një drejtim, qëllimi primar nga kërkesa e institucioneve të Kosovës dhe ato të EULEX-it, për raste të reja fjala, ndërsa jemi pajtuar në fund që edhe misioni i EULEX-it, autoritetet e EULEX-it, të bëjnë kërkesat e tilla, por kjo do të shqyrtohet dhe do të vendoset nga organet e Kosovës.

Unë jam i bindur që çdo rast, edhe kur institucionet vendore bëjnë kërkesa të EULEX-it, edhe e kundërta, do të jetë në dobi të rendit dhe ligjit në vendin tonë.

Dhe më lejoni krejt në fund të them që ka mbetur edhe sot e kësaj dite strategjia jonë që të lëvizim atë që e quajmë unë nga misioni në Komision, pra të përfundojë një ditë misioni i EULEX-it në Kosovë dhe të fillojë apo të vazhdojë mbikëqyrja nga Komisioni Evropian.

Andaj, ju ftoj që sot ta shqyrtoni dhe këto instrumente t'ri ratifikojmë në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Radha është e kryetares së Komisionit FunkSIONAL, zonjës Albulena Haxhiu, nëse është këtu. Nuk është. Atëherë fjalën e ka zonja SelviJE Halimi, nënkryetare.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të nenit 60 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16.6.2016 Komisioni shqyrtoi Projektligjin numër 05/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

#### R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji numër 05/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KRYETARI KADRI VESELI: Të nderuar deputetë, faleminderit shumë.

I nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Unë sot do të flas në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, po më tepër do të flas edhe në cilësinë e përfaqësimit tonë si Grup Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, shpreh edhe qëndrimin e qartë politik, të cilin e ka Partia Demokratike e Kosovës rreth të ardhmes së EULEX-it si komponentë e partneritetit tonë të vazhdueshëm me Bashkimin Evropian.

Në fakt, ky është një moment shumë i rëndësishëm për vetë faktin se, në qoftë se rikthehemi në një proces, i cili ka qenë disa dekada më herët për rrugëtimin tonë të lirisë shumë kush prej nesh do ta kishte parë ëndërr këtë moment në do të ketë mundësi Kosova si etnitet i veçantë me sovranitet të plotë juridik, kushtetues, politik, territorial të ketë mundësinë që perspektivën e vet të ketë edhe një marrëdhënie kontraktuale të veçantë si shtet i pavarur dhe sovran, me një komponentë shumë të veçantë, shumë perëndimore, pjesë e së cilës edhe vetë qytetarët tanë janë, edhe Republika jonë, të bashkëbisedojnë për të ardhmen tonë brenda Bashkimit Evropian.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të theksoj fuqishëm që në fillim. Se qëndrimi politik i Partisë Demokratike të Kosovës është që t'ia vazhdohet mandati EULEX-it në Kosovë. Ky nuk është vetëm qëndrim yni politik, por në të njëjtën kohë është një qëndrim, opion, alternativë e vetme e Republikës së Kosovës

dhe të gjithë qytetarëve tanë me orientimin e vet properëndimor, pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, në këtë kontest kemi të bëjmë edhe me të ardhmen e emisionit të Bashkimit Evropian, të komponentit të EULEX-it.

Ajo çfarë do të dëshiroja të flisja sot më shumë rreth të ardhmes së EULEX-it, të cilën do të dëshiroja ta ngritja si çështje, është mënyra e bashkëpunimit mes nesh.

Sa po e ndihmon kjo prezencë e Bashkimit Evropian nëpërmjet komponentit së vet, siç është EULEX-si në Kosovë, integrimin e Kosovës drejt strukturave të Bashkimit Evropian. Kemi bërë progres të jashtëzakonshëm me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, të njëjtën kohë kemi bërë progres në liberalizimin e vizave, po besojmë shumë dhe jemi të bindur se në fundin e këtij viti, përkatësisht nga dhjetori qytetarët tanë do të lëvizin lirshëm anekënd Evropës, ashtu siç edhe e meritojnë, po në të njëjtën kohë kemi një pjesë, në të cilën nuk kemi arritur progres. Çdo raport i progresit po edhe vetë qytetarët tanë janë duke e vërejtur se aty ku ka ngecje është veçanërisht mungesa e shtetit ligjor në Republikën tonë.

Unë do të dëshiroja që ky vazhdim i mandatit të EULEX-it të jetë një vazhdim i cili ko t'i kontribuonte pikërisht këtij rrugëtimi, e cila nuk do të krijonte fajësim mes palëve, për ta lënë në mes fajin jetim, siç fatkeqësisht po ndodh disa herë, për arsye se është qëndrim ynë, i të gjithëve se duhet të kemi shtet ligjor në Kosovë, duhet të kemi perspektivë ekonomike dhe në të njëjtën kohë duhet të kemi integrim drejt Bashkimit Evropian.

Do të dëshiroja veçanërisht, duke pasur parasysh se e kemi edhe përfaqësuesin e Bashkimit Evropian këtu në Kosovë, që ky mesazh yni bashkërisht, ky vendim yni të cilin do ta marrim sot në Kuvendin e Republikës së Kosovës, është një vendim i fuqishëm pro partneritetit me Bashkimin Evropian, pro orientimit tonë drejt Bashkimit Evropian, po në të njëjtën kohë dëshirojmë që bashkërisht të kemi rezultate më të mëdha, për arsye se ka nevojë Kosova të ketë rezultate edhe më të mëdha, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit, por në të njëjtën kohë të kemi partneritet në këtë proces, të mos ndahemi mes veti. Për arsye se nuk është e mirë në një moment të caktuar kur fajësia mund t'i hidhet njërës palë ose palës tjetër.

Sido që të jetë, çdo dështim i cili ndodh në komponentin e drejtësisë në Kosovë përgjegjësinë e marrim ne si kosovarë, për arsye se është vendi ynë. Edhe unë e di se është shumë përgjegjësi e komponentit të Bashkimit Evropian, as e përfaqësuesve të tyre nuk është shumë e madhe në kuptimin e një përgjegjësie e cila është para qytetarëve, aq më tepër një pozicion i cili është burokratik, i cili është një institucion në të cilin disa mund ta promovojnë veten drejt karrierës së tyre në instancat e Bashkimit Evropian, por ne nuk e kemi fare problem këtë pjesë. U dëshirojmë të gjithëve sukses që nga Kosova të lansohen edhe më lart pozicionet e tyre drejt përgjegjësi në Bashkimin Evropian, po në të njëjtën kohë duhet ta kemi parasysh se institucionet e Republikës së Kosovës, drejtësia në Kosovë, gjyqtarët tanë, prokurorët tanë, kanë mundësi, kanë aftësi, edhe duhet të kenë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, ia ndale kryetarit fjalën!

KRYETARI KADRI VESELI: Kryesuesi si ta vendosë, unë kërkoj falje. Atëherë do të jem shumë i shkurtër në pjesën e dytë.

Kjo është ajo e cila dëshirova të bashkëbisedoj, për arsye se në disa takime, kur i kemi pasur të përbashkëta drejt vazhdimit të EULEX-it, unë do të flas në mënyrë të hapur çka kemi folur brenda takimeve tona.

Ka qenë një shqetësim imi personal, në rend të parë, pse duhet të kemi datë aty, por qëllimi ynë është të integrohemi drejt Bashkimit Evropian, pse të përcaktojmë data, 2014, 2016, 2018. Ne jemi seriozë, ne marrim vendime, mund ta lëmë hapur fare bashkëpunimin tonë. Po, nuk është e mirë, nuk do ta ndihmojë as Kosovën, as komponentin e EULEX-it të fshihemi nga njëri-tjetri.

Drejhtësia, kudo që të jetë, duhet të jetë e barabartë për të gjithë. Nuk duhet të jetë çekan në të cilin të mbajnë shpresa kushdo që dëshiron ta eliminojë njëri-tjetrin politikisht. Nuk duhet të ndërtohet asnjë mentalitet në Republikën e Kosovës, as mes nesh, e aq më pak të mendohet të përdoret komponenti i Bashkimit Evropian për çekan të eliminimit të njëri-tjetrit.

Në të njëjtën kohë kisha dëshiruar, pa potencuar emra specifikë. Krimi i organizuar është vetëm krim, është mirë, po flas publikisht, të ndalen sulmet ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Deri në shtatorin e vitit 1999 ka pasur Ushtri Çlirimtare të Kosovës, ka pasur komandantë, për çdo sekondë të jetës së vet çdo ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e merr përgjegjësinë edhe krenohet për atë. Po le ta harrojnë të gjithë matrapazët, të gjithë akuzuesit se do t'i detyrojmë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ta ulin kokën për gjërat e liga, të cilat kanë ndodhur pas shtatorit 1999. Secili e merr përgjegjësinë e vet, qoftë ai qytetar, qoftë ish-ushtar. Këtu duhet bërë dallim, për arsye se shpeshherë po vërehet një ngulm shumë i madh, çdo herë fajtori kryesor kërkohet vetëm te ushtarët, te luftëtarët, mos i lodhni njerëzit, kanë ballafaqime, na kanë vdekur me dhjetëra e qindra pas lufte, e kanë situatën shumë të rëndë në familjet e tyre. Në të njëjtën kohë të sulmohen, ka emra, Kadri Veseli është emër, ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në qoftë se keni diçka thoni Kadri Veseli, shkoni në Prokurori, i thërras solemnisht, në qoftë se kanë nder, në qoftë se kanë dinjitet, në qoftë se e konsiderojnë veten qytetarë të denjë të këtij vendi, shkoni në prokurori. Çdo kund, mos iu frikoni askujt, i keqi është i keq, pavarësisht çka ka bërë dje, në qoftë se ka qenë edhe hero i luftës.

Por paragjykimet ndaj luftës, andaj ish-luftëtarëve duhet të ndalen. Në të njëjtën kohë për komponentin e EULEX-it u krijua një mendim se është këtu vetëm për ta luftuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Edhe kjo nuk është e vërtetë, nuk do të qëndrojë kjo. Kushdo që bën faj si qytetar i këtij vendi do të ballafaqohet, në të njëjtën kohë krimin duhet ta luftojmë ne vetë, duke u ndihmuar nga komponenti i Bashkimit Evropian. Pa shtet ligjor, e kemi bërë shumë abstrakt, nuk do të ketë investitorë vendorë. Bizneset tona nuk mund të zhvillojnë biznes të qëndrueshëm kur konkurrenca nuk është lojale. Nuk mund të kenë para të paguajnë taksat e Kosovës kur ai që qëndron prej taksapaguesve kosovarë, bartësi i institucioneve, qëndron si zot i vendit, kush është ai. Kjo duhet të transformohet, ata kanë më të drejtë se secili ministër. Ai i cili i mban 10 punëtorë, 15 punëtorë në Kosovë, 10 punëtorë, 15 familje, paguan taksa. Në të njëjtën kohë duhet të mendojmë pikërisht se pikërisht mungesa e shtetit ligjor nuk e sjell Diasporën e Kosovës të jetë fuqishëm me investime këtu në Kosovë. Të mos flasim për investitorët e huaj.

Jam në fund. Qëndrimi politik. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do ta votojë vazhdimin e mandatit të EULEX-it, kemi nevojë për një bashkëpunim, por për kolegët tanë perëndimorë kemi nevojë për besim edhe më të madh ndaj nesh, për arsye se jemi të gatshëm, jemi të aftë të ballafaqohemi me secilën sfidë, e cila na duhet të ballafaqohemi nga prokurorët dhe gjyqtarët tanë, po në të njëjtën kohë edhe nga bartësit e institucioneve. Faleminderit, suksese!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka për diskutim kryeministri i Kosovës, zoti Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

Të nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Dëshiroj edhe unë që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, por më vonë edhe në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetar i së cilës jam, shpreh qëndrimet lidhur me vazhdimin e mandatit të EULEX-it dhe arsyet pse ne konsiderojmë që EULEX-it duhet t'i vazhdohet mandati deri më 15 qershor të vitit 2018.

Unë mund t'ju them se si Qeveri kemi filluar me kohë të përgatitemi, kemi pasur një qasje shumë serioze sa i përket konceptimit të mënyrës së tranzicionit lidhur me EULEX-in, më 15 shtator të vitit të kaluar ne kemi pasur gati materialin tonë, të cilin e kemi dorëzuar në Bruksel, në mënyrë që ta marrim përgjigjen e tyre, por natyrisht që ka pasur një prolongim të kësaj përgjigjeje, në harmoni me atë që e tha edhe zëvendëskryeministri edhe ministri i Drejtësisë tani. Jemi angazhuar që thellësisht të trajtojmë këtë çështje me përfaqësues të Bashkimit Evropian.

Kemi inkuadruar të gjitha palët e interesit, ka qenë edhe presidenti i Republikës, kryetari i Parlamentit, unë si kryeministër i vendit, ministri i Drejtësisë, ministri i Punëve të Brendshme, Kryeprokurori i Shtetit, kryetari i Këshillit Prokurorial, kryetari i Këshillit Gjyqësor, drejtori i Policisë dhe kryetari i Gjykatës Supreme. Kemi marrë mendimet e të gjithëve dhe mendimi ynë i përbashkët ka qenë ky që është i përmbajtur në këto dy ligje. Prandaj, mund t'ju them që ato dy ligje paraqesin një mendim të konsoliduar dhe të harmonizuar të të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, qoftë atyre shtetërore, qoftë institucioneve të drejtësisë.

Ne kemi vlerësuar se EULEX-i duhet të mbetet edhe më tutje, në mënyrë që të vazhdojnë lëndët, të cilat i ka EULEX-i, sipas asaj që është përfshirë në këto ligje, në mënyrë që të tejkalojmë një zbrazëturë juridike, e cila mund të themelohet, por po ashtu që të thellojmë bashkëpunimin për të forcuar sistemin e drejtësisë në vend, për të forcuar shtetin ligjor, për të forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe për të siguruar që qytetarët tanë të ndjehen të sigurt, të lirë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, apo përkatësinë e tyre sociale.

Unë në emër të Qeverisë ftoj Kuvendin që të aprovojë këto dy ligje, shpreh po ashtu edhe qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës për përkrahjen e qëndrimit të mëtutjeshëm të EULEX-it, ashtu siç është paraparë me këto ligje dhe mendoj se me këtë ne po i kryejmë një shërbim forcimit të drejtësisë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar kryeministër! Zotërinj, nga grupet parlamentare a do të vazhdojmë, atëherë Glauk Konjufca e ka fjalën, të shkojmë një herë radhë.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, EULEX-i u krijua më 4 shkurt të vitit 2008 nga veprimi i përbashkët i Këshillit të Bashkimit Evropian. Ky ishte misioni më i madh edhe më i kushtueshëm i Bashkimit Evropian që prej themelimit, me një personel prej qindra vetash dhe me një mesatare të buxhetit vjetor prej rreth 200 milionë eurosh.

EULEX-i u konceptua dhe u quajt mision për sundimin e ligjit dhe brenda Bashkimit Evropian vjen drejtpërdrejt prej Departamentit të Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë. Pikë së pari, vetë shpallja e pavarësisë së Kosovës përmes planit të Ahtisarit, si pavarësi e mbikëqyrur, e imponoi në Kosovë një mision të Bashkimit Evropian që do të mbante kompetenca ekzekutive në disa fusha të institucioneve të Kosovës, siç janë: drejtësia, policia dhe doganat.

Nga zyrtarët ndërkombëtarë thuhej që Kosova nuk kishte kapacitete të brendshme për sundimin e ligjit, prandaj nevojitej një mision i jashtëm për ta mundur një gjë të tillë. Pra, vetë ligjërimi për justifikimin e EULEX-it e ka një problem të madh lidhur me shtetësinë, sovranitetin dhe pavarësinë e vendit. Pavarësia dhe sovraniteti i një shteti është argument i vetëmjaftueshëm, i kompetencave vetjake në institucione. Prania e EULEX-it e presupozon dhe e postulon paaftësinë dhe pamjaftueshmërinë vendore. Në këtë kuptim, EULEX-i e ka formën e tutelës dhe të paternalizmit. Ai në njëfarë mënyre e vendos papjekurinë e shtetit të Kosovës.

Problemi i dytë ka të bëjë me statusin e EULEX-it. Për shkak të kundërshtimeve të Serbisë, si dhe, siç dihet, për shkak të pesë vendeve të Bashkimit Evropian që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, EULEX-i përfundoi me status neutral në raport me Republikën e Kosovës. Kjo është një pengesë shumë e madhe për të kryer punë të mira. Statusi neutral i EULEX-it e ka çimentuar status quo-n në disfavor të Kosovës. Për shembull, kjo e ka mirëmbajtur ndarjen etnike të Kosovës dhe veriun e Kosovës të ndarë prej Republikës. E ka pamundur shtrirjen e pranisë institucionale të Republikës së Kosovës në pjesën veriore të shtetit që kontrollohet prej Serbisë. Meqë jemi te statusi i EULEX-it, këtu dua ta ngre edhe çështjen e imunitetit dhe të privilegjeve që i kanë pjesëtarët e EULEX-it.

Pjesëtarët e EULEX-it e gëzojnë statusin e të mbrojturit diplomatik përmes Ligjit nr. 03/L-033 për statusin, imunitetet dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore, personelin e Kosovës dhe praninë ndërkombëtare e ushtarake në Kosovë. Pra, përmes këtij ligji ata e gëzojnë imunitetin diplomatik edhe privilegjet e karakterit dhe të statusit diplomatik. Mirëpo, së pari, stafi i misioneve diplomatike e njih Kosovën. Për shembull ata që janë punëtorë të ambasadave, stafi diplomatik të shteteve nacionale e njohin shtetin e Kosovës, Republikën e Kosovës. Kurse EULEX-i si i tillë nuk e njih Republikën e Kosovës. Logjika e marrëdhënieve thotë se misioni diplomatik të njih si shtet, kurse ti si nikoqir e ke për obligim që t'ia garantosh imunitetin, statusin, privilegjet dhe të drejtat specifike.

Misioni i EULEX-it i gëzon të gjitha këto pa na njohur fare neve dhe, së dyti, pjesëtarët e EULEX-it janë shumë më të privilegjuar edhe se vetë stafet nacionale të misioneve diplomatike, shumë më të privilegjuar se ato. Stafet diplomatike nuk ushtrojnë kompetenca ekzekutive në

shtetet ku shkojnë, EULEX-i ushtron kompetenca ekzekutive në shtetin e Kosovës. Dhe, është shumë interesant të shihet se si në këtë ligjin që ua garanton statusin dhe imunitetin diplomatik punëtorëve të EULEX-it, për shembull, pika 4.4 e këtij neni thotë: “Ministri i Punëve të Jashtme mund ta njoftojë misionin që udhëheqësi i tij i misionit ose një anëtarë tjetër nga personeli i misionit është person non grata. Shpallet persona non grata dhe nuk është i pranueshëm në Republikën e Kosovës”.

Pika 4.5, thotë: “Në rast se ky anëtarë nuk revokohet brenda një periudhe të mjaftueshme kohore që nuk do të jetë më pak se 48 orë, edhe në rastet e urgjencës ekstreme, dhe jo më shumë se sa 30 ditë, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do ta njohë atë më si anëtar apo si pjesë të misionit dhe privilegjet dhe imunitetet diplomatike do të pushojnë në momentin e shpalljes së tij si person non grata”.

Kjo vlen për të gjitha misionet diplomatike, kjo është rregull universale e raporteve në mes të shteteve nikoqire dhe misioneve diplomatike, por shihni pastaj çka thotë pika 4.6 e ligjit. Thotë: “Ministri i Punëve të Jashtme nuk mund ta shpallë përfaqësuesin ndërkombëtar civil e as përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian ose një anëtar të personelit të tij ose anëtar të misionit të EULEX-it si person non grata”. Domethënë, ministri i Punëve të Jashtme e ka të ndaluar me ligj çfarëdo punëtori të EULEX-it që ta shpallë person non grata në Kosovë.

A këtë të drejtë e ka me të gjitha stafet e tjera diplomatike. Edhe nëse punëtori i EULEX-it bën gabim, edhe nëse ai bën veprim kundër shtetit të Kosovës, edhe ai nëse shpreh deklaratë, e cila e kërcënon sovranitetin apo e lëndon shtetësinë e Kosovës, është e ndaluar me ligj që të veprojë siç vepron, për shembull, ministri në raport me misionet e tjera diplomatike. Kjo qartazi tregon se EULEX-i me status qëndron edhe më lart se misionet diplomatike të shteteve që na kanë njohur, sepse me ligj e kanë të garantuar se çfarëdo që veprojnë e deklarojnë, edhe në rastet kur kjo hapur e sfidon shtetin tonë, autoritetet tona as nuk kanë të drejtë të aplikojnë mjetet e veprimit për ta shprehur mospajtimin dhe qortimin e karakterit diplomatik.

Dhe, ky është njëfarë paradoksi, se EULEX-i dhe punëtorët e tij që nuk na njohin kanë privilegje edhe imunitet më të lartë se sa stafet diplomatike që na njohin.

Problemi i tretë ka të bëjë me punën e misionit të EULEX-it dhe me rezultatet e tij. Arritjet e tij krahasuar me kompetencat dhe buxhetin shumë të madh që e ka janë vërtet modeste, për të mos thënë shumë të varfra. EULEX-i erdhi për sundimin e ligjit në Kosovë, si dhe për luftim të krimit dhe të korrupsionit, e tetë vjet pas, kur EULEX-i prej kur ka filluar të operojë në Kosovë, vendi ynë gjendet para pengesave serioze në rrafshin e shtetit ligjor, si dhe me një korrupsion endemik, ashtu siç e quan Raporti i fundit i Progresit që Kosovën e rendit në të njëjtin brez të korrupsionit sikur që është, për shembull, Etiopia në Afrikë.

Në veprimin e përbashkët të Këshillit të Bashkimit Evropian, të 4 shkurtit të vitit 2008, përmes së cilit u themelua EULEX-i, në nenin 2, me titull “Misioni” thuhet që EULEX-i e ka për qëllim, pra në dokumentin me të cilin është themeluar EULEX-i shkruan që EULEX-i e ka për qëllim që në drejtësi, në polici dhe në dogana të krijojë institucione të pavarura prej ndikimit partiak. Ky ka qenë njëri prej qëllimeve bazike të misionit të EULEX-it.



Tetë vjet pas është më se e qartë që sidomos drejtësia e policia mbeten institucionet më të kontrolluara nga partitë e pushtetit. Ky është një dështim i EULEX-it që nuk do shumë diskutim. Dhe, së fundi, duke qenë të paprekshëm nga ligji vendor, duke gëzuar shumë imunitet dhe privilegje, ndonjë gjyqtari i EULEX-it e pa Kosovën e varfër edhe si parajsë të pasurimit të shpejtë përmes kompromiseve me krimin e organizuar. Rasti i prokurores së EULEX-it, Bamje, që dëshmoi për manipulimet e rasteve gjyqësore, e tregon anën e errët të këtij misioni.

Bilanci final për EULEX-in mund të jetë ky: Shumë para, pak rezultate kundër korrupsionit dhe tepër kompromise me krimin e organizuar dhe me strukturat e Serbisë. Nëse kjo është e vërteta, atëherë nuk kemi se si t'ia zgjasim jetën me votën tonë këtij misioni, të cilit i interesoi më shumë stabiliteti i skenës tonë politike, se sa drejtësia, zbatimi i ligjit dhe lufta e vërtetë kundër korrupsionit dhe keqpërdorimeve.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Slavko Simiq në emër të Listës serbe e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedniče!

Poštovani predsednici Vlade,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Uvaženi poštovani šefe kancelarije Evropski Unije na Kosovo, gospodin Samuel Žbogar,

Uvaženi poštovani ambasadori,

Uvaženi poštovani građani,

Kao parlamentarna grupa znamo da na Kosovo skoro osam godina od uspostavljanja misije EULEX postoji različita mišljenja u vezi rada i funkcionisanja ove misije. Međutim, moramo da budemo potpuno svesni činjenice da naše društvo još uvek nije spremno da samostalno implementira izvršene reforme pravosudnog sistema i daje našem društvu neophodno da i dalje prati dinamiku procesa evropskih integracija i reformskih procesa sektora za vladavinu prava, dakle i dalje nam je potrebna još uvek međunarodna podrška i dalje nam je još uvek potrebna međunarodna pomoć.

Pomoć nam je uglavnom potrebna kako bi se poboljšala uskladila i unapredila politika zakonodavstva i kako bi se ojačali institucionalni mehanizmi u skladu sa najboljim praksama Evropske Unije. Za to je novi mandat misije EULEX-a neophodan iz više razloga. Jedan od razloga je taj što Sudovi i tužilaštva još nisu saziali da rešavaju i gone kako pravne komplikovane predmete, tako ni politički osetljive predmete, predmete visokog profila. Dakle predmete u kojima postaje opasnost da se vrši pritisak na otvaranje ovakvih sudskih procesa i sličnih procesa ovime.

Bez misije EULEX-a pravosuđe bi funkcionisala, ali ne bi funkcionisala punim kapacitetom zbog strukturnih i kadrovskih nedostataka. Isto tako vladavina prava nije mogla da se na odgovarajući način proširi na severni deo Kosova, s toga zbog ovih izmena pomeranja odgovornosti izazova nije mogao da se postigne ženi nivo napretka u pogledu jačanja ovog sektora.

Takođe želim da napomenem prilikom deklarisanja ove tačke dnevnog reda da je savet Evropske Unije odobrio veoma solidan budžet misije EULEX-a u iznosu od 63,3 miliona €, i zbog toga

očekujem da misija EULEX kriz rad opravda očekivanje i poverenje koje će građani nadam se danas preko parlamenta dati nastavak mandata misije EULEX za naredne dve godine.

Uzimajući sve ove činjenice u obzir, parlamentarna grupa Srpske liste u načelu podržace nastavak mandata misije EULEX-a, i mi ćemo glasati pro Nacrtu zakona o sporazumu između Vlade Kosova i Evropske Unije, i pozivam sve poslanike da daju podršku. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani Grupi Parlamentar “6+” s’ka të lajmëruar, a dëshiron dikush fjalën? Nuk dëshiron! Vazhdojmë me deputetët, të cilët janë lajmëruar në mënyrë elektronike. Xhevahire Izmaaku e ka fjalën, në të njëjtën kohë bëhet gati Nuredin Ibishi.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!  
I nderuar kryeministër,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Të nderuar përfaqësues të Bashkimit Evropian dhe zyraive të tjera këtu që jeni sot në Kuvend.

*(Ndërprerje e incizimit)*

KRYETARI: Kërkojmë falje, e kemi bërë një sistem të ri dhe po shohim që po kemi probleme, regjia, po mirë është.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit! Referencat e mia te termi serb duhet të kuptohen gjithmonë për çështjen e policisë dhe kriminelëve serbë që vepruan gjatë kohës së luftës në Kosovë dhe assesi s’kam dëshirë që të preken kolegët e mi këtu. Pra, fjalimi im do të adresohet kryesisht prej të pabëmave të EULEX-it për dëshmitë, të cilat edhe vetë i kam dërguar bashkë me qindra banorë të komunës, prej të cilës unë vij si deputete në këtë Kuvend.

Nga viti ’99 e sot kaluan 17 vjet kur banorët e komunës së Vushtrrisë, me mijëra prej tyre, kanë pritur ditë e natë kur një ditë do të dalë lajmi në TV dhe gazeta se kriminelët e paramilitarët e ushtrisë e policisë serbe që ua shkatërruan jetët e tyre do t’i shohin të lidhur dhe të burgosur për të zezat që ua bënë atyre njerëzve të pafajshëm, që thjesht në momentet kur u vranë e u masakruan disa prej tyre ishin në gjumë, e disa duke lëvruar arat për të siguruar bukën e gojës për familjet e tyre.

Shpresat e tyre që UNMIK-u do ta bënte këtë si një mision me pritje u kthye në zhgënjim edhe për ne kosovarët, por edhe për ata që paguan taksat për ta bërë të mundur jetesën e këtij misioni pas luftës në Kosovë. Kur EULEX-i arriti si një mision i ri në Kosovë ishte një ringjallje shprese se fusha për të cilën më së shumti ky vend kishte nevojë për të bërë ndryshime do të vihej në themele të mbara. Fillimisht, kosovarët, popullata që ende po i vuan pasojat shpirtërore, morale e materiale, menduan që vërtet ky mision kriminelët do t’i burgoste, do t’i sillte para drejtësisë, duke qenë të gatshëm që me dëshmitë e tyre nga ata qindra veta që i mbijetuan vdekjes t’i sjellin EULEX-it dëshmitë për policët, ushtarakët, të cilët edhe sot janë gjallë e shëndosh e mirë e bëjnë sehir, kur ne sot po diskutojmë për të vazhduar mandatin e misionit të EULEX-it.

Çfarë bëri ky mision deri dje. Një dinamikë që e ndoqi dhe e praktikoi, e cila besoj që nuk do të vazhdojë me ritmin e njëjtë, përndryshe do t’i duhen edhe dhjetë vjet për të lëvizur diçka përpara

në këtë drejtim, pos që mbi bazat e thashethemeve burgosi disa nga luftëtarët e UÇK-së, unë e shoh si rationale ndihmën e krijimit të bazës së sistemit të sundimit të ligjit në vendin tim.

EULEX-i çfarë bëri me kriminelët serbë, thjesht, cilët i burgosi dhe sa BE-ja bëri presion që Serbia t'i dorëzojë ose t'i arrestojë ata. Përsëri po flas, pasi aty isha vetë një personazh në mbledhjen e të dhënave pas luftës me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar dhe komuna ime i dorëzoi si dosje me emër e mbiemër prej vitit 2008 vendin ku qëndrojnë këta kriminelë dhe krimet që i kanë bërë. Sot e lexova po ashtu një lajm që vjen nga Serbia, se ata vetë pranojnë që në mesin e tyre jetojnë 3 mijë kriminelë, të cilët vepruan gjatë luftës në vendet e rajonit, pra në Kroaci, Slloveni, Bosnjë, Kosovë.

Unë jam përfaqësuese e kësaj ane, jam deputete e Kuvendit të Kosovës, jam e vetëdijshme që puna nuk u krye mirë. Pagat e tyre dhe jeta që bëjnë në Kosovë këta pjesëtarë nuk e justifikon besimin tonë, por ne ende kemi nevojë për këtë partneritet dhe duhet t'u rijapim shans që pos dhimbjes dhe mllëfit që shkaktojnë burgosjet e luftëtarëve tanë, të bëni balancën edhe për ata që ua prenë jetën në gjysmë familjarëve tanë. Pra, merreni besimin tonë, por mos e nënçmoni këtë besim, sepse nuk është aspak humbja e besimit nga politika, sa keq është kur kosovarët, të cilët janë të dhënë me zemër në vlerat evropiane, perëndimore, do të zhgënjehen përsëri nga ju.

Ftoj edhe krerët e shteteve, të cilat dërgojnë përfaqësuesit e tyre në këtë mision, institucionet e BE-së që mbikëqyrin punën e tyre, të na dërgojnë njerëz, të cilët këtë punë nuk e bëjnë një për një pagë të mirë, sepse po ta bëjnë për këtë vend pune, ne kemi aq shumë nevojë për këto vende pune. Le të vijnë në vendin tim njerëz që vërtet do të ndihmojnë vendin tonë në integrimin e proceseve tona në rrugën e integriteteve evropiane dhe euro-atlantike.

I nderuar kryetar, unë kam edhe shumë e shumë fjalë të tjera, mirëpo këtu sot jam që të drejtoj besim tim si deputete edhe një herë, pra e mbështes vazhdimin e mandatit, me shpresën që ky vazhdim dhe ky mandat i ri do të sjellë një shpresë pozitive për vendin tonë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zoti Nuredin Ibishi e ka fjalën, në të njëjtën kohë bëhet gati Faton Topalli, mbas radhitjes lëvizja "Vetëvendosje".

**NUREDIN IBISHI:** I nderuar zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Shef i Zyrës së Bashkimit Evropian, zoti Zhbogar,

Do të thotë, ambasadorë dhe përfaqësues diplomatikë,

Të nderuar qytetarë,

Lidhur me këtë ligj që po ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare, domethënë shkëmbimin e instrumenteve në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, është një shqetësim imi lidhur me, kur ka të bëjë te qëllimi i ligjit dhe te paragrafi 2, te pika 2 dhe 2,3 lidhur me stafin e EULEX-it, e që ka të bëjë me delegimin e kompetencave në fushën e drejtësisë në përgjithësi, me prokurori dhe gjyqësi, por edhe me komponentën policore.

Mendoj se është dashur, përveç këtyre dy aspekteve të delegimit të kompetencave që ka të bëjë në aspektin edhe të kompetencave të presidentit, të Këshillit gjyqësor dhe prokurorial, të ceket

edhe stafi i policisë së EULEX-it, për arsye se edhe në qasje, edhe në zbatimet e tyre autorizimeve policore mund të prekë ndjeshëm në të drejtat e njeriut. Për atë arsye mendoj se ndër të tjerë, por këtu është cekur sidomos në paragrafin 2 pika 2.3, si në mënyrë të përgjithshme, domethënë te garantimi i imunitetit të stafit të zyrës së personelit, këtu përmenden edhe prokurorët edhe gjykatësit të dërgimi i kompetencave, por jo edhe domethënë policia e EULEX-it që, thashë edhe një herë mund të prekë ndjeshëm në të drejtat e njeriut, pra në përgjithësi unë e përkrah këtë ligj që ratifikon marrëveshjen.

Vetëm kisha thirrur në një bashkëpunim të ndërsjellë dhe ai mocioni që ka qenë më herët rreth monitorimit, mentorimit dhe zbatimit, të jetë një bashkëpunim më i mirëfilltë mes të gjithëve, edhe në aspektin e drejtësisë penale në përgjithësi, por edhe bashkëpunimit policor mes këtyre dy policive, policisë vendore të Kosovës dhe policisë së EULEX-it. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Faton Topalli e ka fjalën, në të njëjtën kohë bëhet gati Blerta Deliu-Kodra.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuara deputete,  
Sot po diskutojmë për vazhdimin e misionit për sundimin e ligjit të Bashkimit Evropian në Republikën e Kosovës.

Ky është vazhdimi i dytë dhe duke njohur logjikën e shumicës parlamentare jam plotësisht i vetëdijshëm që mandati i EULEX-it do të vazhdohet, me arsyetimin se në Kosovë ka shkelje të ligjit, korrupsion, lidhje të politikës me krimin e organizuar, shantazh të gjyqtarëve dhe prokurorëve të frikësuar dhe të korruptuar. Dhe, kjo është e vërtetë, në Kosovë kemi korrupsion, kemi krim të organizuar, kemi gjyqtarë dhe prokurorë të kërcënuar dhe të shantazhuar.

Ndoshta, kjo është e vetmja pikë në të cilën ne pajtohemi të gjithë, por kush e shkaktoi korrupsionin në Kosovë, kush e kapi shtetin, kush kërcënon gjyqtarë dhe prokurorë dhe kush i emëron ata. Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e njohur për të gjithë, si për qytetarët e Kosovës, ashtu edhe për Bashkimin Evropian, i cili në të gjitha raportet e progresit kritikon Qeverinë e Kosovës për moskryerje të detyrave dhe dështim në këtë fushë. Atëherë, si mund të presim që politikanët që janë shkaktarë kryesorë të kësaj situatë, të jenë ata, të cilët mund ta nxjerrin nga kjo krizë.

Fakti që misioni i EULEX-it për tetë vjet me radhë nuk e ndryshoi këtë gjendje është i mjaftueshëm për të kuptuar se ky mision nuk do të jetë i suksesshëm as gjatë viteve të ardhshme. Pra, një eksperiment që nuk funksionoi për tetë vjet me radhë, në kushte të njëjta, me aktorë të njëjtë, pse duhet të jetë i suksesshëm në dy vjetët e ardhshme kur deri tash nuk ka ndryshuar asgjë. Luftimin e krimit të organizuar, kontrabandës, korrupsionit të lartë dhe krimeve të luftës EULEX-i ia ka nënshtruar stabilitetit afatgjatë politik dhe jo të drejtave dhe drejtësisë, lirisë e demokracisë apo zhvillimit ekonomik.

Kjo është arsye pse sundimi i ligjit nga EULEX-i ushtrohet jo duke menduar se kush duhet të arrestohet, por kush nuk bën të arrestohet. Në çdo arrestim të kujtdo qoftë, thelbi është dikush që nuk duhet të arrestohet. Stabiliteti mirëmbahet kundrejt destabilizimit të mundshëm. Kjo është

arsyeja kryesore pse në Kosovë nuk mund të ketë sundim të ligjit, e në veçanti sundimi i ligjit nga EULEX-i. Por, EULEX-i çfarë bëri gjatë këtyre viteve të fundit? EULEX-i mbikëqyr natyrisht, mbikëqyrësi është ai i cili kujdeset që punët të shkojnë vaj edhe atëherë kur makinat pa targa qarkullojnë në veri, kurse kamionët që hynin nga Serbia nuk paguanin fare doganë, edhe atëherë kur u zhdukën 48 kg drogë nga dhoma më e sigurt e Policisë së Kosovës dhe askush as nuk ka dha dorëheqje, as nuk ndodhi asgjë.

Prandaj, deputetë të Kosovës, në Kosovë problem nuk është krimi i organizuar, por krimi i institucionalizuar. Organet e rendit dhe sigurisë, në krye me EULEX-in, e kërkojnë krimin jashtë sistemit. Jashtë sistemit ata kanë gjetur vetëm lëvizjen “Vetëvendosje”, të cilën e kanë persekutuar rregullisht, por korrupsioni, krimi i organizuar e ai i luftës dhe kontrabanda në Kosovë ndodhin e ndodhën brenda sistemit, e sidomos në majat e tij.

Arsyeja e dytë pse unë do të votoj kundër këtij misioni është fakti që këta politikanë të korruptuar, të përfshirë në krimet e ndryshme, shantazhohen shumë lehtë dhe janë të gatshëm për të pranuar çfarëdo vendimi në dëm të Kosovës vetëm për të shpëtuar lëkurën e tyre. Pra, kemi në situatë të tillë kur nga njëra anë shteti është kapur nga politikanët dhe politikanët janë kapur nga EULEX-i, por jo për t’i futur në burg, por për ta ruajtur stabilitetin.

Këtë e vërteton çështja e Zajednicës dhe e demarkacionit më së miri. Unë votoj edhe kundër kësaj kapje, sepse demokracia kërkon që në krye të vendit të jenë zyrtarë që mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës dhe nuk e kthejnë vendin në një monedhë këmbimi për të rregulluar interesat e të tjerëve. Sovraniteti i vendit është një vlerë evropiane dhe amerikane e dëshmuar në demokraci të këtyre vendeve, në të cilat unë besoj. Vënia e rregullit, luftimi i krimit të organizuar nuk mund të bëhen me politikanë të korruptuar në krye të vendit, nuk mund të bëhet pa hequr rrjetin e merimangës së krimit dhe nuk mund të bëhet me misione të huaja, sado që ato mund të kenë qëllime të mira.

E vetmja rrugë për të dalë nga kjo krizë është për të ndryshuar qeverisjen dhe mendësinë politike që sundon sot në Kosovë dhe kjo mund të bëhet me zgjedhje të lira dhe demokratike, atëherë kur qytetarët e Kosovës do t’u thonë “jo” politikanëve të korruptuar, jo krimit të organizuar, jo kapjes së gjykatave, jo kapjes së shtetit. Ne, si lëvizje “Vetëvendosje”, jemi shumë të interesuar që të kemi marrëdhënie të mira me Bashkimin Evropian dhe e konsiderojmë si partnerë. Një për shkak se duke qenë qytetarë të Evropës ndajmë shumë vlera të përbashkëta dhe e dyta për shkak që kemi nevojë të përfitojmë nga përvoja evropiane në zhvillimin e demokracisë dhe fuqizimin e shtetit si kornizë për një jetë më të mirë të qytetarëve.

Ne kemi nevojë për mbështetje të sistemit shëndetësor, ne kemi nevojë për kredi të lira që mundësojnë investime dhe krijojnë hapësirë për zhvillim ekonomik, ne kemi nevojë për mbështetje të sistemit arsimor, ne kemi nevojë për një zhvillim të infrastrukturës rrugore dhe të hekurudhave. Kemi nevojë për shqiptarë të mirë, kemi nevojë që të bëhemi pjesë e Bashkimit Evropian dhe strukturave atlantike, por nuk kemi nevojë për një mision, i cili të lë përshtypjen që lufton krimin, ndërsa në fakt vetëm stabilizon atë.

Ndihma më e madhe që Bashkimi Evropian dhe miqtë e Kosovës do të mund t’ua bënin qytetarëve të Kosovës është të mos e përkrahin këtë qeverisje të korruptuar, e cila është shkaktari

kryesor për gjendjen për të cilën ne po bisedojmë dhe për të cilën të gjithë po pajtohemi që është gjendje e vështirë.

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Blerta Deliu-Kodra dhe bëhet gati zonja Alma Lama.

BLERTA DELIU-KODRA: I nderuar kryetar i Kuvendit!  
I nderuar kryeministër,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar përfaqësues të Bashkimit Evropian në Kosovë,

Më lejoni që të them që në fillim dëshiroj të bëj të qartë se Kosova ka nevojë për misionin evropian për sundim të ligjit, EULEX-in. Ndaj, edhe unë sikurse kolegët e mi të grupit parlamentar e përkrah vazhdimin e mandatit të këtij misioni, sepse konsideroj se në këtë mënyrë i ndihmohet Kosovës në ecjen e saj drejt integriteteve më të mëdha evropiane në fushën e sundimit të ligjit.

EULEX-i është duke vazhduar përkushtimin e tij në luftën kundër korrupsionit dhe bashkëpunimin e ngushtë me palën vendore, për ta arritur qëndrueshmërinë dhe praktikën më të mira të Bashkimit Evropian në Kosovë. Mirëpo, të nderuar kolegë, ne duhet të konstatojmë se EULEX-i nuk i ka përmbushur prioritetet për vendosjen e sundimit të ligjit në Kosovë dhe në këtë kuadër as në veri të Kosovës, ku veprojnë akoma strukturat kriminale të trashëguara që nga periudha e sundimit të Milosheviqit.

Kjo është një mungesë e këmbënguljes për vendosjen e drejtësisë dhe të rendit të ligjit. Misioni i EULEX-it mendoj që, nëse shqiptarët janë hetuar qoftë edhe për një gërvishtje në kohën e luftës, pse atëherë EULEX-i nuk i ndriçoi asnjëherë rastet e masakrave më makabre, si ajo e Mehës, e Obrisë, e Vërbovcit, masakrën në Burgun e Dubravës, kur dihen qartë strukturat komanduese dhe protagonistët e këtyre strukturave ushtarake dhe policore.

Si është e mundur, për shembull, të mos dihet gjë për fatin e Ukshin Hotit dhe ekzekutimin e afro 200 të burgosurve shqiptarë kur dihet emri dhe mbiemri i drejtuesve serbë të Burgut të Dubravës. Pse EULEX-i nuk ndriçoi as edhe njëherë krimin dhe gjenocidin që kriminelët serbë e kryen në fshatin Rezallë, ku u vranë civilë të pafajshëm, u masakruan dhe fshehën trupat e tyre në varrezën masive në Rudnicë.

Si u bë që Lubisha Dikoviç, gjenerali i apostrofuar si përgjegjës kryesor për krimin në Rezallë dhe Çikatovë të Vjetër, nuk u dënua, madje u dekorua nga shteti serb dhe u lejua që të futej në vendin ku edhe ka kryer krimin e tij. Si mund të jenë pozita të rëndësishme shtetërore në Serbi ata që kryen krimet më makabre në Kosovë. Çfarë po ndodh me të pagjeturit, është çështja që ne sot duhet ta diskutojmë? Pse ende nuk ka një koordinim të aktiviteteve me Prishtinën lidhur me të pagjeturit, aktivitetet po koordinohen me palën serbe në Beograd, pa qenë fare e informuar pala kosovare.

Po ndalem tek rasti i varrezës potenciale masive në Kizhevak të Rashkës. Staf i profesional i EULEX-it në agjencinë e mjekësisë ligjore është i koncentruar në Rashkë, ku edhe ku po kryen

gërmimet në lokacionet potenciale të Kosovës, mirëpo për këtë shkak po rezulton që Kosova nuk po i kryen punët e saj dhe meritat po i shkojnë Beogradit. Misioni evropian për sundim të ligjit duhet të ofrojë të gjitha dokumentet që i posedon nga UNMIK-u, duhet t'i hapë arkivat.

Të nderuar deputetë, më lejoni të pyes pse nuk ka ende gërmime në veri, në varrezat e myslimanëve tek Xhamia e Ibrit, si dhe në Zubin Potok për çështjen e të pagjeturve. Vetëm në rast se ne ndalemi të shifra e atyre, të cilët janë të akuzuar për krime lufte nga të dyja anët, atëherë kjo rezulton që kemi një diskrepancë të madhe në mes të shqiptarëve dhe serbëve që akuzohen për krime të luftës. Janë 80 shqiptarë, të cilët po akuzohen për krime lufte dhe janë vetëm 20 serbë, të cilët janë të akuzuar për krime lufte.

E ajo që sot duhet të thuhet është që në mesin e të akuzuarve janë edhe ish-ushtarë të UÇK-së, të cilët akuzohen për vrasjen e personave të panjohur, të cilët nuk kanë as emër dhe as mbiemër dhe që nuk figurojnë në listat zyrtare të të zhdukurve, as në listën e viktimave.

Të nderuar kolegë deputetë,  
Nëse drejtësia është drejtësi, EULEX-i nuk duhet të vazhdojë këtë qasje selektive. Atëherë, kjo nuk është drejtësi me standarde evropiane, është përndjekje e porositur dhe mendoj që Kosova ka shumë nevojë për drejtësi të paanshme, sepse gjatë gjithë sundimit serb ka vuajtur nga padrejtësia.

Jemi në një situatë ku njerëzit arrestohen për 50 cm mur të ndërtuar në oborin e tyre, ndërkohë që janë kriminelët serbë ata që kanë shërbyer në strukturat represive të Milosheviqit, të cilët lëvizin lirshëm në pjesë të ndryshme të territorit të Kosovës dhe nuk arrestohen vetëm për të krijuar një lloj balance. Sado që një gjë e tillë mund të duket e mirë, sepse në fakt krijon njëfarë balance, kjo sjellje në rend të parë po e dëmton drejtësinë, po i rëndon viktimat dhe nuk po i kontribuon përbaljes me të vërtetën. Është rasti dhe koha që EULEX-i të bëjë transparente strukturën e tij, sepse ka informacione se një pjesë e hetuesve dhe gjyqtarëve janë të strukturave të dikurshme të UNMIK-ut.

Ne jemi dëshmitarë se disa hetues apo gjyqtarë pas mbarimit të mandatit kanë shpërfaqur publikisht lidhjet me strukturat shtetërore të Serbisë, shteti i cili mban qëndrimin më armiqësor ndaj Kosovës dhe shtetit që është bërë oazë e kriminit dhe e mosdënimit për krime lufte. Për më tepër, nëse EULEX-i mban raport me Serbinë, atëherë ky bashkëpunim duhet të jetë i dyanshëm, që Serbia të dorëzojë personat e dyshimtë për kryerjen e krimeve të rënda në Kosovë. Për më keq, Serbia jo vetëm që po vazhdon të ketë pretendime territoriale ndaj shtetit të Kosovës, por ndihma financiare të Bashkimit Evropian po i përdor për financimin e strukturave kriminale në veri të vendit, të cilat po sfidojnë rendin dhe ligjin në Kosovë, po sfidojnë edhe vetë misionin e Bashkimit Evropian, EULEX, në Kosovë.

Pra, Serbia në njërin anë po vazhdon negociatat me Bashkimin Evropian dhe po merr bonuse financiare dhe politike nga Brukseli dhe, në anën tjetër, në të njëjtën kohë po sfidon edhe vetë misionin e Bashkimit Evropian në Kosovë. Mendoj që kjo është një paradoks dhe është totalisht e palogjikshme. EULEX-i duhet të rishikojë bashkëpunimin me këtë vend fqinj që vazhdon ta sfidojë rendin dhe territorin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne mendojmë se këto sjellje do të korrigjohen nga EULEX-i dhe Brukseli, dhe nisur nga kjo, unë bashkë me kolegët e mi të Grupit Parlamentar të PDK-së jemi për vazhdimin e misionit të EULEX-it, duke qenë thellë të bindur se sundimi i ligjit ka vetëm një rrugë se si bëhet. E kjo bëhet vetëm përmes transparencës dhe pa paragjykime politike dhe etnike, bëhet me dëshmitarë realë dhe të vërtetë dhe jo me dëshmi të fabrikuara.

Vetëm një drejtësi e cila bëhet në këtë formë ka shans që ta përgatisë Kosovën në rrugën e integritit evropian dhe ta ndihmojë konsolidimin e shtetit të ri të Kosovës në planin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Një drejtësi selektive dhe për qëllime politike mendoj që nuk i duhet as Kosovës, e as Bashkimit Evropian. Mendoj se para se gjithash Kosova ka nevojë për drejtësi dhe për sundim të ligjit.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Alma Lama e ka fjalën, ndërkohë me një insistim Vjosa Osmani, Aida, në qoftë se ti lejon. Ka provim...

ALMA LAMA: Faleminderit! Për një çështje me kaq shumë rëndësi po flasim vetëm gratë, si duket burrat paskan frikë.

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, ministra dhe përfaqësues të ambasadave që jeni sot në Kuvend,

Kjo që thashë është e vërtetë, nuk është për të qeshur.

Tashmë u bënë rreth shtatë vjet që kur misioni i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX-i, është vendosur në Kosovë. Shtatë vjet janë një kohë më se e mjaftueshme për të bërë vlerësimin e punës, për të numëruar sukseset ose për të evidentuar dështimet. Kur jemi te dështimet, besoj se pajtohemi të gjithë me një fakt se pritshmëria e qytetarëve të Kosovës ndaj këtij misioni ka qenë shumë më e lartë, sepse EULEX-i ka mundur të punojë me më shumë seriozitet dhe përkushtim për ta përmbushur misionin e tij, se prania e tij do të kishte bërë që t'u dridheshin gjunjët edhe shkelësve më të mëdhenj të ligjit. Mirëpo, të gjithë në këtë sallë dhe jashtë saj duhet të pajtohemi se prania e misionit EULEX në Kosovë edhe për një periudhë jo të shkurtër është e domosdoshme.

Bindja ime e thellë është se EULEX-i i duhet Kosovës me këshillat dhe ekspertizën e tij, por i duhet, thënë në mënyrë simbolike, qoftë edhe si një shpatë e Demokleut mbi kokat e atyre që nuk kanë respekt për ligjin, që janë individë ose institucione. I them këto, sepse në vazhdimësi dëgjoj zëra se fakti që ia kemi bartur kompetencat një misioni të huaj, do të thotë që kemi rrjedhje të sovranitetit. Për sa i përket sovranitetit, Kosova, duhet të jemi realistë, nuk e ka marrë kurrë të plotë atë deri tani, por shikoni se çfarë po ndodh edhe me vendet e rajonit, që kanë dështuar në sistemin e drejtësisë. Shqipëria dhe Maqedonia, për shembull, "po e dorëzojnë sovranitetin" e tyre, edhe pse janë shtete të njohura ndërkombëtarisht shumë më shumë se Kosova. Në këto vende po krijohen prokurori e gjykata speciale me ndërkombëtarë, pas dështimit të atyre vendëse. Por, ka dhe zëra të tjerë, të cilët kur kundërshtojnë nën të njëjtat pretendime, pra të sovranitetit, në fakt, hallin e kanë diku tjetër - preokupohen për fatin e tyre personal.



Unë për vete preokupohe për funksionimin e këtij shteti, për funksionimin e demokracisë, e cila kurrsesi nuk mund të kuptohet pa sundimin e ligjit. Preokupohe për shkeljen e të drejtave të qytetarëve nga ato institucione, të cilat duhet të bëjnë drejtësi. Preokupohe për shtetin e të së drejtës, i cili, tani për tani, duket vetëm një ideal.

Unë besoj se prania e EULEX-it mund të ndihmojë që këtë ideal ta bëjmë realitet, ashtu sikur jam e bindur se ky mision i BE-së dhe asnjë mision tjetër në botë nuk mund ta ndihmojë Kosovën që ta fitojë betejën me krimin.

Këtë betejë mund dhe duhet ta fitojnë qytetarët e Kosovës dhe institucionet e Kosovës. Nuk mund të jetë i suksesshëm asnjë mision i huaj për sundim të ligjit, për sa kohë që qytetarët nuk bashkëpunojnë me të. E njëjta gjë vlen edhe për institucionet vendore të drejtësisë.

Mirëpo, duhet të jemi realistë. Institucionet tona të drejtësisë prej vitesh na dëshmojnë një anomali të madhe. Prokurorëve dhe gjyqtarëve tanë u pëlqen t'i marrin pagat e larta, të cilat vijnë nga taksapaguesit e Kosovës, i duan privilegjet, e duan mandatin e përjetshëm në profesionin që bëjnë, por nuk ua ka shumë qejfi të bëjnë punën. Nuk kanë dëshirë të marrin rrisqe, e mezi presin t'i heqin nga duart e tyre rastet e rënda. Sa e sa raste janë raportuar, kur prokurorët apo gjykatësit e Kosovës kanë hequr dorë me dëshirë, me arsyetime nga më të ndryshmet.

Pra, përditë na kanë dëshmuar se nuk kanë kapacitete dhe as guxim ta bëjnë punën, për të cilën paguhen. Dhe, këtu ne duhet të jemi jashtëzakonisht kritikë.

Sërish kërkoj që të jemi realistë. Kush do të guxonte t'i prekte ata që në emër të kredive të luftës abuzojnë me pushtetin, apo rastet e korrupsionit të lartë nga persona që konsiderohen të paprekshëm. Sa kohë që kemi persona, të cilët drejtësia vendore i konsideron të paprekshëm, i kemi punët shumë keq. E po të mos e kishim një situatë të tillë, sot nuk do ta kishim fare EULEX-in në Kosovë, sepse nuk do të kishim nevojë për të. Duhet ta dimë që EULEX-i është misioni më i madh nga 30 misione që Bashkimi Evropian i ka dërguar në vende të ndryshme të botës në tri kontinente dhe unë këtë e shoh si vlerësim që Bashkimi Evropian, ose preokupim më mirë, ka për sundimin e ligjit në Kosovë.

Tani dy fjalë për modifikimet e fundit që i janë bërë mandatit të EULEX-it në shkëmbimin e letrave të fundit dhe në ligjin, që sot do ta miratojmë, ndërmjet Presidentit të Kosovës dhe përfaqësueses së Politikës së Jashtme të BE-së. Pamundësimi i hapjes së rasteve të reja nga EULEX-i kam frikë se do ta shndërrojë drejtësinë në një derë të mbyllur për qytetarët e Kosovës, pikërisht sepse ne nuk i kemi të gatshme këto institucione të drejtësisë për t'u marrë me raste të ndjeshme.

Në anën tjetër, në këto letra do të duhej të ishte kërkuar nga EULEX-i që të luante rol vendimtar në pjesën veriore të Kosovës, ku është i vetmi institucion që përpiqet të funksionojë dhe të mos i shërbejë status quo-s shumëvjeçare në atë pjesë. Po kështu, EULEX-i duhet të heqë dorë nga llogaritë politike, sepse kjo logjikë e dëmton drejtësinë në Kosovë, jo vetëm në planin afatshkurtër, por edhe në atë afatgjatë.

Dua ta mbyll këtë fjalim duke i bërë thirrje EULEX-it që të merret seriozisht me krimet e luftës, të kryera ndaj shqiptarëve, nga forcat e Policisë dhe të Ushtrisë serbe, të cilat lanë dymbëdhjetëmijë të vrarë. E po kështu, dua t'i bëj thirrje që të fillojë hapjen e rasteve, ngritjen e padive për mijëra gra të dhunuara nga këto forca, dhembja e të cilave sot e kësaj dite nuk u shpagua me drejtësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Faleminderit edhe deputetes Aida Dërguti, që pranoi të flas para saj, me gjithë radhën e determinuar më herët nga Kryesia!

Të nderuar deputetë,

Dje, në Mbretërinë e Bashkuar, një deputete angleze, Joe Cox, u vra mizorisht për shkak të qëndrimeve të saj politike, qëndrime pro vlerave evropiane, qëndrime pro diversitetit në mendime, në etni, në ngjyrë, në racë apo në gjini, përderisa ka vlera shumë më të mëdha që na bëjnë unikë e na bashkojnë. Pikërisht për shkak të këtyre vlerave, vlerave evropiane pra, kur në vitin 2008 Bashkimi Evropian e vendosi në Kosovë misionin më të madh dhe më të shtrenjtë në historinë e vet, me qëllim të promovimit të vlerave evropiane në fushën e rendit të ligjit, shumë prej nesh, përfshirë edhe mua, thoshim se derisa ne të përgatitemi e të hyjmë në Evropë do ta kemi Evropën në Kosovë.

Pra, vazhdimisht me shpresën se prania e këtij misioni në Kosovë do ta ndihmonte rrugën tonë të integritit evropian dhe do ta përshpejtonte atë.

Sot, tetë vjet pas, përderisa vendosim nëse këtij misioni, pra EULEX-it, duhet t'i vazhdohet mandati, ne duhet të vlerësojmë jo vetëm statistika apo analiza numerike. Puna e një misioni të tillë të madh nuk mund dhe nuk do të duhej të reduktohej vetëm në statistika të hetimeve, të aktakuzave, gjykimeve apo dënimeve. Duhet po ashtu të reflektojmë sesa na ka ndihmuar ky mision me të gjithë pjesëtarët, që vijnë nga vende me demokraci të zhvilluar dhe kryesisht të demokracive perëndimore, pra që të zhvillojnë edhe në Kosovë bashkërisht me ne vlera të barazisë para ligjit, vlera të mosdiskriminimit, të trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve, pavarësisht etnisë apo dallimeve të tjera.

Sa na ka bërë të ndihemi të sigurt dhe sa na ka bërë të besojmë në sistemin tonë të drejtësisë? Ta pyesim veten sot, tetë vjet pas, dhe para se të mendojmë si deputetë e politikanë, por thjesht si qytetarë të barabartë të këtij shteti, të cilët mbrojtjen e vetme e kanë ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës, në qoftë sot na shkelen të drejtat tona themelore, në qoftë se më shumë besim kemi në një gjyqtar që vjen nga një shtet i tillë evropian apo në gjyqtarët tanë.

Për t'u përgjigjur sinqerisht në këtë pyetje ne duhet t'i shohim edhe deklaratat e gjyqtarëve tanë, madje edhe ata që bëjnë pjesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, të cilët vetë e thonë publikisht para qytetarëve të Kosovës se akoma nuk i kanë kapacitetet e ndërhuara për t'u marrë me hetime apo me raste të nivelit të lartë, siç janë korrupsioni, krimi i organizuar dhe raste të tjera sensitive.

Kur në vitin 2008 u vendos për mandatin e UNMIK-ut, u tha që mandati i tij do të jetë i bazuar në tri shtylla: monitorim, mentorim dhe këshillim. Pra, se të tri këto shtylla do të shërbenin për t'i ndërtuar kapacitetet në mesin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Kosovës, që ata pas disa vjetëve të mund të qëndronin në këmbët e tyre, thënë simbolikisht, dhe të mund të kenë integritetin, por edhe përgatitjen profesionale, që vetë të vendosin për raste të tilla të ndjeshme.

Çka ndodh pas shumë vjetësh? Ne i kemi akoma vërejtjet e ngjashme, siç i kishim edhe në vitin 2012, kur ne si Kuvend i Kosovës i dhamë fund procesit të pavarësisë së mbikëqyrur. Pra, janë këto tri shtylla, që ende mbeten të papërbushura dhe akoma edhe sot i kemi gjyqtarët tanë që hezitojnë të thonë se janë të përgatitur sa duhet për këto raste të ndjeshme.

Ne si Kuvend i Kosovës duhet të insistojmë jo vetëm në këto ligje që sot po i miratojmë, por edhe në çdo takim që kemi me zyrtarë të BE-së, që në qoftë se Raporti i Progresit, i cili miratohet çdo tetor, flet për sundimin e ligjit, aty nuk mund të flitet vetëm për gjyqtarë e prokurorë kosovarë. Aty duhet patjetër të flitet edhe për punën e EULEX-it. Në qoftë se Komisioni për Legjislacion apo ai për Integrim Evropian i Kuvendit të Kosovës mblidhet për ta analizuar fushën e sundimit të ligjit, aty duhet të jetë EULEX-i.

Pra, në qoftë se ne si Kuvend i Kosovës vendosim të delegojmë kompetenca në një mision të tillë, duke i shfrytëzuar kompetencat tona kushtetuese, është po ashtu kompetencë jona kushtetuese që ta ftojme këtë mision të raportojë edhe para nesh për sukseset, sfidat dhe dështimet. Kjo nuk ka ndodhur deri tash, por ne duhet të jemi më të zëshëm, që një gjë të tillë ta bëjmë të mundur.

Çka duhet të bëhet tash e tutje? Kur kam folur në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së para disa vjetësh, kur vendosej për vazhdimin e mandatit të EULEX-it, e kam thënë këtë: “Më pak shou televiziv e më shumë punë, më pak deklarime politike e më shumë sundim të ligjit”. Fatkeqësisht, e njëjta vlen edhe sot, pra disa vjet më pas.

Ky mision dhe në përgjithësi prania ndërkombëtare në Kosovë për vite të tëra na ka mësuar logjikën e kompromisit, logjikën e tolerancës me fqinjët tanë, përfshirë edhe ata që tentuan të na shfarosin. Mirëpo, fatkeqësisht, akoma nuk na e kanë mësuar logjikën e kompromisit e të tolerancës me njëri-tjetrin. Dhe, besoj se kriza politike, nëpër të cilën kaluam para disa muajsh, e ka dëshmuar këtë. Na inkurajuan për logjikën e uljes në tavolinë, të shtrëngimit të duarve dhe logjikën e dialogut me fqinjët tanë, por akoma nuk patën sukses që të njëjtën logjikë të dialogut ta instalojnë ndërmjet njëri-tjetrit.

Janë këto vlera, të cilat EULEX-i në dy vjetët e ardhshme duhet t'i instalojë, duhet t'i inkurajojë dhe duhet t'i zhvillojë në shoqërinë kosovare, së bashku me misionin e vet të shenjtë për sundimin e ligjit. Pra, të punohet, jo vetëm për sundim të ligjit, por edhe për sjellje para drejtësisë të të gjithë atyre që bien ndesh me ligjin, për rikthim të besimit të qytetarëve të Kosovës në drejtësi, por edhe për vlera të tjera evropiane, të cilat ne shpresuam se do t'i shohim në ju e ndër të cilat hyjnë edhe mostoleranca ndaj korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Presidenti Rugova në fillim të viteve të '90-ta dhe deputetja e ndjerë britanike Cox, në vitin 2016, pra dy dekada më vonë, u thirrën në të njëjtën thënie nga autori britaniko-irlandez Edmond Burgh, ku thuhet krejt çfarë duhet që e keqja të triumfojë, është që njerëzit e mirë të mos bëjnë asgjë, pra të rrinë duarkryq. Edhe ne sot mund të bëjmë asgjë, mund të rrimë duarkryq, por çfarë mund të ndodhë? Janë dy gjëra, e para është mungesa e ushtrimit të sovranitetit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që e kemi kompetencë kushtetuese, pra të delegojmë kompetenca në një mision të huaj. Ne sot, duke i vazhduar mandatin EULEX-it, nuk demonstrojmë mungesë sovraniteti, por demonstrojmë ushtrim sovraniteti të Republikës së Kosovës. Dhe, e dyta çfarë mund të ndodhë, në qoftë se nuk veprojmë dhe rrimë duarkryq, është në mungesë, pra të vazhdim të mandatit, triumfi i planit të riaktivizimit të gjyqtarëve të UNMIK-ut dhe rikthimit të kompetencave në UNMIK-un, pra rikthim në një kohë të para pavarësisë, të para vitit 2008.

Ne nuk duhet të lejojmë që të triumfojnë këta skenarë, por duhet ta përkrahim mundësinë që vlerat më të avancuara evropiane të sundimit të ligjit, pavarësisht se në temp shumë më të ulët se sa që kemi menduar, të na mësohen të gjithëve, duke filluar nga ndërtimi i kapacitetit të gjyqtarët dhe prokurorët vendorë e deri te studentët më të rinj të drejtësisë. Janë pikërisht këto vlera evropiane, për të cilat u përcaktua ky popull pro-evropian para më shumë se tri dekadash, janë pikërisht këto vlera evropiane, për të cilat u sakrifikuara shumë dhe pësuan mijëra e mijëra viktima në Kosovë, që një ditë të jenë të lirë dhe të kenë besim në një sistem të drejtësisë jo diskriminues, janë këto vlera për të cilat vdiq edhe deputetja britanike Joe Cox, janë pikërisht mungesa e këtyre vlerave pse e humbi jetën Xheneta trevjeçare para një kohe, pra mungesa e përgjegjësisë dhe mungesa e përgjegjshmërisë së zyrtarëve publikë.

Prandaj, pikërisht për shkak të këtyre vlerave unë do të votoj për, që Misioni i BE-së ta ketë edhe një shans, pra edhe dy vjet, që ato t'i ndërtojë në Republikën e Kosovës, duke shpresuar se do ta kuptojnë, se orientimi pro-evropian i qytetarëve të Republikës së Kosovës do të mund të zhvillohet, në qoftë se ata na japin shembuj të mirë, në qoftë se ata na japin shembuj të barazisë para ligjit, në qoftë se ata na japin shembuj të mostolerancës ndaj korrupsionit, e jo shembuj të kundërt. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën do ta ketë deputetja Aida Dërguti.

**AIDA DËRGUTI:** Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Nuk duhet harruar se misioni i EULEX-it erdhi me ftesën e Qeverisë së Kosovës. Edhe pse trumbetonin luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke thënë se do t'i zëmë peshqit e mëdhenj, për tetë vjet pune përfunduan duke zënë sardina.

Si rëndom, pak para skadimit të mandatit, EULEX-i na shfaqet me disa arrestime spektakulare, me të cilat synon të ngjallë shpresë të rrejshme dhe të sigurojë përkrahje për vazhdim të mandatit. Qysh para vazhdimin të misionit të EULEX-it ishte Lëvizja "Vetëvendosje", e cila e kundërshtoi ardhjen e tij. Arsyet e kundërshtimit ishin konceptuale e parimore. Koha e dëshmoi se ky mision as nuk e ndihmoi, e as nuk e avancoi procesin e shtetndërtimit në fushat më të ndjeshme, që i mori përsipër ky mision, e që ndërlidhen me sundimin e ligjit.

Për shkak të këtij kundërshtimi, aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” iu nënshtruan shumë proceseve gjyqësore, të cilët edhe sot e kësaj dite janë subjekt i përndjekjes, e që këto lëndë aktivizohen nga pushteti në momente të përshtatshme për ta, me qëllim të pengimit e dobësimit të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Në këtë kundërshtim përgjatë viteve Lëvizja “Vetëvendosje” ishte zë i vetmuar. Kësaj radhe, në prag të vazhdimit të mandatit të EULEX-it, u befasuam nga letra e njëanshme e presidentit të “gazit”, Thaçit, dhe projektligjet në përputhje me këtë letër, që i zvogëlonin kompetencat e këtij misioni.

Ky do të ishte lajm i mirë, po që se me të vërtetë kjo bartje e kompetencave do të nënkuptonte seriozitet të institucioneve tona në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Mirëpo, duke pasur parasysh se këta njerëz e votuan gjykatën speciale, duke sakrifikuar dhe njollosur kështu luftën e drejtë të UÇK-së dhe njëkohësisht duke hequr dorë nga një pjesë e sovranitetit, shtatë vjet pas shpalljes së pavarësisë, vështirë se mund të bindet dikush se qëllimi i kësaj përpjekjeje për të zvogëluar kompetencat e misionit të EULEX-it kishte për qëllim forcimin e institucioneve vendore për sundim të ligjit. Këta njerëz, që kaheerë na e kanë dëshmuar se qëndrojnë mbi ligjin, tanimë na bindën se po të njëjtit qëndrojnë edhe mbi Republikën. Pra, Republika është në funksion të tyre dhe trajtimi i saj si plaçkë e luftës, të cilën e nxjerrin në pazar me fqinjë, sa herë të kenë nevojë, po e zhbën atë nga dita në ditë.

Mjerisht, motivet e vërteta për këtë kundërshtim nga ana e pushtetit janë krejtësisht të ndryshme nga kundërshtimi ynë konceptual e parimor. Në fakt, qëllimi i këtij kundërshtimi ishte pengimi i hapjes së hetimeve të reja për rate të caktuara, që ndërliken me interesa personale e grupe.

Ne si Lëvizje “Vetëvendosje” do të vazhdojmë ta kundërshtojmë këtë mision të dështuar, për hir të interesave të përgjithshme shtetërore, në ndërkohë që çfarëdo kundërshtimi tjetër që vjen nga ana e atyre që e ftuan këtë mision, është kryekëput për interesa personale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Mexhide Mjaku-Topalli, nga PDK-ja.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryesues,  
Kabinet qeveritar,  
Kolegë deputetë,  
Përfaqësues të Bashkimit Evropian në Kosovë,  
Nëse nisemi nga ajo se çfarë mekanizmi është EULEX, ne e dimë se është një mekanizëm për promovimin e sundimit të ligjit dhe si i tillë në këtë fushë duhet të reflektojë barazi për të gjithë. Sot, në ndërdijen e qytetarëve të Kosovës EULEX konsiderohet si një mision, që nuk e ka arritur pritshmërinë e duhur.

Anembanë vendit tonë kemi gjurmë dhe plagë që s’shërohen dot. EULEX-i e ka mandatin edhe për t’i shëruar plagët e këtij populli, e këtë duhet ta bëjë duke u marrë me rastet konkrete dhe duke i gjykuar kriminelët dhe kryesit e masakrave, vrasjeve, dhunimeve dhe krimeve tjera, të kryera në vendin tonë.

Barazia në trajtimin dhe gjykimin e krimeve të luftës është shumë e tejdukshme. EULEX-i ka përballë një bjeshkë me argumente, të cilat i kemi diskutuar shumë herë edhe në këtë Kuvend. Po ashtu, ka emra konkretë të atyre që duhet të jenë prapa grilave si kryes të krimeve, por ja që

akoma nuk kemi asnjë veprim konkret në këtë drejtim. Sot, kur po shënojmë ditëlindjen e ideologut dhe veprimtarit Ukshin Hoti, ne akoma vazhdojmë të kërkojmë zbardhjen e fatit të tij, si dhe shumë të të zhdukurve të tjerë, ku në mesin e tyre ka edhe fëmijë, pleq dhe gra.

Ne të gjithë jemi në njohuri se kush e mori Ukshin Hotin. Po ashtu, dihet se kush e mori avokatin e mirënjohur Alishefik Spahiun dhe akoma asnjë veprim nuk është marrë në këtë drejtim. Në Ferizaj, në muajin qershor të vitit 1998 u burgosën shumë të rinj ferizajas. Nga ky grup i të burgosurve ferizajas në hetuesi mizorisht u vranë Rexhep Bislimi, Cenë Dugolli dhe Bilall Shala, ndërsa dhjetëra të tjerë u maltretuan mizorisht deri në gjymtim të disa prej tyre.

Ata i torturuan Rajko Doder, Radovan Klariq, Nebojsa Gjorgjeviq e shumë të tjerë. Ata ua kthyen nënave të tyre të bërë copë e grimë, të shpuar e të djegur me hekur elektrik. Vitin e kaluar nëna e dëshmorit Cenë Dugolli vdiq me plagë të pashëruara, asaj ia vranë në torturë djalin e vetëm, ndërsa nëna e dëshmorit Rexhep Bislimi, në moshë të shtyrë akoma e pret drejtësinë e EULEX-it dhe, ata që ia masakruan djalin ajo do që t'i shohë para drejtësisë. EULEX-i akoma nuk reflekton për këto raste, që ka prova të mjaftueshme dhe ato janë publike, por merren me raste ku edhe mungojnë dëshmi të bazuara, sikurse është rasti i "Grupit të Drenicës".

Ne jemi për t'i trajtuar drejtësia të gjithë ata për të cilët ka argumente. Kërkoj nga komuniteti i drejtësisë, gjyqtarët, prokurorët, avokatët dhe juristët, që janë pjesë e misionit të EULEX-it, që ta çojnë drejtësinë në vend edhe për kolegët tuaj të profesionit, avokatët, siç ishin Bajram Kelmendi, Alishefik Spahiu, e të tjerë. Së paku, bëjeni për njerëzit me të cilët do të kishit misionin e përbashkët, po qe se ata do ta gëzonin jetën sikurse ne të tjerët. Ne jemi të bindur në rrugën që kemi zgjedhur. E duam Kosovën me rend dhe ligj, të orientuar drejt vlerave euroatlantike.

Ne kërkojmë që duke respektuar barazinë para ligjit t'i mbyllim plagët e hapura të popullit tim të shumëvujtur. Unë, duke e parë interesin afatgjatë të vendit tim, duke qenë e bindur në rrugën e drejtë europerëndimore, e që e kemi zgjedhur si shtet, duke mbështetur edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe të kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës, e duke besuar se misioni i EULEX-it në vazhdim do të punojë duke i evituar këto mangësi, do ta votoj vazhdimin e mandatit të këtij misioni në Kosovë.

Besoj se ky është vendim në interes të Kosovës dhe të së ardhmes së saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Arben Gashi, nga LDK-ja.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë pata dëshirë që të jetë ministri i Drejtësisë këtu, në mënyrë që t'ia bëj disa pyetje për çështje që unë mendoj se duhet të marrim pak sqarim. Gjithsesi, unë pyetjet e mia po i bëj. Ndoshta, në ndërkohë vjen ministri dhe i thotë.

Në dokumentet që Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë i kanë dërguar, thuhet se nuk do të ketë raste të reja, si parim, që merr EULEX-i në shqyrtim, por unë kam pyetje për ministrin. A ka ministri apo Ministria një regjistër të të gjitha rasteve, të cilat i ka hapur EULEX-i? A e

posedon Ministria një regjistër të këtyre rasteve dhe çka konsiderohet rast i jashtëzakonshëm, kur EULEX-i mund të marrë raste të reja.

Çështja tjetër, që unë e kam, po ashtu pyetje për ministrin e Drejtësisë, pse e kanë lënë kaq vonë këtë çështje dhe pse me kaq urgjencë duhet të trajtohet në Kuvend? Mendoj se trajtimi i tillë po e bën joserioz Kuvendin dhe mënyrën se si po trajtohen gjërat.

Po ashtu, pyetje shtesë për ministrin e Drejtësisë do të jetë: A mbyllet tranzicioni me përfundimin pas dy vjetësh, apo do të ketë hapësira sërish, që periudha e tranzicionit në sistemin e drejtësisë së Kosovës të vazhdojë?

Unë, po ashtu kam vërejtjet dhe dyshimet e mia lidhur me situatën e brendshme, klimën e brendshme politike, e cila është zhvilluar dhe sa ka ndikuar kjo klimë e brendshme politike në vazhdimin e mandatit të EULEX-it. A ka pasur raste kur edhe zyrtarët e lartë politikë të Kosovës kanë kërkuar edhe ata vetë, që rastet e tyre të merren nga EULEX-i, për shkak të mungesës së besueshmërisë së institucioneve të Kosovës?

Po ashtu, cilat janë problemet që ne sot po i hasim në sistemin e drejtësisë? Kosova, sot duket se ka një sistem të trefishtë të drejtësisë, një sistem hibrid të drejtësisë me tri burime kryesore, të cilat japin drejtësi.

Sistemi i parë është sistemi i ndërtuar në Kosovë, domethënë institucionet e Kosovës, duke përfshirë Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, gjykatat, prokuroritë, Policinë, e tjerë... Sistemi i EULEX-it i ndërtuar në Kosovë, që ka po ashtu prokurorinë e vetë, policinë e vetë dhe gjykatat e veta dhe tendenca apo vendimi i organeve të Kosovës për të ndërtuar edhe Gjykatën Speciale, e cila do të jetë një sistem i veçantë i drejtësisë. Domethënë, ky sistem hibrid i drejtësisë a po e lufton vetveten apo po e ndërton një sistem të vërtetë të drejtësisë, i cili do të garantojë vënien e drejtësisë në këtë vend. Ka dyshime shumë të thella se ky sistem i shumëllojshëm i drejtësisë dhe këto burime të shumëllojshme të vënies së drejtësisë në vend po e luftojnë njëra tjetrën dhe mund ta krijojnë një situatë, ku vërtet nuk ka një burim të vërtetë, i cili ka për t'i trajtuar rastet e drejtësisë.

Po t'ia shtojmë kësaj edhe problemin tjetër, që e kemi me pjesën e veriut, ku kemi sistemin paralel, i cili tashmë është në shpërbërje e sipër, por prapëseprapë ka mbeturina të këtij sistemi, e që hyn si sistem i katërt dhe kjo tendencë, kjo laramani e sistemeve është një laramani, e cila realisht nuk po garanton vënien e drejtësisë në këtë vend.

Këto janë problemet me të cilat ne po përballemi sot dhe, nëse sot ne po e vazhdojmë misionin e EULEX-it, në ditët e ardhshme do të kemi raste kur do të merremi me Gjykatën Speciale dhe formimin e saj, që është një sistem komplet hibrid, sepse do të kemi ndërtimin e kësaj gjykate bazuar në ligjet e Kosovës, por që do të funksionojë jashtë Kosovës dhe do të marrë praktikën më të mira ndërkombëtare, kështu thuhet. E kemi EULEX-in, që funksionon me ligjet e Kosovës dhe ligje të tjera dhe me Polici, gjyqtarë, prokurorë ndërkombëtarë dhe sistemin e drejtësisë së Kosovës, i cili ka trashëguar edhe ato problemet nga sistemi i UNMIK-ut. Prandaj, kjo laramani e sistemit nuk po garanton drejtësi në Kosovë. Kur ta marrim parasysh faktin bazik, se krejt ky

sistem po ndërtohet, ose krejt këto sisteme po ndërtohen për rreth një milion e shtatëqind mijë banorë, atëherë nuk ka logjikë, sepse nuk po jepet “output”-i, i cili synohet të merret.

Andaj, me këto pyetje ndoshta ministri vjen më vonë e na jep përgjigje, por besoj se ngritën dilemat me të cilat sot po përballet Kosova, sistemi i drejtësisë në Kosovë dhe e ardhmja e sigurisë në vendimmarrjen juridike në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shqipe Pantina, nga “Vetëvendosje”.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Dua t’ua përkujtoj të gjithë kolegëve të mi, të cilët debatin kryesisht e orientuan për punën e EULEX-it, se ne më datë 23 korrik 2015, e kemi pas miratuar një rezolutë për punën e Kuvendit, ku debatet dhe diskutimet kanë qenë të ngjashme dhe ku në mes tjerash ne i patëm kërkuar edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial, që të bëjë një raportim, i cili asnjëherë nuk ka ndodhur deri më tash.

Po ashtu, i gjithë debati u orientua drejt punës së deritashme të EULEX-it, por nuk dëgjova ende ndonjë diskutim lidhur me marrëveshjen dhe ligjin, për të cilin ne na kërkohet që ta provojmë. Ministri nuk është këtu për të dhënë sqarime, por unë dua të vë theksin te neni 1, pika 2.2 e Rezolutës për marrëveshjen me Bashkimin Evropian.

Në këtë pikë thuhet: “Delegimi i autoritetit për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të EULEX-it në përputhje me Kushtetutën neni 20, duke iu nënshtuar procesit të konfirmimit të emërimeve nga presidenti. Pas aprovimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, respektivisht Këshilli Prokurorial i Kosovës, vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve të tanishëm ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese”.

Deri tash thamë se misioni i EULEX-it ka pasur për qëllim luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. A do të thotë këtu se krimi i organizuar dhe korrupsioni paska arritur në Gjykatën Kushtetuese dhe, nëse ne po miratojmë një marrëveshje, e cila është në përputhje me Kushtetutën? Kushtetuta thotë, në nenin 114 të saj, se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese i emëron Kuvendi. Përderisa, në pikën 2.2 të nenit të parë, asnjëherë nuk përmendet fjala “Kuvend”. Herën e fundit, kur unë e kam lexuar Kushtetutën, e që është sot në Kuvend, Kushtetuta thotë se ne jemi shtet parlamentar dhe jo presidencial dhe është Kuvendi ai që emëron edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe jo presidenti i Kosovës. Nëse në ndonjërin nga ato takimet në tavan ju e keni ndërruar edhe Kushtetutën dhe një të drejtë të tillë ia keni kaluar presidentit, unë ende s’e di, se nuk është askund e përcaktuar.

Përderisa, me nenin 152 përcaktohej se tre nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese emëroheshin nga përfaqësuesi civil ndërkombëtar, ky nen tashmë është amendamentuar, gjegjësisht është fshirë nga Kushtetuta me amendamentin e 13 të saj. Pra, ajo çfarë po ndodh me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, Qeveria po kërkon që të hyjë në fuqi, të ratifikohet edhe një marrëveshje tjetër jokushtetuese. Tash nuk është hera e parë që Qeveria ka nënshkruar marrëveshje jokushtetuese, por a do të jetë Kuvendi, do ta vërtetojë atë që është shndërruar thjesht në një mekanizëm votimi, duke miratuar edhe një herë, një ligj, një marrëveshje, e cila është antikushtetuese, mbetet të shihet, edhe pse, dorën në zemër, nuk pres ndonjë befasi. Faleminderit!



KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa, nga PDK-ja.

HAJDAR BEQA: Faleminderit!

I nderuar kryetar Veseli,

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të ambasadave, që jeni sot këtu,

Për të diskutuar lidhur me zgjatjen e mandatit të EULEX-it në vendin tonë konsideroj se duhet ta kthejmë pak kujtesën në retrospektivë, duke kujtuar vitin 2008, kur ne vetë jemi dakorduar që BE-ja ta dërgojë një mision, i cili do ta ndihmojë Kosovën në forcimin e institucioneve demokratike, si në drejtësi, dogana, polici, por mbi të gjitha ta ndihmojë Kosovën që ta shtrijë autoritetin e institucioneve të saj në tërë territorin e vendit.

Sot, të gjithë ne duhet ta pranojmë se situata në institucionet e zbatimit të ligjit, pavarësisht se ka një ngritje të kapaciteteve, ka një avancim, ka përmirësime, nuk është ajo që ne si përfaqësues të popullit dhe as qytetarët e vendit, e kemi pritur. Po ashtu, sot jemi dëshmitarë se sovraniteti i vendit po sfidohet në një pjesë të konsiderueshme të vendit edhe pas arritjeve të disa marrëveshjeve në Bruksel ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë. Jemi të vetëdijshëm se sot do të donim që të ishte momenti, kur BE-ja do të kërkonte vetë tërheqjen e misionit të EULEX-it, duke vlerësuar se institucionet tona dhe përgjithësisht sistemi ynë i drejtësisë ka arritur në stadin, ku performanca e atyre ka arritur që, në mos në nivel të njëjtë, të jetë përafërsisht në harmonizim me nivelin e Bashkimit Evropian, me sistemin e drejtësisë së shteteve të BE-së.

Ne duhet ta pranojmë se akoma nuk është arritur niveli i dëshirueshëm në zbatimin e ligjit. Fatkeqësisht, duhet të them se as misioni i EULEX-it edhe pas tetë vjetëve të pranisë së tij nuk ka treguar ndonjë rezultat, i cili do të mund të merrej si model nga institucionet tona. Për më tepër jemi dëshmitarë të kohës se edhe ky mision ka pasur problemet e tij në funksionimin, respektivisht funksionimin jo të mirë në zbatimin e ligjit. Por, si përfaqësues i popullit më duhet që këtu kur flas, të shpreh edhe opinionin e atyre që përfaqësojmë - popullit të Kosovës.

Me sa unë kam kuptuar gjatë takimeve që i kemi pasur në vazhdimësi me qytetarët e Republikës së Kosovës, opinionin e tyre rezulton të jetë në favor të vazhdimin të këtij misioni edhe për dy vjet.

Andaj, të nderuar deputetë, unë sot e mbështes konsensusin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe do ta jap mbështetjen time që ky mision të vazhdojë. Por, njëkohësisht, kërkoj që vazhdimi i këtij misioni të mos jetë një mundësi sikur veprimi deri tani, por vazhdimi i tij të jetë, në përgjithësi, që ky mision të merret edhe me rastet e masakrave të kryera gjatë luftës, të merret edhe me ato të cilat i bëri, në këtë rast, okupatori serbosllav, si me masakrat, që po i përmendim me këtë rast, Mejë, Krushë, Burgun e Dubravës, Obri, Poklek, Izbicë, Rezallë, Reçak e shumë masakra të tjera, sepse drejtësia selektive nuk është parim i funksionimit të drejtësisë në vendet e zhvilluara demokratike.

Kosova si vend i ri i Evropës nuk duhet të ishte poligon i promovimit të drejtësisë selektive, por duhet të shihet si mundësi e promovimit të vlerave të mirëfillta evropiane.

Krejt në fund, të nderuar deputetë, unë i kam disa pyetje: Me këtë rast, kërkoj disa përgjigje për qytetarët e Republikës së Kosovës, që i kemi hasur gjatë takimeve që i kemi pasur anekënd Kosovës, që janë edhe shqetësime të qytetarëve që i drejtohen si pyetje Misionit të EULEX-it:

- Cilat janë rezultatet e hetimeve të skandaleve të EULEX-it që kanë ndodhur gjatë mandatit të tyre në vetë EULEX-in?
- A kanë marrë ndonjë masë?
- Deri ku kanë shkuar fazat e hetimeve?
- Çka po ndodh me dëshmitarët e rrejshëm, që po deklarohen se u janë ofruar shuma të majme parash për të deklaruar rrejshëm?
- Ku është drejtësia këtu, kur dimë se dëshmia e rrejshme është vepër penale?
- Cili mund të jetë imazhi dhe besimi i EULEX-it, i cili duhet të jetë kur prokurorët e tij ndjekës të ish-Ushtrisë Çlirimtare apo ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që kemi raste pas mbarimit të mandatit punësohen si këshilltarë në Prokurorinë e Serbisë?

Do të thotë, edhe këtu në njëfarë forme humb besimi dhe imazhi ndaj EULEX-it, i cili nuk është në interes të vendit, e as të Bashkimit Evropian.

- Cili është besimi i misionit të EULEX-it pas daljes në publik të transkripteve të dëshmitarit Bllaca dhe prokurorisë së Serbisë?

Do të thotë, kanë qenë të njohura për gjithë opinionin.

- A janë hetuar mjetet financiare, të cilat janë derdhur në konton e dëshmitarëve të rrejshëm?

Rreth kësaj çështjeje kemi pasur raste që ka pasur derdhje të mjeteve financiare nga prokuroria e Serbisë te dëshmitari Bllaca.

- A është marrë ndonjë masë apo cila ka qenë procedura e EULEX-it e udhëhequr në këtë drejtim.

Unë si deputet i këtij vendi, si përfaqësues i qytetarëve, konsideroj se duhet t'i vazhdohet mandati edhe për dy vjet, por në të njëjtën kohë duhet t'i forcojmë institucionet tona, që me të vërtetë prokuroritë dhe gjykatat tona të jenë edhe më efikase. Mendoj se kanë avancuar, por duhet të jenë edhe më efikase dhe misioni i EULEX-it duhet të jetë më efikas dhe më i besueshëm edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, në këtë rast edhe për komunitetin shqiptar, të mos jetë i njëanshëm dhe selektiv. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

KRYETARI: Faleminderit! Profesori Muhamet Mustafa dhe të bëhet gati zonja Besa Baftiu.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar përfaqësues të Komisionit Evropian,

Po shihet edhe nga debati këtu, por në përgjithësi edhe nga ajo që shohim në opinion, në medie dhe në diskutime gjatë kësaj kohe, kur është trajtuar çështja e vazhdimit të mandatit, shihet se ekziston një pajtueshmëri që ky mandat të vazhdohet dhe kjo pajtueshmëri rrjedh nga fakti se po shihet qartë se ka nevojë për një veprim komplementar përplotësues të këtij misioni me sistemin e Gjyqësorit në Republikën e Kosovës.

Këtu u fol edhe për pritjet. Natyrisht, pritjet tona kanë qenë më të larta edhe për EULEX-in, edhe për një produktivitet dhe efektivitet më të madh të sistemit gjyqësor të Kosovës, mirëpo ajo që sot ne duhet të diskutojmë, ma merr mendja se sot ne duhet të shohim se cilat janë ato çështjet kyçe që duhet t'i ndërmarim, e të cilat do të na mundësojnë që në vitin 2018 ky Kuvend, Komisioni Evropian dhe të gjithë të tjerët do të konstatojnë se vazhdimi i EULEX-it në Kosovë më nuk do të jetë i nevojshëm.

Mendoj se lidhur me këtë janë dy çështje shumë të rëndësishme që duhet të trajtohen më tutje. E para ka të bëjë me atë sa kemi arritur të sigurojmë pavarësinë dhe llogaridhënien në tërë vijën dhe në të gjitha strukturat e sistemit gjyqësor të Kosovës lidhur me performansën ose mosperformansën e tyre.

Dhe, e dyta, çka kemi bërë dhe në çfarë stadi është zhvillimi i kapaciteteve të Gjyqësorit në Kosovë, duke përfshirë edhe numrin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Sa i përket çështjes së parë, te pavarësia dhe llogaridhënia lidhur me performansën, apo mosperformansën, mendoj se ka nevojë që të shqyrtohet dhe të shihet se në sistemin tonë juridik, politik dhe kushtetues a është gjetur një balancë e duhur ndërmjet pavarësisë së Gjyqësorit dhe llogaridhënies për performansë.

Kjo kërkon një trajtim studioz të ekspertëve, sepse në qoftë se ky Kuvend nuk ka asnjë pushtet të trajtojë efikasitetin, atëherë duhet të shihet se kush duhet ta trajtojë efikasitetin e gjyqësorit në Kosovë dhe duhet të shihet se pse ne na rritet numri, në vend që të zvogëlohet numri i rasteve nëpër gjykatave tona dhe e dini që ne kemi diskutuar shumë edhe për problemet e biznesit të cilat janë më problematike dhe kanë konsekuenca shumë të dëmshme për klimën investuese në Kosovë.

E di që janë marrë masa me krijimin e seksioneve të posaçme për investitorë të jashtëm, por ne nuk mund të krijojmë baza të posaçme për investitorët e jashtëm, por duhet të krijojmë barazi midis investitorëve të jashtëm dhe të brendshëm dhe efikasitet të sistemit tonë.

Prandaj, duhet të shihet se cili është roli i këtij Kuvendi, cili është roli i një trupi tjetër i cili është merituar që të theksojë suksesin e punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës. E di që gjyqet i raportojnë dhe përgjigjen Këshillit Gjyqësor të Kosovës, po nëse Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është i suksesshëm atëherë ku është linja e përgjegjesisë dhe llogaridhënia.

Këtë çështje duhet ta shqyrtojmë. Ndoshta nuk ka nevojë dhe ndoshta kjo është e zgjidhur, por unë kam përshtypje se ne këtu kemi një defekt në sistem, në definim të sistemit, ose në funksionimin e sistemit.

Çështja tjetër, burimet dhe kapacitetet në sistemin gjyqësor të Kosovës. Ne kemi investuar mjaft, edhe Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare ka bërë mjaft trajnime, ka dhënë mjaft asistencë financiare dhe teknike e gjithashtu janë rritur edhe pagat e prokurorëve e gjyqtarëve dhe në këtë drejtim edhe Qeveria i ka ndërmarrë masat e duhura.

Mirëpo, e kam përshtypjen se këtu diku po kemi një problem. Nëse neve na vjen duke u rritur numri apo duke u brumbulluar lëndë në sistemin gjyqësor, atë ne duhet ta shohim se ku është arsyeja.

Më duket se një nga arsyet, dhe nuk po them që e tëra është kjo, por një nga arsyet është se ne kemi pak gjyqtarë dhe kemi pak prokurorë. Nëse e shihni numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës në 1 000 banorë ose 100 000 banorë, do ta shihni se ky numër në Kosovë është bukur shumë më i vogël se në vendet e rajonit dhe se mesatarja e Bashkimit Evropian.

Ne mund të kërkojmë prej gjykatësve dhe prokurorëve tanë që janë përgjegjës të punojmë për të arritur një produktivitet mesatar të gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit apo gjyqtarët dhe prokurorët mesatarë evropian, por nuk mund të kërkojmë që gjyqtari ynë dhe prokurori ynë të punojë dyfish. Nuk mund të kërkojmë, sepse ata duhet të rrisin përgjegjësinë e tyre dhe t'ua definojmë vëllimin e punës.

Mendoj që, nëse në këtë segment kursehet buxheti, unë mendoj se ne bëjmë dëm të madh në shumë sektorë tjerë. Prandaj, më duhet të them se në këtë çështje duhet ndoshta të vazhdojmë debatin dhe t'i objektivizojmë këto vlerësime në mënyrë që pastaj të shohim edhe produktivitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve tanë përgjegjësive të tyre, pavarësinë dhe llogaridhënien në linjën gjykatë, këshill, këshill gjyqësor, prokurori, këshill prokurorial dhe Kuvendi i Kosovës, apo dikush tjetër. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Besa Baftiu e ka fjalën dhe në ndërkohë le të përgatitet Bislim Zogaj.

**BESA BAFTIU:** Faleminderit, kryesues,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Të nderuar të pranishëm,

U bënë 8 vjet që zakonisht thuhet se EULEX-i erdh në Kosovë, por në realitet ai erdh se e ftuan. E ftoi Qeveria e Republikës së Kosovës me arsyetimin se Kosova pasi e kishte shpallur pavarësinë e kushtëzuar nga Pakoja e Ahtisarit i nevojitej ndihma e BE-së për të ndihmuar sundimin e ligjit.

Ardhja e tij u mirëprit nga një pjesë e madhe e qytetarëve, nga shoqëria civile. E vetmja ishte Lëvizja “Vetëvendosje” kundër këtij misioni, sepse asnjë shtet serioz në botë nuk u thotë të huajve - ejani e bëjeni drejtësinë. E kur shpjegohej puna e EULEX-it si mision i sundimit të ligjit, askund nuk figurojnë fjalët drejtësi, barazi. Kur përshkruhen kompetencat e EULEX-it, një herë përdoren termat monitorim, udhëzim, këshillim për të vazhduar me të njëjtën fjalë me fuqinë e ekzekutivit të tij.

Nëse EULEX-i do të përmbahej sinqerisht zotimit për luftimin e korrupsionit, kontrabandës dhe krimin të organizuar, atëherë atij do t'i duhej t'i arrestonte partnerët e vet.

Në njërën anë, EULEX-i do të duhej t'i arrestonte politikanët kryesorë kosovarë, të cilët aq shumë para kanë përvetësuar përgjatë dekadës së pasluftës dhe tash të kësaj pas pavarësisë.

Po ashtu, EULEX-i do të duhej t'i arrestonte strukturat paralele shtetërore të Serbisë që janë përplot njerëz të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë me të cilën EULEX-i pati nënshkruar protokollin për bashkëpunim policor në vitin 2009.

Tanimë, të gjithë në Republikën e Kosovës e dinë se EULEX-i nuk i arrestoi bashkëpunëtorët e tij. Askund nuk ka korrupsion sikur te Qeveria, institucionet dhe në interes të lidhura me të. Askund nuk ka kontrabandë, krim të organizuar dhe kriminelë lufte sikur në veri të Kosovës.

Po çfarë bën EULEX-i tash e 8 vjet? Në vend që të diskutohet për dështimet e tij, në vend që EULEX-i të japë llogari për atë se çfarë ka bërë e çfarë nuk ka bërë, duke shpenzuar mbi 2 miliardë euro taksapaguesve evropianë, tash po synohet të kalohet në vazhdimin edhe për 2 vjet të tjera të EULEX-it. 9 vjet e kishim UNMIK-un, e tash EULEX-i do t'ia kalojë edhe UNMIK-ut.

Është shumë e çuditshme se si Qeveria e Kosovës pasi që ka qenë dëshmitare tash e 8 vjet, për dështimet e njëpasnjëshme të EULEX-it, nuk hezitoi aspak që sërish brenda natës e në rrethana krejtësisht jotransparente, me procedura të përshpejtuara të sjellë sërish për ratifikim zgjatjen e mandatit të EULEX-it. Mbase është e çuditshme për ne që presim kur një person, një organizatë dhe një mision nuk performon dhe nuk tregon sukses, ai apo ajo, duhet të shkarkohet, të ndëshkohet apo të largohet.

Mirëpo, është fare e kuptueshme se një Qeveri e dështuar ia zgjatë mandatin një misioni të dështuar, nga se të dyja këto, pra Qeveria e dështuar dhe misioni i dështuar janë në funksion të njëra-tjetrës.

Zgjatja e mandatit të këtij misioni që edhe më tutje nuk i jep llogari këtij Kuvendi dhe asnjë institucioni tjetër të Republikës së Kosovës dhe besimi se kësaj radhe se vërtet do të ketë ndryshime, është sikur të besohet se një lule e plastikës për 8 vjet ta ujitni dhe në fund të besoni se ajo do të rritej.

Krejt në fund, i ftoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të votojnë kundër, sidomos ata që me fjalimet e tyre paraqitën të metat e këtij misioni të dështuar, mirëpo prapë nuk besoj se do ta bëjnë këtë, sepse këtë e kanë dëshmuar edhe me votimin e Gjykatës Speciale, dhe përkundër fjalimeve të tyre që ishin kundër kësaj, prapë në fund votuan, sepse ashtu ishin dhe ashtu e patën të detyruar, pothuaj, nga liderët e tyre që ta votojnë një gjë të tillë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Atëherë, Bislim Zogaj e ka fjalën dhe në ndërkohë të bëhet gati Gëzim Kelmendi.

**BISLIM ZOGAJ:** I nderuar kryetar,  
Të nderuar deputetë,

Nga ne sot po kërkohet të votojmë vazhdimin e mandatit të misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit EULEX, mandat të cilin e ushtroi për plot 8 vjet. Po çka bëri EULEX-i për 8 vjet në Kosovë? E implementoi një gjyqësi të mirëfilltë në Kosovë, e zhvilloi ndonjë proces gjyqësor të drejtë që ta bindë qytetarin e Kosovës se ai proces ishte i drejtë dhe fajtorët morën dënimin e merituar? Me gjykimet që i bëri ndikoi në zvogëlimin e korrupsionit apo kriminalitetit në Kosovë?

Unë mendoj se jo! Veprimet dhe vendimet që i mori gjatë këtyre 8 vjetëve sa ishin të padrejta, po aq ishin denigruese dhe të tmerrshme për qytetarin e Kosovës.

Do të mundohem t'i përmend vetëm disa raste, ku EULEX-i dështoi tërësisht. Për shembull, për krime lufte, e dënoi Sami Lushtakun pse kinse e kishte vrarë një person për të cilin nuk dihet se kush është ai person, dhe ky vendim merret nga deklarata e vetëm një dëshmitari. A thua ka ndodhur në ndonjë vend tjetër të botës që të dënohet dikush që e ka vrarë një person për të cilin nuk dihet nëse ka ekzistuar. Unë besoj se jo!

Po "Rasti i Drenicës" kur dënohen 4 vëllezër Demaku gjoja se i paskan dhënë tri shuplaka një bashkëpunëtori të UDB-së gjatë luftës, edhe këtu vetëm një dëshmitar.

Po si janë trajtuar bashkëpunëtorët e okupatorit në vendet tuaja, të nderuar?  
Dhe, kur dihet se këtyre vëllezërve Demaku, përveç që u është vrarë një vëlla gjatë luftës, u është plagosur edhe një motër dhe askush nuk ka dhënë përgjegjësi për këtë.

KRYETARI: U është vrarë një motër, nuk është plagosur. U është vrarë një motër dhe mbesës i është amputuar dora.

BISLIM ZOGAJ: Megjithatë, dua të them se është dëmtuar skajshmërisht dhe askush nuk është gjykuar për këtë, kurse për krime të organizuara tashmë e 8 vjet nuk u ndërmor asgjë dhe vetëm tani në fund të mandatit sa për të krijuar një arsye për ta vazhduar mandatin tuaj bëtë një veprim spektakular dhe për këtë viktimitë duhej të ishte një njeri me autoritet për të arsyetuar veprimin tuaj se gjëja ne jemi të guximshëm dhe mund të arrestojmë kë të duam, madje edhe pa fakte kredibile.

Arrestimi i Azem Sylës për krim të organizuar ishte një absurd i llojit të vet. Ai ende mbahet në paraburgim vetëm në saje të dëshmimeve të dëshmitarit Bllaca, të përgatitur nga Dragolub Stankoviqi dhe një dëshmitar tjetër të mbrojtur.

Forma e arrestimit dhe mbajtja në paraburgim edhe më tutje, pa fakte e dëshmitarë kredibil është një arsye më shumë se edhe ju jeni të vetëdijshëm për pafajësinë e Azem Sylës. Po nëpërmjet këtyre veprimeve ju po mundoheni t'ia humbni autoritetin e Azem Sylës ish komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e përmes tij të bëni edhe denigrimin e luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Por Azem Sylë do të dalë edhe më i fuqishëm sepse Azem Sylë nuk është siç e quani ju me epitete të llojllojshme, por ai është një patriot i madh i cili tërë jetën ia kushtojë çështjes kombëtare.

Po ju, zotërinj të EULEX-it, përse edhe pas 8 vjetëve nuk ngrihet aktakuzë për masakrën e Burgut të Dubravës? Në këtë masakër isha pjesë edhe unë, do të thotë e përjetova edhe unë këtë masakër dhe ishte një masakër kur për 5 ditë rresht u masakruan të burgosurit e pambrojtur. Dhe, me të vërtetë, kjo ishte një masakër e organizuar shtetërore dhe aty mbetën të vrarë 120 dhe mbi 300 të plagosur dhe kur dihet se kush e organizoi këtë masakër, e deri më tani ende nuk janë marrë masa ndaj askujt, derisa mua një herë më kanë ftuar për një deklaratë EULEX-i, por megjithatë ende asgjë nuk është vepruar në këtë drejtim.

E për rastin e doktorit dhe humanistit Hafir Shala, pse mbahet ende në sirtar lënda e tij për këtë rast, kur dihet se kemi dëshmitarë kredibilë, dy nga ta të cilin ishin bashkë me të, Hetem Sinani e Shaban Neziri, të cilët edhe kanë deklaruar se Hafirin, i fundit nga ata, e ka marrë Fadil Suleviqi dhe ende nuk është bërë për këtë rast.

Po, edhe për shumë masakra që u bënë anekënd Kosovës, përse nuk u gjykuan? Vallë ju do të gjykoni vetëm ata që luftuan për të mbrojtur vendin apo në këtë mandat do të gjykoni edhe ata që na vranë dhe persekutuan. Prandaj, kërkoj nga ju që tani t'i thërrisni ndërgjegjes tuaj dhe të bëni një gjyqësi të mirëfilltë dhe të marrin dënimin e merituar ata që bënë krime lufte në Kosovë dhe ata që në të vërtetë po bëjnë krime ekonomike në Kosovë.

**KRYETARI:** Gëzim Kelmendi e ka fjalën dhe në ndërkohë të bëhet gati Mytaher Haskuka.

**GËZIM KELMENDI:** I nderuar kryetar i Kuvendit,  
I nderuari kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Të nderuar përfaqësues të ambasadave,  
I nderuar përfaqësues i BE-së,  
Vazhdimi i mandatit të EULEX-it padyshim se është një sfidë e radhës për neve si deputetë të Kuvendit të Kosovës por në anën tjetër është edhe një nevojë e domosdoshme për vendin tonë. Pse po e them këtë? Unë mendoj si deputet i Kuvendit të Kosovës që shkalla e lartë e krimit të organizuar që mbretëron në Kosovë ende, fatkeqësisht, dhe shkalla e lartë e korrupsionit janë dy arsye kryesore pse duhet t'i vazhdohet mandati EULEX-it.

Mos të harrojmë që fatkeqësisht këtë situatë e bën edhe më të rëndë mungesa apo më mirë me thënë mungesa e guximit të institucioneve të drejtësisë kosovare që duhet të ballafaqohen me krimin e organizuar dhe shkallën e lartë të korrupsionit.

Ne e dimë të gjithë dhe edhe dëgjuam prej shumë kolegëve deputetë se pritjet nga EULEX-i kanë qenë shumë më të mëdha. Por, mos të harrojmë se jo vetëm misioni i EULEX-it por çdo mision në nivel botëror apo global ka të meta dhe mangësi, por unë do të kisha përqendruar fjalimin tim në një drejtim tjetër për faktin se para se të merremi me punën gjatë mandatit të kaluar të EULEX-it merremi të merremi me vetveten tonë, para se të jemi kritikë ndaj tjetërkujt, të jemi vetëkritikë. Sa ka bërë politika kosovare për këto 17 vjet pas lufte për zbardhjen e të gjitha atyre masakrave që u përmendën këtu? Sa ka bë politika kosovare për zbardhjen e fatit të pagjeturve? Sa ka bërë politika kosovare që të ruhet pastërtia e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

Prandaj, para se ta kritikojmë EULEX-in, ta kritikojmë vetveten tonë. Ne e dimë se, fatkeqësisht, pala kosovare në të gjitha bisedimet që ka zhvilluar në Bruksel nuk e ka mbrojtur dinjitetshëm të drejtën, lirinë ose më mirë me thënë kauzën për lirinë e vendit tonë. Kjo na ka kushtuar neve shumë. Imagjinoni sikur të ishte rasti i kundërt, sikur ne të ishim agresori dhe jo viktimë se sa e fuqishme do të ishte qeveria e Beogradit në mbrojtjen e të drejtës së saj. Prandaj, unë mendoj se një pjesë të mirë të përgjegjësisë për moszbardhjen e këtyre vrasjeve, për njollosjen apo tentimin e njollosjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për të mungesën e të pagjeturve, e mban politika kosovare.

Prandaj, kritikën ndaj EULEX-it unë mendoj se duhet t'ia hedhim edhe vetvetes sonë, e pastaj të merremi me EULEX-in.

Dha pa dashur të zgjas më shumë, unë e përfundoj me dy arsye kryesore dhe prapë po e them pse duhet të jetë EULEX-i në Kosovë? E para, shkalla e lartë e krimit të organizuar e korrupsionit dhe e dyta mungesa e vullnetit të drejtësisë kosovare që t'i dënojë këto krime që fatkeqësisht e kanë ngulfatur çdo sistem të jetës së jetës kosovare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mytaher Haskuka dhe në ndërkohë le të bëhet gati Nait Hasani, ose Adem Grabovci.

MYTAHER HASKUKA: Të nderuar deputetë dhe deputete, Bashkimi Evropian apo shtetet që janë aty janë për shkak se atje ka llogaridhënie dhe ndarje të përgjegjësive. Atje gjykatat punojnë ngase u kërkohet llogari atyre kur nuk e bëjnë punën e tyre.

Mirëpo, në EULEX ne e kemi të kundërtën. Aty nuk ka kurrfarë llogaridhënie. Asnjëherë, asnjëri prej shefave të EULEX-it, nuk ka raportuar në Kuvendin e Kosovës për atë se çfarë po bën ai në Kosovë apo cilat janë rezultatet e EULEX-it në Kosovë.

Vitin e kaluar ky Parlament ose Kuvendi ynë, pati nxjerrë një rezolutë në të cilën kërkohet që ndër tjera EULEX-i të raportonte në Kuvendin e Kosovës për punën e tij apo për mos punën e tij. Por, u kaluan shumë vite dhe asgjë nuk u bë pas rezolutës, edhe pse aty, në rezolutë kërkohet që brenda 6 muajve të bëhet një gjë e tillë.

Këta zyrtarë ose shefa të EULEX-it shkojnë nëpër ligjërata në kolege private, ata ulen nëpër tryeza të organizatave joqeveritare, nëpër studio televizive, këta shkojnë e flasin pothuaj gjithkrah, por vetëm nuk vijnë në Kuvendin e Kosovës dhe nuk raportojnë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Pse ky aversion ndaj Kuvendit të Republikës? Nëse EULEX-i konsideron se nuk duhet t'i japë llogari Kuvendit të Kosovës dhe nuk ka kurrfarë përgjegjësie ndaj Kuvendit të Kosovës, përse ai atëherë kërkon që Kuvendi i Republikës ta vazhdojë mandatin e tij. Pra, pasi s'jep llogari, nuk ka as nevojë të kritikojë dhe të japë leje, do të thotë pasi EULEX-i nuk jep llogari ndaj Kuvendit të Kosovës pse ai kërkon leje nga Kuvendi.

Pas 8 vjetësh dhe 2 miliardë euro, asnjë raportim kundrejt popullit të Kosovës, asnjë llogari ndaj përfaqësuesve të popullit dhe kundrejt Republikës.



Mos është edhe kjo ndoshta arsyeja kryesore pse EULEX-i nuk jep llogari ndaj Kuvendit të Kosovës, nga se ai është Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe për shkak se EULEX-i është në njëfarë aspekti asnjans ndaj Republikës së Kosovës dhe nuk e pranon atë.

Këtu duhet të lidhim edhe një raport nga Gjykata Evropiane e Auditorëve që e publikoi një raport me 72 faqe në vitin 2012, ajo ndër të tjera raporton për shumë dështime të EULEX-it, por ndër të tjera dhe kryesore përmenden si pamundësia e hetimit të krimeve serioze për shkak të papërvojës dhe ndërhyrjes politike, nuk është i shënuar progres në adresimin e krimeve ekonomike dhe pastrimin e parasë dhe aty po ashtu theksohet se EULEX-i përmban përgjegjësinë ekzekutive si pjesë integrale e Gjyqësorit të Kosovës dhe të gjitha dështimet në to varen edhe prej saj.

Unë këtu do ta shtoj edhe një dështim të EULEX-it në këto 8 vjet të kaluara, e ai është dështimi që t'i shqyrtojë krimet e Serbisë në Kosovë. E pse ndodhi ky dështim, apo pse EULEX-i nuk jep llogari?

EULEX-i fillimisht u krijua që t'i ndjekë rastet për të cilat Gjyqësori i Kosovës nuk kishte guxim apo nuk kishte dijeni t'i ndjekë dhe po ashtu që ta shtrinte sundimin e ligjit në pjesën veriore të Kosovës.

Pas dy vjetësh, asnjëri nga këto qëllime nuk është arritur. As nuk janë persekutuar personat të cilët janë më problematikë ose raste problematike apo peshqit e mëdhenj dhe as nuk është shtrirë sundimi i ligjit në pjesën veriore të Kosovës. Po çfarë u bë? EULEX-i u bë bashkëpunëtor i këtyre dy pikave problematike të Kosovës ose të qytetarëve të Kosovës. U bë bashkëpunëtor i kriminelëve të cilët janë në pushtet dhe të kriminelëve të Serbisë në Kosovë. Prandaj, si bashkëpunëtor i këtyre dyve, ai nuk mund të bie drejtësi dhe nuk mund të rregullohet.

Unë besoj se Kosova nuk ka nevojë për status quo dhe duhen ndryshime, prandaj edhe nuk jam për vazhdimin e mandatit të EULEX-it në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Prej këtyre që janë lajmëruar për diskutim, në sallë je vetëm edhe ti, Salih Salihu. Urdhëroni!

**SALIH SALIHU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne deputetët e këtij Kuvendi jemi thirrur që të miratojmë vazhdimin e një misioni i cili nuk e njeh subjektivitetin e këtij vendi, mision i cili këtë vend e konsideron si territor në të cilin balancohet pozicioni politik karshi shtetit, i cili e projekton Kosovën ngjashëm sikur në situatën aktuale në të cilin gjendet Republika e Kosovës, pa sovranitet, vend me qeveri të korruptuar, krim të organizuar, institucional dhe shërbyes ndaj interesave të jashtme, në dëm të Republikës.

Ndonëse Kushtetuta e Republikës së Kosovës ne si deputetë na obligon që gjithë funksionin ta ushtrojmë në dobi më të mirë për shtetin e Kosovës, sot për ne kërkohet që pazarllëkun e subjekteve politike në qeverisje PDK dhe LDK ta ratifikojmë dhe miratojmë nomenklaturën juridike ligjore për të vazhduar mandatin e një misioni i cili nuk ka pasur guxim të hetojë krimin

brenda organizimit vetjak të brendshëm e lërë më që të mbahet në prerogativën formale të saj misioni i BE-së për sundimin e ligjit.

Ndonëse shteti i Kosovës në nenin 1 paragrafi 1 dhe nenin 2 paragrafi 1 të Kushtetutës së Kosovës përkufizohet si shtet sovran, në të cilin sovraniteti shtetëror ushtrohet nga populli përmes përfaqësuesve të saj, ne na kërkohet që këtë sovranitet ta falim. Pra, nuk kërkohet bartja e sovranitetit në shërbim të mirës së përgjithshme të qytetarëve të Kosovës dhe kështu të bartet e drejta sovrane, sikur, për shembull me rastin e anëtarësimit në BE, por Kosova sot po kërkohet që të vazhdojë sovranitetin e pezulluar.

Nuk po kërkohet nga ne që nga misioni i BE-së të ofrohet ndihma e mirëfilltë, me përkrahje të institucioneve të zbatimit të ligjit, por po kërkohet që të vazhdohet së ekzistuari vëllai i madh i cili mbikëqyrë dhe vetëm në baza të proceseve politike dhe në përfundim të mandatit të nisë procese.

Është më e keqe se edhe ky mision e ka përvetësuar një praktikë të kësaj qeverie. Në pamundësi që të shtrojë asfalt në fund të mandatit dhe të presë shirita festivë, ky mision i fillon disa ndjekje penale simbolike në emër të kinse sundimit të ligjit.

Për gjithë këtë e pagoi dhe ende po e paguan Kosova me sovranitetin e saj. Këto lëshime të vazhdueshme në kurriz të vendit u iniciuan nga Serbia, u zbatuan nga Qeveria jonë, shpeshherë me arsyetimin se miqtë ndërkombëtarë po e kërkojnë edhe një koncesion të ri për vendin.

Sot gjatë ditës e kuptuam se binomi politik në krye të vendit, paska mundësi të refuzojë misionet, jo për të mbrojtur sovranitetin e vendit, por për të mbrojtur veten, pasi kësaj here kushti për vazhdimin e misionit ka qenë eksplicitë, kërkesa për mosngritje të reja për korrupsion dhe rrjedhimisht amnisti për njerëz të krimit, njerëz këta që janë direkt të pushtetit.

Prandaj, sot kemi pasur negociata, jo për sovranitet, jo për shtet dhe parime, por për individë dhe lëndë të caktuara, ose thënë më shkurt për të vazhduar partneritetin me EULEX-in, por me kushtin që të paprekshmit të vazhdojnë të mbesin të tillë.

Sot Republika e Kosovës, si asnjëherë më parë, ka nevojë për institucione sovrane e të mëvetshme, për institucione që i japin llogari shtetasve të Republikës nën misionin e qartë - Kosova Republikë funksionale dhe ekzistenciale, e cila... *(ndërprerje e incizimit)*... Kosova me sistem kushtetues e ligjor,... i sigurisë juridike në dobi të qytetarëve, Kosova shtet i barazisë sociale, shtet i së drejtës dhe shtet zhvillimor. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nait Hasani e ka fjalën dhe diskutuesi i fundit është zoti Adem Grabovci. Tjerë të lajmëruar nuk ka.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për kryeministrin, zëvendëskryeministrin, ministrat,

Përsëritje kolegë deputetë,

Është bërë një traditë që 8 vjet, për çdo 2 vjet ta kemi në rend dite çështjen e EULEX-it, vazhdimin, mosvazhdimin, ngarkesave politike, streseve mediatike të ndryshme. Për ne me

rëndësi është që Kosova është shtet i pavarur. Me rëndësi është që kemi një mision të Bashkimit Evropian duke u munduar dhe duke synuar të jemi pjesë e integriteteve evropiane dhe duke besuar se ky mision do të jetë pjesë e së drejtës, pjesë e sundimit të ligjit, pjesë e vlerësimit pozitiv të qytetarët tanë.

Atë që e kemi biseduar, atë që e kemi dëshiruar me shumicë absolute, të them, të qytetarëve të Kosovës, nuk i ka arritur parashikimet tona EULEX-i.

Kur e them nuk i ka arritur, kemi parasysh veprimet jo edhe për atë që është pritur, sidomos në sundimin e ligjit. E them këtë se ne kur ishim të burgosurit politikë kemi bërë një kallëzim penal pikërisht në 2007 dhe ai kallëzim penal e ajo akuzë që e kemi bërë ndaj masakrës dhe krimeve që i ka bërë Serbia në Burgun e Dubravës, asnjëherë nuk është trajtuar, asnjëherë nuk është shqyrtuar dhe pikërisht në këtë Kuvend të Kosovës kemi debatuar, kemi nxjerrë rezolutë, kemi kërkuar që krimet në Burgun e Dubravës të dihen me emër e mbiemër, të gjykohen e të dënohen.

Janë vrarë 120 e më tepër të burgosur, janë të plagosur mbi 300 të burgosur... *(ndërprerje e incizimit)* ...vrasje, dy të burgosur dhe janë torturuar shpirtërisht qindra të tjerë, prandaj nëse një veprim të tillë nuk ka mund ta trajtojë EULEX-i, atëherë cila është vlera e tij ose besimi i tyre që ata të rrinë dhe qëndrojnë në Kosovë.

Tjetra është se kemi masakra që janë bërë në Krushë të Vogël dhe në Krushë të Vogël ka qenë edhe Komisioni i Kombeve të Bashkuara, pikërisht të varreza masive, të djegia që është bërë, dhe asnjë veprim nuk është bërë për gjykimin e tyre që e kanë bërë këtë krim, pra ushtrisë dhe policisë serbe.

E kemi në Krushë të Madhe, po ashtu, masakrën që ende nuk dihen njerëzit se ku i kanë eshtrat e tyre. Janë të zhdukur nëpër Serbi diku.

Kemi Celinën, kemi Nagavcin, kemi Bellacërkën, i kemi edhe shumë fshatra ku banorët lokalë serbë të veshur në uniforma, të mobilizuar kanë bërë krime dhe gjenocid. Prandaj, sundimi i ligjit që është mundësi e Bashkimit Evropian, kërkesë edhe jona që e kemi bërë, është një nevojë e kohës që ata të tregojnë veten. Nuk duhet të merren ata vetëm me individë të caktuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të thonë pastaj - ne e zgjidhëm problemin. Jo, sundimi i ligjit është sundim i ligjit ku nuk ka barazi etnike, nuk ka përkatësi etnike, nuk ka as gjumë, as racë, por ai është sundim i ligjit për të gjithë. Prandaj, për të vendosur këtë, unë jam që EULEX-i të jetë në Kosovë, jam t'i vazhdohet mandati dhe pikërisht se po besojmë që tanimë kanë ndryshuar rrethanat dhe ai do të jetë më efikas në sundimin e ligjit për të gjithë në Kosovë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Tani kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Adem Grabovci e ka fjalën.

**ADEM GRABOVCI:** Faleminderit, zoti kryetar!  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeverisës,  
Kolegë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është takuar, është këshilluar dhe biseduar dhe së fundi kemi ardhur në përfundim se ne do t'i japim mbështetje vazhdimet të misionit të EULEX-it në Kosovë dhe këtë e kemi bërë që para vitit 2008, pra para shpalljes së pavarësisë, gjatë shpalljes së pavarësisë, gjatë përgatitjeve të punës përgatitore për shpalljen e pavarësisë, kemi pasur parasysh ndihmën e jashtëzakonshme që na i ka dhënë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, jemi dakorduar që të thërrasim misionin e Bashkimit Evropian për të na ndihmuar në konsolidimin e sistemit të rendit e ligjit, si dhe sistemin e drejtësisë.

Ne kemi besuar dhe akoma besojmë se misioni i Bashkimit Evropian do të na ndihmojë në përshpejtimin e hapave drejt integritimit në mekanizmat e Bashkimit Evropian dhe të sistemit ndërkombëtar, në përgjithësi.

Që nga viti 2008 e deri më tash, misioni i EULEX-it, përkundër angazhimeve dhe rezultateve të arritura në sundimin e ligjit, është përcjell edhe me lëshime e dobësi të manifestuara veçanërisht në mosndriçimin deri në fund të rasteve me të cilat është marrë, por, edhe me lëshimin anash, thuaja se në tërësi, të krimeve të luftës që ka ndodhur në Kosovë.

Duhet theksuar se për gjenocidin e shkaktuar në Kosovë gjatë periudhës së luftës nuk janë duke u ndjekur kriminelët që shkaktuan gjenocid.

Misioni i EULEX-it përveç një rasti në Mitrovicë të kriminelëve që kanë vra më se 12 mijë civilë shqiptarë, që zhdukën mbi 5 mijë shqiptarë, akoma mbi 1 600 familje presim për ndriçimin e fatit të më të dashurve të tyre. Më se 1 620 persona, duke llogaritur edhe një numër të konsiderueshëm të fëmijëve ende janë të pagjetur, kundër kriminelëve që kanë ushtruar dhunë seksuale në mbi 20 mijë gra e vajza shqiptare, e që po ashtu edhe dhuna seksuale është akt gjenocidial kundër atyre që kanë dëbuar mbi 1 milionë shqiptarë nuk është zhvilluar asnjë proces.

Deri më tash më shumë janë trajtuar e madje edhe dënuar pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët kanë bërë një luftë mbrojtëse dhe kanë mbrojtur popullatën se sa kriminelët që kanë ushtruar gjenocid në Kosovë. Drejtësia që eventualisht bazohet në dosje tërësisht të fabrikuara nga prokuroria e Serbisë për krime lufte është padrejtësia më e madhe që mund t'u bëhet të gjithë atyre që presin të dënohen kriminelët që shkaktuan gjenocid në Kosovë, prandaj ne kërkojmë nga misioni i EULEX-it se para drejtësisë të dalin kriminelët që shkaktuan gjenocidin në Kosovës por edhe të ndriçojnë rastet e rënda si dhe të jenë efektivë kundër kimit, korrupsionit dhe dukurive tjera devijonte që janë manifestuar në shoqërinë kosovare.

Ne si Grup Parlamentar e mbështesim misionin e EULEX-it në Republikën e Kosovës, sepse përcaktimi ynë është i drejtë dhe rruga e vetme drejt Bashkimit Evropian.

Edhe një herë shfrytëzoj rastin dhe të gjithë deputetëve tu bëjë thirrje të votojnë për vazhdimin e misionit të EULEX-it. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë zoti Grabovci! Zoti Konjufca, e doni fjalën edhe një herë?

Atëherë, para se të vazhdojmë me votimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 91 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për të proceduar.

Votimi do të jetë transparent, me elektronikë, dhe lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë, 90 deputetë kanë marrë pjesë në votim. 84 janë për, 6 kanë votuar kundër dhe Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë.

### **19. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit që ndërlidhet me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës**

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për ta miratuar.

Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotëri Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që të prezantoj para jush Projektligjin për ndryshimin e ligjeve që lidhen me mandatin e EULEX-it në Kosovë, duke i theksuar ndryshimet kryesore që janë paraparë me këtë projektligj.

Në këtë projektligj do të vëreni po sa edhe është shkruar se janë bërë disa zgjidhje, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me mandatin e EULEX-it në Kosovë, e njëkohësisht edhe me kompetencën e institucioneve të Republikës së Kosovës

Natyrisht do t'i theksoj ndryshimet kryesore, ndërsa besoj të tjerat janë të vërejtura në ligj.

Çështja e përmbylljes apo data e përmbylljes së misionit të EULEX-it tanimë është definuar se do të jetë në qershor të vitit 2018 dhe kjo natyrisht ka qenë një prej pikave që është edhe negociuar dhe është një pajtueshmëri tani edhe me institucionet e Kosovës dhe me ato të BE-së.

Çështje me rëndësi të veçantë dhe që është diskutuar, në veçanti ka qenë e nevojshme të saktësohet dhe në këtë projektligj është mundësia e marrjes së rasteve të reja.

Natyrisht në këtë pikë kemi qenë jashtëzakonisht të kujdesshëm se si ta rregullojmë, së pari që të mos pengojmë organet e drejtësisë të kryejnë punën e vet dhe në rrethanat e jashtëzakonshme të

jepet mundësia që institucionet e Kosovës të kërkojnë bartje të një rasti tek institucionit të EULEX-it.

Dhe, njëkohësisht më lejoni të them se është dhënë po ashtu e drejta që autoriteti kompetent i EULEX-it të bëjë një kërkesë të tillë, duke dhënë mundësinë gjithmonë që vendimmarrja të jetë nga një komision i përbërë nga kryeprokurori i shtetit, prokurori i prokurorisë speciale dhe ai i apelit dhe të votohet nga Këshilli Prokurorial.

E njëjta gjë do të vlejë edhe lidhur me kërkesat që janë për Këshillin Gjyqësor dhe për panelet me shumicë të EULEX-it.

Në fund, më lejoni të them se janë përfshirë të gjitha ato ndryshime që reflektojnë edhe nga letrat e shkëmbyera nga presidenti i Republikës dhe zonja Mogerini.

Ju ftoj që sot ta bëjmë leximin e parë, dhe besoj pas pauzës me leximin e dytë, si kusht për funksionimin e mandati të ri të EULEX-it në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë.

Të nderuar deputetë, pas prezantimit të Projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim.

Kryetarja e Komisionit për Legjislacion nuk është këtu.

Në emër të Komisionit Funkcional, zonja Selvije Halimi e ka fjalën!

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Komisioni për legjislacion, duke u bazuar në nenin 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 16.6.2016 e shqyrtoi Projektligjin numër 5/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

#### R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 5/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Republikën e Kosovës.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën. Do të shkojmë në formë elektronike, edhe grupet parlamentare, kolegët e “Vetëvendosjes”. Atëherë, fjalën e ka zoti Armend Zemaj. Urdhëroni!

Nuk do ta merrni fjalën! Atëherë nuk ka tjerë të paraqitur për fjalë, as përfaqësues të Qeverisë që ta marrin fjalën.

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Të pranishëm në sallë janë 90 deputetë. Ju lus të përgatitemi për votim. Më fal, zoti Damka, jemi në procedurë të votimit, pastaj e vazhdoni.

Pra, lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Gjithsej kanë votuar 89 deputetë. 84 janë për, 5 kundër dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion që në pajtim me mendimin e seancës plenare të ndryshojë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesë raportin me rekomandime për seancën plenare të radhës, që do të mbahet sot.

Pyes, kur doni ta mbajmë seancën? Në orën 16:30. Atëherë, do të takohemi në orën 16:30. Faleminderit!

Pra, me kaq i mbyll punimet e kësaj seance dhe mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*